

Rruga e Arbërit

www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 8 / 2018.

ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Reportazh

Shën Mëria në Lurë,
një festë si askund
tjetër

Nga **ERION KRISTO**



7

Profil

Ferma "Kaja" në
Gjoricë, një histori
suksesi përmes punës

Nga **OSMAN XHILI**



9

Sport

Dibra e Madhe
pret Kampionët

Gjetan Keta lufton për
titullin në versionin WBU

Nga **DEFRIM METHASANI**



12

Revista Monitor, e profilizuar
mbi raportimin e zhvillimeve ekonomike në vend,
boton një reportazh për potencialet e zhvillimit të turizmit

Dibra tjetër, ajo e turizmit

FAQE 4-5

PERËNDIM NË
BJESHKËN E
HINOSKËS.

Foto: BUJAR KAROSHI

NË BRENDËSI:

- Zimuri, fshat i harruar
- Një ditë në Prat, aty ku festojnë banorët e Katër Grykëve
- Organizimet komunitare dhe demokracia
- Adriatik Cami: Duke punuar fort vjen edhe suksesi
- Duke kujtuar Pedagogjiken e Peshkopisë
- 154 sonetet e Shekspirit në gjuhën e Naim Berishës
- KALENDAR HISTORIK shek. V p.e.s. - qershor 2009
- Leo Krkuti, një tjetër shqiptar i madh në muzikën "Pop"
- Masakra e Çidhnës (1466)
- "Penën time nuk e shes!"

Kryeministri: Punimet vijnë me cilësi e ritëm të lartë



Qytetarët, edhe për shkak të mbështetjes politike, janë të ndarë në dy grupe: ata që besojnë te Kryeministri se nuk ka kthim prapa dhe ata që besojnë se gjithçka e reklamua është vetëm propagandë. Një vëzhgim të terren tregon se, pavarësisht opinionit të ndarë në dysh, punimet vazhdojnë.

FAQE 3



Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearbërit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.



Gazetë e pavarur.
Nr. 8 (148). Gusht 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit shtator

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.
Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.
Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:

Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFÀ
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:

Ledina LOGA
Erion KRISTO
Hekuran VLADI
Mevlud BUCI
Angjelina SULA
Bajram XHAFA
Xhafer MARTINI
Arjan A. BEJKO
Halil TEODORI
Haki PERNEZHA
Adem NAZIFI
Viron KONA

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearbërit.com.
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearbërit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearbërit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohej riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.



BUJTINA KONAKU

është 500 metra larg qendrës së Peshkopisë, rrugës për Kukës. Ajo ofron 6 dhomë dhe ka një kapacitet prej 18 vendesh. Kjo bujtinë menaxhohet nga Hamit Salkurti, një nga ekspertët lokalë të turizmit malor. Kontakt: Tel: +355 218 24 638 / Cel: 0692053492. 0673105366. 0675413107 / Email: hamitsalkurti@gmail.com



GUESTHOUSE “TE SABRIU” NE RABDISH

Në fshatin turistik të Rabdishtit është hapur e para shtëpi pritëse te familja e Sabri Shahinit. Bujtina është me standarde të kërkuara nga turizmi familjar. Rregulli, pastërtia, mikpritja, gatimi tradicional dhe shtëpia karakteristike janë mundësitë që po shfrytëzon Sabriu për turizëm.

Vizito Dibrën më 4-6 tetor

ODA DIBRANE

dhe

FESTA E TE VJELAVE

Mos e humb rastin! Vizito Dibrën një fundjavë!

VJESHTA ËSHTË E ARTË

#Dibran’feste #FestaeteVjelave #OdaDibrane



Disa shtëpi pritëse në Dibër



Kullë mbi 200-vjeçare.
Lepurak, Fushë-Bulqizë.
Cel 0688373793



VLADIMIR MARKU

Telefon : +355 68 65 06 061 Facebook: Vladimir Marku
Email: markuvladimir@yahoo.com



REST HOUSE KORABI është investimi më i bukur i bërë nga vëllezërit Elezi në fshatin Bahute. Një shtëpi me gur të gdhendur, me oborr të gjelbert, me pajisje prej druri, me impiant ngrohje, si në Evropë. Pasioni i Fluturim Elezit ju mahnit me shërbimin dhe guidën në ballkonin e Peshkopisë dhe në parajsën e bjeshkës së Gramës. Nëse doni të largoheni nga vapa, në Bahute vetëm 15 min larg Peshkopisë ju mirepret:

Vizitoni në Facebook:
Rest House Korabi dhe Fluturim Elezi



Chalet Stebleva

Bujtina Stebleva

Tel: 00355 695168173
Email: mersinhoxha@gmail.com
adahoxha@gmail.com
www.facebook.com/chalet.stebleva
www.shoqatastebleva.al

Kryeministri: Punimet vijnë me cilësi e ritëm të lartë

Qytetarët, edhe për shkak të mbështetjes politike, janë të ndarë në dy grupe: ata që besojnë te Kryeministri se nuk ka kthim prapa dhe ata që besojnë se gjithçka e reklamua është vetëm propagandë. Një vëzhgim të terren tregon se, pavarësisht opinionit të ndarë në dysh, punimet vazhdojnë.

Më 24 gusht kryeministri Edi Rama u tha “Mirëmëngjes” dhe u uroj një ditë të mbarë ndjekësve të tij në FB me një videoinformacion nga kantieri i Rrugës së Arbrit, ku sipas tij, “punimet vijnë me cilësi e ritëm të lartë sipas planit”.

Dhe si zakonisht, siç ndodh në postimet e tij, komentet janë të ndryshme. Ka qytetarë që e urojnë dhe i japin hapur mbështetje, siç ka edhe të tjerë që shfaqen mosbesues.

“Forcë punëtore nuk ka! Bëji sa të duash reklamë, por ne që kalojmë e dimë si është e vërteta”, i shkruan një komentues, të cilit kryeministri i përgjigjet se “kjo rrugë nuk ka një vit, por vetëm pak muaj që ka nisur e para, dhe e dyta, ti nuk kalon dot nga kjo rrugë edhe me dash sepse, siç e sheh, është komplet gjurmë e re! Kështu që, qesh sa të kesh fuqi, po ji i sigurt se projekti i kësaj rruge po ecën krejtësisht sipas planit dhe forcat punëtore janë të gjitha në punë”.

Gjatë këtij viti, Rruga e Arbrit ka qenë në një vëmendje të shtuar të kryeministrit. Ai njoftoi nisjen e punimeve në një miting të madh në Peshkopë dhe Klos në mes të qershorit, ndërsa prej atëherë ka njoftuar ecurinë e tyre edhe përmes njoftimeve në kanalën e tij televiziv online ERTV dhe Facebook-ut.

Më 15 gusht u hap njëri nga tunelet në Klos dhe ishte Ministri i Infrastruktura dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, i cili përmes një postimi me disa foto në FB dha lajmin.

“Vazhdon me intensitet të lartë puna në kantierin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Ditën e djeshme u shënua dhe hapja e tunelit T5 që është 500 metër i gjatë dhe ndodhet në fshatin Fshat të Klosit. Përtej këtij tuneli do të fillojë ndërtimi i Urës së Vashës, e cila do të kryejë lidhjen me anën tjetër të rrugës në drejtim të Bulqizës”.

Postimet me foto e lajme të pjesshme në rrjetet sociale përcjellin jo vetëm ministrat, por edhe niveli në bazë i qeverisjes lokale, drejtues lokalë apo punonjës të kompanisë.

“Janë mbi 450 makineri në punë”, shkruante në profilin e tij një drejtor lokal në murin e tij në Facebook dhe ndjekësit e tij bënë thirrje që tani “dibranët duhet të mbështesin me votë Edi Ramën, jo Sali Berishën që i ka gënjyer tash sa vite”.

Por, përtej postimeve dhe imazheve që përcillen, një vëzhgim në terren është ajo që nuk përshkruhet përmes propagandës.

Korresponendët tanë kanë njoftuar se në Shupenzë kanë filluar punimet në urën ndërsa vazhdon puna me hapjen e trasesë drejt fshatit Gjoricë. Në Klos, përveç hapjes së tunelit 500 metra të gjatë, vazhdon puna edhe për hapjen e tunelit tjetër. Në tunelin e dytë punëtorët kanë hasur në një shpellë, e cila u mendua në fillim si një tunel i fshehtë që të çon në Kalanë e Petralbës, por një burim nga Instituti Arkeologjik i tha gazetës se ekspertët e saj e kanë vëzhguar tunelin, por ajo nuk ka të bëjë me kalanë. Thjesht është një çarje natyrore, një shpellë.

Ata që kanë filluar të parët të fitojnë nga avantazhet e rrugës në ndërtim janë banorët e fshatit Bastarit dhe fshatrave përreth, të cilët tani më kanë braktisur rrugën e vjetër, duke udhëtuar në trasenë e re të hapur buzë lumit të Tiranës, e cila të nxjerr të ura mbi lum afër Zall Dajtit, aty ku prej disa vitesh ka përfunduar një segment prej afro 5 kilometrash, i shtruar por i paasfaltuar.

Në zonën e Tiranës janë dy kantiere që po vazhdojnë punën, njëri i ngritur pranë lumit që vazhdon me hapjen e trasesë përgjatë lumit, ndërsa kompania ka hapur edhe një rrugë provizore që të çon te tunelet, ku është edhe kantieri i dytë. Te tunelet ka nisur puna për hapjen e



Në foto: Pamje nga kantieri i punës te dy tunelet e Qafë Murrizit. Gusht, 2018.



QEVERIA: 3.5 MILIONË EURO PËR MBIKQYRJEN E PUNIMEVE

Më 13 gusht Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë hapi një tender publik për “shërbime inxhinierike të pavarura për zbatimin e kontratës koncesionare/PPP për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e rrugës së Arbrit” me një vlerë 446 218 904 lekë, ose përafërsisht 3.5 milionë Euro. Tenderi është mbyllur për vlerësim më 31 gusht dhe pritet që brenda pak ditësh të shpallet fituesi. Qeveria po kërkon një kompani që së paku të ketë në stafin e tij mbi 15 inxhinierë me përvojë punë mbi 10-20 vite, të ndarë sipas 12 profileve inxhinierikë. Kompania duhet të ketë në staf një menaxherë projekti si dhe inxhinierë të ndërtimit, hidrologë, gjeoteknikë, tunelesh, elektrikë, mekanikë, gjeodet, e deri te inxhinierët dhe specialistë të sigurisë rrugore e ndërtimes civile. Afati i kontratës është 48 muaj, katër muaj më shumë se afati që kompania Gjoka Konstruksion do të mbyllë punimet.

të dy tuneleve. Një inxhinier i ri në kantier tha se punimet po ecin sipas planit. Terreni është i vështirë në fillim, ndaj po avancojmë hap pas hapi. Njëri tunel në kohën e këtij vëzhgimi kishte avancuar rreth 60 metra, ndërsa tuneli i dytë vetëm sa kishte filluar.

Duke pasur parasysh se punimet kanë nisur zyrtarisht në qershor, ajo që binte në sy ishte një volum i madh pune, por një punëtor i kompanisë Gjoka tha se puna këtu ka filluar para qershorit dhe se po punohet me turne, deri në 20 orë në ditë.

Në hyrje dhe dalje të kantierit nuk ka tabela informuese, siç ka qenë rutinë më parë, në lidhje me afatet e punimit dhe vlerën e projektit, përveç disa tabelave që kanë të bëjnë me sigurinë në punë të punonjësve.

Siç është njoftuar edhe më parë, rruga në tërësi do të jetë e kategorisë C2, përveç segmenteve Bllatë - Maqellarë që do të jetë e kategorisë E dhe rrugës lidhëse me Klosin që do të jetë e kategorisë F2. Kjo do të thotë që shpejtësia e lëvizjes në aksin kryesor do të jetë rreth 100 km/orë me minimum shpejtësie 60 km/orë, ndërsa në dy akset e tjera shpejtësia e projektuar e lëvizjes do të jetë 40-60 km/orë.

Gjerësia e rrugës e standardit C2 do të jetë 11 metra, prej të cilave 9.5 metra do të jetë e asfaltuar, e parashikuar me nga 1 korsi lëvizje në dy kahet me gjerësi 3.5 metra.

Në lidhje me hollësi të tjera të parametra teknikë të projektimit, ndërtimit dhe afatet, ne i kemi nisur një email kompanisë, por deri më tani nuk kemi marrë përgjigje. Me anë të komunikimit telefonik, kemi marrë një premtim se së shpejti do të kemi një vizitë tjetër në kantier nga ku do të marrin përgjigje shumë pyetje të lexuesve, optimistëve dhe dyshuesve, por deri atëherë mund të themi se punimet vazhdojnë.

BUJAR KAROSHI

Grehans Uka, djali me emër gjerman, shërben si guidë lokale për shumë të huaj që janë të pasionuar të ngjitjeve në mal, kryesisht nga zonat gjermanishtfolëse

reportazh

Dibra është një krahinë e pasur me kulturë, traditë, gastronomi dhe e bekuar me një natyrë që lë mbresa. Së fundmi, me produktin më të ri në turizmin e aventurës, High Scardus Trail, rajoni do të jetë një nga top destinacionet e turistëve në kërkim të adrenalinës. Turizmi malor është një nga potencialet e pashfrytëzuara, nëpërmjet të cilit do të hapeshin vende të reja pune dhe do të zbutej varfëria. Çfarë po ofron Dibra për turistët?

Nga Ledina LOGA / MONITOR

Në vapën mbytëse të këtij gushti në Tiranë, pjesa më e madhe e njerëzve do të rendnin drejt bregut të detit. Megjithatë falë gjeografisë, territori shqiptar ofron alternativa të ndryshme. Për të gjithë të pasionuarit e ecjeve në mal dhe pushimeve aktive ka një shteg të ri, High Scardus Trail, i cili është pak i eksploruar nga turistët dhe që shtrihet në tre shtete. Tre grupe të ndryshme u nisën njëkohësisht nga Tirana, Kosova dhe Maqedonia për t'u takuar në Dibër.

Nga Tirana për në Fushë-Bulqizë, ku ishte dhe ndalesa jonë e parë, u deshën 5 orë të mira rrugë (përfshirë këtu edhe pushimet gjatë rrugës). Shqipëria mund të jetë mbase i vetmi vend ku rrugët nuk maten me kilometra, por me orë. Përgjigjen për harresën dhe turizmin e vakët të kësaj krahine e kuptuam gjatë rrugës plot kthesa dhe të amortizuar që lidh kryeqytetin me verilindjen e vendit. Mbrëmjen e asaj nate do ta kalonim në bujtinën e Lulzim Hupit, një kullë e vjetër 220-vjeçare. Kulla, e ndërtuar prej Sul Hupit, një tregtar i famshëm i asaj krahine, ishte sjellë në formën e saj origjinale dhe restauruar me kujdes.

Edhe pse pronarët e asaj kulle jetojnë prej vitesh në Bulqizë, kulla është shndërruar në stacion për shumë turistë të huaj që vijnë të eksplorojnë rajonin. Nënë Sofia, 67 vjeçe, e cila po të jetonte në kryeqytet nuk do t'i pëlqente që ta thërrisim "nënë", është mikpritëseja në këtë bujtinë. Edhe pse së fundmi tregon se ka nisur ta ndiejë lodhjen e viteve, ajo ende nuk ka hequr dorë prej punëve të rënda të fshatit. Natën e kaluam aty. Në mëngjes nuk ishte i nevojshëm alarmi. Gjeli këndoi deri sa u zgjuam të gjithë, në orën 6:00. Sigurisht e zonja e shtëpisë ishte zgjuar shumë më herët. Në fshat nëse nuk zgjohesh me lindjen e diellit, vështirë të mbijetosh, aty nuk ka vend për dembelët.

Pasi hamë mëngjesin nisemi drejt Maqellarës, ku do takoheshim me guidat lokale me të cilët do të përshkruanim një pjesë të shtegut High Scardus Trail, i cili nëse bëhet i gjithi, parashikohet se zgjat rreth 22 ditë. Prej njësisë administrative të Maqellarës, që duhet thënë se është një ndër më të zhvilluarat në Qarkun e Dibrës, nisemi në drejtim të Popinarës, një fshat shumë i thellë malor. Rruga drejt Popinarës ishte e pashtuar me asfalt dhe shoqëruesit lokalë na treguan se në dimër, fshati bllokohet prej reshjeve të borës. Rrugët e shtruara me kalldrëm në brendësi të fshatit Popinarë shënuan shtratin e ecjes sonë në mal, ndërsa pika e mbërritjes janë bjeshkët e Hinoskës.

Lartësia e fillimit të marshimit nis në nivelin 1.190 metra mbi nivelin e detit. E gjithë rruga është parashikuar se zgjat rreth 6-7 orë, për të

Dibra tjetër, ajo e turizmit



Në foto: Bjeshka e Hinoskës. Foto: B.Karoshi

prekur pikën më të lartë Velivarin, në 2332 metër lartësi. Shtegu ka vështirësi mesatare dhe kërkon një përgatitje mesatare fizike. Të gjitha shtigjet prej Popinarës në Hinoskë janë të shënuara. Gjatë shtegut kishte burime të shumta uji dhe stane ku mund të pushonim gjatë ecjes. Guidat na shpjegojnë se në burimet e ujit, uji është shumë të ftohtë, me cilësi të lartë, i lehtë për organizmin dhe i pasur me kripëra minerale, të cilat bëjnë mirë për organizmin. Gjatë rrugës, grupi u desh të ndahej, një pjesë prej nesh e kishin të pamundur për të prekur pikën prej 2332 metër të Velivarit.

Piramida shërbente si pikë takimi me grupin që ishte nisur nga Maqedonia. Grupi që nuk kishte përgatitjen e duhur fizike ndoqi një shteg më të lehtë, e cila zvogëlonte distancën nga Popinara në Hinoskë, me rreth 3 orë. Pas ngjitjes për më shumë se tre-orë, guida që na shoqëronte drejt një shtegu më të shkurtër, na njoftoi se po i afroheshim postës turke. Kishim sërish rrugë për të bërë drejt Hinoskës, stanet e së cilës kishin filluar që të dukeshin në horizont. Gjatë verës, kullotat janë të mbushura me tufa bagëtish dhe stane.

Duhet të nxitojmë në rast se nuk duam që të na kapë stuhia në mal, në të kundërt do të duhet të presim në një nga stanet që çobanët kanë ngritur.

Për Aurorën, pjesë e grupit, kjo nuk është ngjitja e parë në male, megjithatë kjo ngjitje shënoi rekordin e saj më të lartë deri më tani, por jo më të vështirë. Për një shkallë vështirësie nga 1 në 10, ajo dha vlerësimin shtatë për shtegun nga Popinara në Hinoskë.

PARA PREJ BJESHKËVE

Në muajin gusht, bjeshka e Hinoskës është e pasur me mjedra, boronicë, luleshtrydhe të egër, por edhe me shumë llojshmëri bimësh mjekësore. Guida jonë shoqëruese na tregon se tashmë bjeshkët janë shndërruar në një burim mjaft të rëndësishëm ekonomik për të gjitha familjet e atyre zonave. Gjatë muajve të verës, familjet angazhohen për grumbullimin e bimëve mjekësore si sherbela, çaji i malit.

Bjeshka e Hinoskës ndodhet në juglindje të qytetit të Peshkopisë. Fshati më i afërt është Illica, rreth 1250 metër mbi nivelin e detit. Hinoska shtrihet edhe në anën e Maqedonisë. Piramida 10 është shenja kufitare ku ndahet territori i Republikës së Shqipërisë me Maqedoninë.

Dibra është shumë e pasur me bimë mjekësore dhe aromatike, ku numërohen rreth 80 lloje të ndryshme të cilat pasi mblidhen, përpunohen në rajon. Disa prej llojeve më të përhapura janë sherbela, agulice, murrizi, dëllinja e kuqe, trëndafili i egër, bishtkali,

trëndafili i egër, hithra, molla e egër. Mbas përpunimit, këto bimë tregtohen në vende të ndryshme të BE-së si në Gjermani, Spanjë, Francë, Greqi dhe Itali, si dhe në SHBA.

RIKTHIM NË HINOSKË

Adi Fida e kalon pjesën më të madhe të vitit midis Italisë, ku punon sezonalisht dhe Shqipërisë. Ai ka vendosur që në tokat e të parëve të ngrejë shtëpiza të vogla, me dhoma komode, për të gjithë turistët që përshkojnë shtegun High Scardus Trail. Në bujtinën Fida u akomodua edhe grupi. Familja e madhe Fida, zhvendoset gjatë verës në Bjeshkët e Hinoskës.

Rryma elektrike nuk ka shkuar ende në fshat dhe Adi, çdo mbrëmje vendos në punë një gjenerator të energjisë elektrike, e cila do të sigurojë rrymë që të paktën të karikohen telefonat. Ndërsa për pajisjet e tjera, ai e siguron rrymën nëpërmjet disa paneleve modeste diellore. Adi shpreson që me zhvillimin e turizmit në këtë zonë malore të zgjerojë dhe aktivitetin. Kërkon të bëjë më shumë investime, mirëpo burimet e veta financiare nuk ia mundësojnë këtë gjë për momentin.

Qëndrimi në një fshat malor, ku valët e telefonave depërtonin me vështirësi dhe duhet të menaxhoje me nikoqirllëk baterinë e mbetur të telefonit na dha mundësinë që të shijonim jetën aktive. Edhe pse kishim bërë më shumë se

pesë orë rrugë në këmbë për të mbërritur nga Popinara në Hinoskë, grupi nisi të eksplorojë përreth fshatit dhe gjithsecili u mundua të shkrepe foton më të bukur të perëndimit të diellit, jo buzë detit, si pjesa më e madhe, por në lartësinë e maleve.

Me uljen e diellit përtej maleve, edhe temperaturat shënuan vlera të ulëta. Megjithatë, atje në mal, ka një zgjidhje për çdo gjë. Një filxhan i ngrohtë me çaj mali të mbledhur nga bjeshkët, si dhe optimizmi i familjes Fida për t'u marrë me turizëm në atë zonë është zgjidhje për të ftohtin.

Pasi gjithsecili shkoi në dhomë për të fjetur, qetësinë e prishin të lehurat e qenve të stanit, të cilat u ndoqën nga ulërimat e ujqërve. Sikurse dhe na shpjeguan guidat, shpesh afrohen pranë zonave të banuara. Bjeshkët e Hinoskës janë të pasura me gjallesa të egra, nga zvarranikët, te lepujt e egër, dhelprat dhe ujqërit, arinjtë etj.

Të nesërmen grupi vazhdon sërish rrugën. Kësaj radhe me në është bashkuar dhe grupi nga Maqedonia, të cilët ndryshe nga ne, ka në përbërje të tij vetëm guida profesionistë. Nga Hinoska, deri në fshatin më të afërt ku ka rrugë makine, e cila është e paasfaltuar, rruga zgjat rreth 1 orë. Në fshatin Illicë na presin makinat që do të na çojnë drejt qytetit të Peshkopisë. U deshën rreth 45 minuta të përshkuara me makinë që rrotat të preknin më në fund asfaltin.



Një grup turistësh në malin e Velivarit



Kulla hupi ne Bulqizë
Foto: Lulzim Hupi
Facebook



Perëndim në Hinoskë

GUIDA E HINOSKËS

Për të gjithë ata që kërkojnë të bëjnë shtegun e Hinoskës, i cili për ata që nisen nga Tirana zgjat tre ditë dhe me fjetje në tenda, kostot për këtë udhëtim janë rreth 40 euro.

Ky shteg është i nivelit të moderuar dhe zgjat rreth 7 orë ecje në mal. Hartuesit e programit të guidës në Hinoskë sugjerojnë se pjesëmarrësit në udhëtim duhet të kenë me vete kapele, duke qenë se dielli është i fortë në male dhe një pjesë e shtegut kalon nëpër livadhe ku mungojnë pemët për hije, syze dielli, xhup dimëror pasi temperaturat në darkë janë të ulëta, atlete të përshtatshme për ngjitje malore, veshje sportive, elektrik dore, duke qenë se në rryma elektrike mungon, bluza për t’u ndërruar dhe një çantë shpine.



Kufiti mes dy shteteve

GUIDA E KORABIT

Për të pasionuarit e ngjitjeve në mal ngjitja në majën më të lartë të Shqipërisë, në një program që zgjat tre ditë kushton rreth 50 euro (për grupet që nisen që nga Tirana). Ngjitja deri në pikën më të lartë dhe zbritja zgjat rreth 7 orë dhe sipas ekspertëve, niveli i vështirësisë është mbi mesatar. Gjatë rrugës turistët ndalojnë edhe në Ujëvarën e Korabit, monument natyre. Të vizitosh Korabin duhet të kesh parasysh se natyra është e egër dhe e paprekur nga dora e njeriut. Mbi lartësinë 250m presioni i ajrit është i ulët dhe lehtëson mushkëritë gjatë frymëmarrjes. Burime të shumta gjatë gjithë shtegut, por guidat këshillojnë të mos pihet ujë direkt nga burimi, pasi krijohen plasaritje të buzëve. Gatimet në Bjeshkët e Radomirës janë 100% bio. Banorët e Kalasë së Dodës janë njerëz të besës, bujarë dhe mikpritës.



Dibra e Madhe parë nga mali i Velivarit

ÇFARË MUND TË VIZITOSH TJETËR?

I gjithë rajoni i Dibrës ka pafund kulla të hershme, të cilat vitet e fundit po restaurohen dhe po bëhen të prekshme për të gjithë turistët. Gjithashtu në Dibrë mund të vizitohen dhe objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike si Ura e Vashës, e cila ndodhet mbi lumin Mat në lindje të rrugës së fshatit Guri i Bardhë. Ura është ndërtuar në fillim të shekullit të 19 me gurë lumi, me gjatësi 11 metër dhe gjerësi 2.8 metër. Por, nuk mungojnë as objektet e kultit, një prej të cilave është edhe Kisha e Shën Mitrit e ndërtuar në vitin 1892, e shpallur Monument Kulture në vitin 2007. Natyra është treguar bujare me rajonin e Dibrës. Një aktivitet tjetër me mjaft interes nga turistët është edhe eksplorimi i lumenjve dhe kanioneve që kanë krijuar ata gjatë rrjedhës së tyre.

USHQIMI, PLOT SHIJE

Ushqimi është një ndër pikat e forta të turizmit të aventurës. Në përbërjen e grupit që u nis drejt Bjeshkëve të Hinoskës kishte dhe gjermanë, të cilët kishin kuriozitetin që të provonin çdo gjë që shtrohej në sofrën e ngrënies dhe të pyesnin se me çfarë ishin gatuar. Nga qulli me pulë, gatim tradicional i zonës së Bulqizës, te mishi i qengjit i pjekur në saç, turshitë, djathi, kosi dhe qumështi i bagëtive që kanë kullotur mbi 2000 metra lartësi, te sheqerparja e famshme e Dibrës, janë një arsye më shumë për të vizituar rajonin e Dibrës.

Edhe pse gatime relativisht të thjeshta në përbërje, (miell, gjalpë apo sheqer në përbërje), gatimet e zonës janë plot shije dhe mbi të gjitha organike, janë një nga pikat e forta të kësaj zone. Padyshim që pjata kryesore në sofrën dibrane janë Jufkat e Dibrës, gatimi tradicional i dibranëve. Jufkat janë makarona të prodhuara në mënyrë artizanale nga punishtet që kanë ruajtur traditën e hershme të prodhimit, të gatuar me lëngun e mishit të pulës.

SHTEG I RI, MUNDËSI ZHVILLIMI PËR NJË RAJON

High Scardus Trail kalon në tre shtete dhe është ndër shtigjet më të gjata në rajonin e Ballkanit. Shtegu ka gjatësi 495 kilometra dhe përshkon malet në kufij me Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë. Shtegu kalon përmes gjashtë parqeve kombëtare, dy në Maqedoni, një në Kosovë dhe tre parqe në Shqipëri. Shtegu ka shtigje të tjera të panumërta, të cilat lidhin shtegun kryesor dhe me zonat e banuara. Pika e fillimit e këtij shtegu është mali i Sharrit (ana e Maqedonisë) dhe përfundon në rajonin e Prespës në Shqipëri. Për t’u përshkuar i gjithë shtegu, duhen më shumë se 20 ditë, kohëzgjatje 3 herë më e madhe se kohëzgjatja mesatare e udhëtimeve aventurore.

Ky produkt turistik malor është rezultat i projektit Perspektiva e së Ardhmes nëpërmjet Turizmit Malor, të implementuar prej GIZ. Qëllimi kryesor i projektit ishte që të përmirësojë mundësitë e punësimit në sektorin e turizmit në rajonin kufitar midis Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë nëpërmjet zhvillimit dhe promovimit. Zhvillimi i këtij produkti turistik malor përfshin: shënjimin e 33 shtigjeve për ecje në 5 masive malore që shtrihen në kufijtë e tri shteteve, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni; identifikimi, përzgjedhja dhe përfshirja e strukturave akomoduese dhe të shërbimit të ushqimit përgjatë shtegut, si dhe të pikave që mund të ketë interes nga turistët, si trashëgimitë kulturore dhe natyrore të rajonit.

Anica Palazzo, drejtuese e projektit të GIZ për të tre shtetet, tha se ky produkt i ri turistik, i cili bën bashkë tre destinacione ka hapur rreth 100 vende të reja pune. Në shtegun High Scaruds Trail, i cili nis që nga malet e Sharrit dhe përfundon në jug në Liqenet e Prespës, fillimisht janë evidentuar nevojat për akomodim dhe më pas janë mbështetur me grante rreth 17 subjekte akomoduese. 35% e financimit, sipas zonjës Palazzo, ka ardhur nga vetë njerëzit e zonës.



Foto. B.Karoshi

“Njerëzit e atyre zonave kanë filluar të besojnë që nëpërmjet shërbimeve turistike mund të sigurojnë jetesën, shtoi drejtuesja e projektit të GIZ. Gjatë trajnimeve janë bërë mbi 140 aplikime nga Shqipëria dhe Maqedonia. Për zëvendësministrin e Turizmit dhe Mjedisit, zotit Hajrulla Çeku, shtetet tona kanë mundësi që të rrisin konkurrueshmërinë nëpërmjet këtij lloj turizmi, ndërsa shtoi se bashkëpunimi mes vendeve është shumë i frytshëm.

“Diversifikimi i ekonomive lokale, qendrave informative, turizmit do të shërbejë si instrument efektiv për hapjen e vendeve të reja të punës në zonat rurale dhe të zhvillimit ekonomik dhe zbutjen e varfërisë, tha Çeku.

Sipas tij, zona e Dibrës ka një strategji për të shfrytëzuar potencialin turistik, traditat, festat dhe mikpritjen. Për të, Dibra do të jetë shumë shpejt destinacioni kryesor i turizmit në rajon e Ballkanit.

DIBRA, JO VETËM PËR TURIZËM MALOR

Për zotin Muharrem Rama, kryetari i Bashkisë së Dibrës, turizmi është një sektor që në rajon ka shumë potencial. Zhvillimi i turizmit në zonën e Dibrës do të shënojë një epokë të re, veçanërisht për sa i përket turizmit malor në vend. Z. Rama shtoi se numërohen rreth 23 liqene akullnajore në Dibrë. Por rajoni është i pasur me kulturë, folklor, ka njerëz mikpritës. Sipas z. Muharrem zhvillimi i turizmit do të përmirësohet edhe kushtet ekonomike të familjeve në qarkun Dibrë.

Përpos turizmit malor, Rama nuk la pa përmendur dhe turizmin shëndetësor. Prej vitesh Dibra është destinacion për të sëmurët kronikë që përdorin llixhat kurative të Dibrës. Llixhat ndodhen brenda qytetit të Peshkopisë, në lindje të tij. Kompleksi balnear kurativ i ujërave termale të Peshkopisë ka 44 kabina individuale dhe disa kabinete terapeutike, të cilat përfshijë trajtime të baltës sulfurore, fizioterapisë dhe aerosalterapisë.

Për Grehans Ukën, guidë lokale, turizmit të Dibrës i mungon tregu me produkte tradicionale të Dibrës. “Jufkat dhe sheqerparja e Dibrës janë të njohura, por nuk promovohen, argumenton ai për “Monitor”. Gjithashtu, ai thotë se mund të promovohen më shumë veglat tradicionale që prodhojnë kostumet e zonës, apo festat tradicionale, një prej të cilave është edhe Oda Dibrane. Ndërkohë që ka edhe festa që mund të kthehen në rituale, siç është Festa e të Vjelave.

MUNDËSI PËR TË RINJTË E ZONËS

Grehansi punon si guidë për më shumë se dy vite në rajonin e Dibrës. Ai ka studiuar për Ekonomiks në Tiranë dhe kur përfundoi studimet vendosi që të kthehej në qytetin e lindjes, Peshkopinë, me shpresën se do të punësohej. Por mundësitë që ofron qyteti i Peshkopisë janë të pakta për të rinjtë. Grehansi nuk po gjente punë në profesionin që kishte studiuar dhe në atë kohë ishte bërë disi pesimist.

Ai u bë pjesë, edhe pse jo fort optimist, në një prej trajnimeve që GIZ bën në këto zona. Në ngjitjen e tij të parë drejt majës më të lartë të vendit, Korabit, ai u kujton se është detyruar që të kthehet pas. Grehansi kujton se gjatë ngjitjes e kapi stresi dhe prej ndryshimit të presionit të ajrit dhe trupit të pakalitur me të tillë aktivitet pati gjakrrjedhje nga hundët. Mirëpo nuk u dorëzua.Tani mund të kalojë dhe një muaj pa u kthyer në shtëpi, madje kur kalon më shumë se tre dite në shtëpi ndien mungesën e maleve.

Grehansi, djali me emër gjerman, shërben si guidë lokale për shumë të huaj që janë të pasionuar të ngjitjeve në mal, kryesisht nga zonat gjermanishtfolëse. Gjatë gjithë përvojës si guidë, situata më e vështirë ka qenë aksidenti i një turisti australian dhe në përgjithësi vështirësia e punës së tij lidhet me faktin se ka në përgjegjësi jetën e njerëzve që merr përsipër të shoqërojë në male.

“Disa prej turistëve kërkojnë më shumë aventurë, duan shtigjet më të rrezikshme për të ndier adrenalininë më të fortë”, – tregon ai për “Monitor”. Të ardhurat në këtë profesion të dytë që ka zgjedhur janë më të larta në krahasim nëse do të punonte si ekonomist në Dibrë. Puna është më intensive gjatë pranverës dhe verës. Aktualisht ai punon si guidë lokale, por shpreson që të bëjë emër shumë shpejt dhe të krijojë agjencinë e tij turistike. Të ardhurat e tij mesatare mujore, duke llogaritur dhe bakshishet në një muaj të mirë, llogariten mesatarisht 700 euro. Një guidë lokale paguhet mesatarisht 25-30 euro në ditë, ndërsa guidat nga Tirana paguhën rreth 50 euro në ditë. Tani së afërmi, Grehansi duhet të përgatitet edhe për provimin e licencimit, me marrjen e të cilit ai do të paguhet më shumë.

Turizmi po kthehet në një mundësi të artë për shumë të rinj të zonës së Dibrës. Labinot Murrja, ka vetëm një vit që merret me ngjitjen e maleve. Ai shkon pas guidave të certifikuara për të mësuar profesionin. Ai kryen kryesisht shoqërimin e turistëve në zonën e Luznies, e cila është e shtrirë në bregun e Drinit të Zi. Aktualisht është punonjës i Bashkisë Dibrë, arkivist dhe finacier, mirëpo prej një viti gjatë fundjavave punon si guidë.

Aktivitetet që mund të bëjnë turistët janë të shumtë. “Mund të bësh hiking, rafting, kamping, në kanionet e Drinit. Ndërsa për të pasionuarit e sporteve ekstreme kanë disa shpella, shumë të thella dhe vetëm “të çmendurit” mund t’i vizitojnë. Kemi mundur t’i eksplorojmë deri në 20 metra” – tregon Murrja.

Ai po mendon që ngrejë një fushë për kamping në fshatin e tij Luzni, ndërsa për sa i përket ngritjes së një bujtine e ka të pamundur që ta përballojë financiarisht, vetëm në rast se merr mbështetje financiare nga programet mbështetëse të turizmit në zonat rurale.

Profesioni i guidës ka qenë zgjedhje edhe për Vladimir Markun, ish-mësues i anglishtes. Prej gjashtë vitesh, Marku bën guidën në të gjithë Shqipërinë, por më së shumti në zonën e Lurës. Nga feedback-u i turistëve Marku ishte guida më popullore e të gjithë rajonit. Guida kërkon gjithashtu talent, të cilët disa persona si Marku e kanë të lindur. Në zonën e Lurës Marku ka një bujtinë ku pret të huajt. Pjesa më e madhe e turistëve mund ta gjejnë bujtinën edhe nëpërmjet faqeve popullore si Air BNB apo Booking.com.

MES SHQIPËRISË DHE MAQEDONISË

Jovan Jovanoski është guidë ndërkombëtare nga Maqedonia. Këtë profesion ka nisur ta bëjë që prej fillimit të vitit 2009 dhe aktualisht bashkëpunon edhe me agjencitë shqiptare dhe bën ture ku përfshihen të dy vendet. Jovanovski thotë se punon më shumë më të huajt, pasi edhe prej maqedonasve, sikurse dhe shqiptarëve nuk ka shumë interes. Ai mendon se do të duhen edhe shumë vite kur këto sporte të bëhen popullore edhe në vendet tona. Disa prej sporteve që ai bën së bashku me turistët janë: hiking, cycling, trekking, kayaking, cycling përgjatë liqenit të Ohrit, etj.



Foto. B.Karoshi

“Fshati që nuk ka fshat mbi krye”, ka gjithë Dibrën në pëllëmbë të dorës, por dora e qeveritarëve të Dibrës për të nuk është shtrirë kurrë.

reportazh

Nga Samet ZAGRADI

Zimuri, fshati më i largët të Njësisë Administrative Tomin, ndodhet 1 orë larg me makinë nga qendra e qytetit të Peshkopisë. Rruga për të shkuar atje kalon është e vështirë, e paasfaltuar dhe kalon përmes një terreni tepër të thyer. “Fshati që nuk ka fshat mbi krye”, siç i thonë vendasit, kufizohet me Shimçanin dhe Bahutet. Kur ngjitesh në fshat sytë shikojnë një panoramë unike, ku qyteti bashkë me fshatrat duken si në pëllëmbë të dorës.

Zimuri duhet të ishte një fshat i zhvilluar, por realiteti tregon tjetër gjë. Sot ky fshat që ngrihet jo larg qytetit të Peshkopisë ofron shumë pak për banorët e tij. Dikur këtu jetonin rreth tetëdhjetë familje dhe sot kanë mbetur rreth njëzet. Nuk është e vështirë të mendosh përse janë larguar: infrastruktura e vështirë, rruga e rrënuar, papunësia... Shumë nga këto banorë janë larguar drejt Tiranës e Durrësit, por një pjesë e vogël kanë zgjedhur Peshkopinë, duke u përpjekur të mos lënë tokat djerrë. Dhe gjithashtu u ofrojnë fëmijëve mundësi për shkollim.

“Nuk ka rrugë, nuk ka të ardhme në fshat”, thotë Nderim Kamberi, një i ri nga ky fshat, i cili pasi mbaroi Universitetin, ka emigruar pasi, edhe nëse siguron një punë në qytet, paratë nuk i dalin as për rrugën.

“Të gjithë po ikin duke lënë pas fshatin dhe tokat djerrë. Këtu rrezikohet dhe buka e gojës, jo më të llogarisësh një jetesë normale. Nëse ke një rast urgjent, një të sëmurë, duhet të paguash njëzetë mijë lekë të vjetra për të shkuar në spital”, tregon Nderimi. Furgoni i linjës shkon vetëm në rrugë: një në mëngjes dhe kthimi pasdite. Bileta kushton 100 lekë, shumë e cila mund të jetë e papërfillshme, por për fshatarët e Zimurit, ku të ardhurat janë minimale, ajo është shumë e konsiderueshme.

EKONOMIA E FAMILJEVE MES PATATES DHE BIMËVE MEDICINALE

Emigracioni dhe bujqësia janë burimet kryesore ekonomike për këto njerëz. Ndi-hmën ekonomike e përfitojnë shumë pak familje.

Zimuri ka një klimë të ftohtë, duke qenë se ndodhet në një lartësi të konsiderueshme mbi nivelin e detit. Zimur, sipas vendasve, do të thotë vendi “ftohtë”. Patatja dhe mollët janë pothuajse të vetmit produkte që prodhohen në tokat e ku më pas me vështirësi të shumta mundohen ti shesin për të mbijetuar deri në vitin tjetër.

Mungesa e tregut dhe futja e patates nga jashtë, ka bërë që shpesh herë dhjetëra ton të hidhen në përrua, bashkë me mundin e një vere të banorëve të kësaj zone, pa llogaritur këtu edhe shpenzimet për pesticide dhe farë.

“Vitin që shkoi, - tregon Qazim Shkurta, 60 vjeç, - mezi i kam shitur patatet me një çmim shumë të lirë, duke mos nxjerrë as paratë e ujit dhe pesticideve. I gjithë munda vajtë dëm. Këtë vit kam mbjellë vetëm për përdorimin e familjes time”.

Zimuri, fshat i harruar



Pamje nga Zimuri. Fotot: B.Karoshi

Bimët medicinale janë një alternativë tjerë ku fëmijë, gra, burra dhe pleq, në pikë të vapës drejtohen drejt bjeshkës së Gramës. Punojnë gjashtë muaj për të jetuar, gjashtë të tjera duke shitur bimët mjekësore, për të mbuluar shpenzimet minimale.

Varfëria në këtë fshat duket qartazi, mjafton të shohësh shtëpi të vjetra të braktisura dhe të rrënuara e në mëndje të vijnë filmat e vjetër të periudhës komuniste. Në të gjithë fshatin ndihet një atmosferë e zymtë, e cila transmetohet që nga banori i parë e deri tek i fundit që takon në këtë fshat. Kur hyn në fshat të krijohet përshtypja se gjithçka është e braktisur, por tymi i sobave të drurit në ballkonet e atyre pak shtëpive tregon se ka njerëz që jetojnë në fshat. Patkojt e kuajve të ngarkuara me barë ndiqen nga fëmijë të vegjël dhe prishin sadopak qetësinë dhe zymtësinë. Të varfër, të harruar dhe të mbetur në mëshirë të fatit këta banorë ngushëllohen me faktin që një xhami e re po u ndërtohet e do të kenë një vend ku të luten për një të ardhme më të mirë për ta dhe fëmijët e tyre.

TURIZMI, PAK BESIM SE SJELL ZHVILLIM

Investimet në këtë fshat nuk mbahen mend kur mund të kenë ndodhur. Në njërën anë skamja në tjetrën mungesa e investimeve ka bërë që ky komunitet dhe kjo zonë të mos tentoj aspak ndryshimin. Fshati Zimur, me pak investime në rrugë, kthehet një atraksion të mirëfilltë të turizmit malor. Bjeshkët e Gramës, rreth një orë e gjysmë larg, me një bukuri të pashoqe, qëndrojnë të pazbuluara nga turistët për shkak



Nga Grama, Zimuri e më pas në darkë në shtëpinë pritëse “Elezi”, është një tur që lë mbresa tek vizitorët.
Foto:Facebook/KorabiRestHouse

të mungesës së infrastrukturës. Rruga e papërshtatshme dhe mosreklamimi i këtyre resurseve, bën që turistët të jenë të paktë në këtë zonë. Relievi i thyer që ka ky fshat ka filluar të shërbejë si vendndisje për të pasionuarit e aeronautikës. Ushqimet tërësisht bio dhe të vështira për tu gjetur në disa prej fshatrave të tjerë, gjenden pikërisht në këtë zonë, dhe pak kohë më parë vetë banorët e kësaj zone menduan të investonin për turizmin malor.

Për më pak se 2 kilometër poshtë fshatit, në Bahute ndodhet shtëpia pritëse “Elezi” e saponduar, e cila është e gatshme të presë turistët. Fluturim Elezi, menaxheri i kësaj shtëpie pritëse, thotë se “bjeshkët e Gramës pëlqehen mjaftë mirë nga turistët vendas dhe të huaj”. Nga Grama, Zimuri e më pas në darkë në shtëpinë pritëse “Elezi”, është një

tur që lë mbresa tek vizitorët, pasi bukuritë natyrore të këtij vendi janë krejt të veçanta. “Këta turistë, thotë Fluturimi, marrin me vete edhe produkte nga fshatarët, duke u sjellë sadopak përfitime.

Banorët e kësaj zone gjithmonë i ka shoqëruar një atmosferë harmonie me njëri-tjetrin. Bujaria dhe mikpritja e këtyre njerëzve vihet re menjëherë sapo takon personin e parë në fshat. Turistët e paktë që e kanë vizituar kanë mbetur të kënaqur. Por banorët nuk besojnë akoma se turizmi mund të jetë një mundësi zhvillimi. Po tu thuash atyre se “kanë një fshat të bukur”, nuk e marrin seriozisht. Ndaj duhet një një punë e madhe për t’i bindur banorët se ia vlen akoma të jetosh në Zimur. Dhe nuk kanë faj: 28 vjet pas ndryshimit të sistemit, shteti për ta kujtohet veç në ditën e votimit.



Një fragment i rrugë që lidh fshatin me qytetin e Peshkopisë. Fotot: B.Karoshi



Fotot: B.Karoshi

Mes mrekullisë së 7 liqeneve dhe monumenteve të natyrës, mes pyjeve e luleve të rralla si askund tjetër, Lura është vendi ku në çdo troje e gur ku shkel, ka një histori për të treguar.

Shën Mëria në Lurë, një festë si askund tjetër

Nga Erion KRISTO

LURA JU PRET!

Mes mrekullisë së 7 liqeneve dhe monumenteve të natyrës, mes pyjeve e luleve të rralla si askund tjetër, Lura është vendi ku në çdo troje e gur ku shkel, ka një histori për të treguar.

Dhe ne sot, do t'ju tregojmë një histori që nisi në këtë fundgushti, me festën e Shën Mërisë në Lurë.

Ajo lidhet me traditën e vjetër të lurasve për të festuar ditën e shenjtë katolike, një organizim i përbashkët me myslimanët që nuk mund ta hasësh as në shtetet më liberale për lirinë e besimit.

Madje, në Kishën e rindërtuar të Shën Mërisë në Lurë, edhe kujdestari i saj është një mysliman.

Harmonia fetare në Lurë është mbase vlera më unike e këtyre banorëve, që nën një çati shtëpie kanë banuar dy vëllezër me besime të ndryshme dhe gatimi bëhej veçmas në enë për myslimanët.

Ndaj, në respekt të këtyre traditave, në Kishën e Shën Mërisë mbërriti edhe Dom Gjergj Meta, së bashku me disa motra katolike, që mbajtën një meshë me këtë rast.

Por festa më e madhe u bë jashtë saj, në qendër të Lurës.

Një emocion i jashtëzakonshëm për banorët, pasi pas 3 dekadash thuajse edhe në heshtje ekzistence, Lura “u pushtua” nga identiteti i vërtetë.

Këngë e valle autentike, vargje për Lurën, identifikimi dhe nderimi i figurave historike si heronjtë e vrarë gjatë luftrave apo përkujtimi i të madhit Dom Nikollë Kaçorri, nënkryetar i Qeverisë së Parë Shqiptare, ishin vetëm disa nga aktivitetet që i dhanë jehonë këtij vendi të harruar në 30 vjet.

Lura ka dhënë heronj në luftë, por edhe mend.

Shumë beteja janë fituar në sajë të meçurisë Lurjane dhe ajo më e famshmja që njerëzit e kujtojnë për legjendë, por qenë fakt është e vërtetë; është “Historia e 300 duvakëve”, ku pashai u kërkoi 300 nuse të bukura dibranëve dhe ata nën këshillimin e pleqve të Lurës u dhanë 300 djem të veshur me duvakë, ku nën to fshehën shpatat dhe e shpartalluan ushtrinë turke.

Lura ju pret më shumë se kurrë!



Ansambli Lura, ringritur me mbështetjen financiare të Unionit Lura. Foto marrë nga www.unionilura.al

Lura shtrihej poshtë shumë e bukur. Pothuaj dhjetë fshatra. Historitë nuk mbaronin. Ky vend i vogël, i fshehur mes malesh, kishte prodhuar shumë histori... Por ndërkohë natyra po bënte të vetën. Bota bimore po përtërihej. Aty ka një florë jashtëzakonisht të pasur.

Dhe, kjo histori e re e promovimit të vlerave lurjane, vetëm sa ka filluar, falë themelimit të UNIONIT LURA, nga një grup intelektualësh të zonës, që kanë marrë vetë në dorë të ardhmen e saj.

Unioni Lura, përveç organizimit të festimeve çoi në Lurë surprizën e shumëpritur: Themelimin e Ansambli Lura.

Gjithashtu, Unioni shpalli një vendim të rëndësishëm për rikthimin e traditës së ruajtjes së pyllit me bazë komunitare, vendim, i cili gjeti një mbështetje të madhe tek të gjithë.

Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë, ka thënë dikur i madhi Gjergj Fishta.

Dhe UNIONI LURA po bën gjithçka tashmë që Shqipëria të shihet përmes syve të Lurës.

MBRESA NGA UDHËTIMI IM NË LURË, NË GUSHT 2018

Më merr në telefon Hekuran Vladi, miku im. Se ç'më thotë ca gjëra, që më kapën të papërgatitur. Kalojnë ca ditë dhe e mblodha mendjen. Do niseshim për Lurë.

U nisëm herët. Makina plot me njerëz dhe gjëra. Fuoristradë e lartë. Vetëm ajo mund të kalonte. Rruga shume e gjatë dhe e keqe. Më e keqe sesa rruga e Lurës, që zgjati dy orë, ishte rruga Perlat - Rrëshen. Kishte gropa të papritura, që t'a shkatërronin makinën. Çudi, kjo rrugë s'e ka njohur rilindjen, po ndoshta në mandatin e tretë.

Më në fund mbërritëm në Krej Lurë. Aty bëmë fotot e para me delet. Unë dola me një dash. Se jam dhe shenjë e dashit. Apo ishte cja? Humor. U bëmë Bagëti e bujqësia ne qytetësit. Ishte ndjenjë e bukur.

Shkuam në Hotel. Lura shtrihej poshtë shumë e bukur. Pothuaj dhjetë fshatra. Historitë nuk mbaronin. Ky vend i vogël, i fshehur mes malesh, kishte prodhuar shumë histori. Gjate viteve demokratike ishin prerë pishat dhe ahet afro 100 metra të lartë. Por ndërkohë natyra po bënte të vetën. Bota bimore po përtërihej. Aty ka një florë jashtëzakonisht të pasur.

Thënia ime nr. 1: Zoti paska hedhur shumë natyrë këtu. Ju mund ta ndihmoni punën e Tij. Ky është një vend energjik.

Shkuam te Bujtina e Llesh Doçit. Aty hëngrëm kos me boronica dhe mjaltë prej vërteti. Skënder Doçi, elektrikist, nga Lura,

Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë, ka thënë dikur i madhi Gjergj Fishta. Dhe UNIONI LURA po bën gjithçka tashmë që Shqipëria të shihet përmes syve të Lurës.

që jetonte në Lezhë, më tregoi një pafundësi historish dhe humoresh, që janë pjesë e jetës dhe duhen bërë pjesë e turizmit. Por, ai më ktheu besimin te fjala. Njerëzit e Lurës nuk janë shquar si punëtorë, por si gojëtarë.

Thënia ime nr. 2: Lurianët kanë pasur mend për vete dhe për të tjerët.

Ata kishin patur pleqësi. Dhe pleqtë e tyre shkonin për të zgjidhur çështje dhe tjetërkund, sepse ishin shumë të zgjuar.

Skënderi me ndriçoi edhe për bashkëjetesën fetare. Në një shtëpi jetonte muslimani dhe katoliku. Pasuri tjetër e Lurës.

Thënia ime nr. 3: Lurianët nuk i ka përdorur feja, por ata e kanë përdorur fenë.

Darkë e madhe, ku kishte dhe plot gra e vajza të Ansambli Lura, që rilindi nga Unioni Lura. Këngë trimërie dhe dashurie. Çuditërisht më pëlqyen shumë. Më vunë në krye të tryezës. Dolla pa fund...si në Vlorë.

Gjumë. Ajër i pastër.

Të nesërmen festa e Shën Mërisë. Dt. 26. Lurianët e festonin më vonë. Në komunizëm festohej festa e Lurës, që në fakt ishte festë fetare. Po, kjo ishte zgjuarsia.

Mbajta fjalim para qindra Lurianëve. I ngrita në ajër, atje ku e meritonin.

Thënia ime nr. 4: Pasuria më e madhe e Lurës jeni ju dhe familjet tuaja.

Se ju e dini si jam unë. Lura më dhuroi dashuri pa fund. Respekt pa fund.

Në drekën zyrtare, ku kishte dhe gra, prapë u ngritën mirësi për mua. Prapë fjalim.

Aty thashë thënien nr. 5: Ta bëjmë Lurën Disneyland, parajsën e fëmijëve.

U kthem. Natë. Tmerr rruga. Mbërritëm shëndoshë e mirë.

Thënia nr. 6: Duhet kërkuar jeta e bukur.

Këtu mbaroi aventura luriane, me pengun që nuk i pashe liqenet. Por duhet një shtysë për të shkuar prapë. Falë Unionit Lura dhe miqve, do kemi raste përsëri.



Me të zotin e Bujtina “Oxhaku i Doçit” në Lurë, një mikpritës i rrallë, Llesh Doçi. Këto enë përdorehin për ushqimin e muslimanëve, që ata të mos hanin me enët e katolikëve. Lura është një shembull unik i bashkëjetesës fetare. Një vlla ishte musliman, tjetri i krishterë. Jetonin në një shtëpi. Respekti për njëri-tjetrin ka qenë absolut. Gjen dhe kund tjetër bashkëjetesë, por jo si në Lurë. Lurianët e kanë përdorur fenë dhe nuk janë përdorur prej saj. (Foto: Erion Kristo / Facebook)



Pamje nga Lura / Facebook/ketumblihdendibranet

Një ditë në Prat, aty ku festojnë banorët e Katër Grykëve



Pamje nga festa në Prat / Facebook/katergryket

Nga Mevlud BUCI

NJË FTESE NGA TOFIK TOTRAKU

Natën e 20 majit 2018, ditën kur do të festonin Katër-Grykët e Dibrës festën pagane të Shënkollit në Prat, rreth orës 12.00 të natës, më ra zilja e telefonit:

-Përshëndetje! Jam djali i Mehmet Totrakut. Uroj që ke kthyer në vendlindje!

-Faleminderit dhe ju përgëzoj o Latif!

-Jo, nuk jam Latifi. Jam djali i vogël i Mehmetit, jam emigrant në Itali. Nuk më njeh mua, jam Tofiku. Dua që nesër të vini me neve në Prat. Kam ardhur bashkë me shokë, me bijtë e Menës për të festuar. Jam në Lukan, në kullën e Ramazan Totrakut.

U befasova dhe u gëzova. Ku t'i gjejmë ata djem si Tofik Mehmet Totraku, të cilët kanë prova fjale, prova jete, prova djerse? Së bashku me vëllain e madh, Latifin, ka filluar muret e rrethimit për të ndërtuar shtëpinë e re në Lukan, në mes të një lëndine, aty ku janë rrënojat e gjyshërve të vet. Të dy punojnë në Itali, banojnë në Tiranë, por zemrën dhe mendjen e kanë në vendlindje, në Lukan, rrëzë Runjës shekullore.

Mëngjes! 20 maj 2018. Në Lunarë, vendin ku ndodhet qendra gjeografike e Katër-Grykëve, vijnë plot makina nga Tirana, Shkodra, Lezha, Mati, nga treva të ndryshme të atdheut e nisen drejt Pratis, drejt Livadhit të Gjatë, atje ku do të festohet festa pagane e Shënkollit. Që kur ishte kryetar komune i rnderuari Xhemal Delishi, çdo vit më 20 maj Katër-Grykët festojnë në Prat. Festohet dalja në verë, festohet për vllazërinë, traditat, për t'u parë e mirënjohur, për të lartësuar benat e mallit e krenarisë për vendlindjen.

ME KËNGË ME ÇITELI DREJT PRATIT

Tek po ngjitemi drejt Pratis me makinën e Dan Menës, burazerit të Tofik Totrakut, na shoqërojnë këngët. Lunara, Selishta dhe Shkalla e Pratis ushtojnë prej zërave të gëzuar. Pranë timonit Dani mban edhe çiftelinë. Këngët për Lurën e trimërinë, për 300 nuset me duvak, për kullat dhe mejdanet e trimërisë pushtojnë grykat e thella të Selishtës, kurorën e maleve. Ndërkohë më vijnë ndër mend vargjet epike luriane "ku edhe cuca bahet djalë, "ku xhila e topit varra-varra, Sulë Beshiri i del përpara, ky Sufë Mena..."

Përmes honeve plot hijeshi e madhështi të bën më krenar shpirti dhe zëri i djemve të

Lurës, Dan dhe Adriatik Mena. Një provë fjale e bese, një provë drite për tokën, për jetën, për shokët. Me të drejtë shkrimtari e studiuesi Fatos Daci ka shkruar librin "Shqipëti e kreshtave të Lurës", kushtuar fisit martir e qëndrestar të Menës së Lurës. Dan Seit Mena, biri i Pregj Lurës, ka një tatuazh në parakrahun e krahut të majtë, babain e tij, Seit Mena, që e la jetim gjashtë muajsh. Dhe djali pason dritën e babait, amanetin dhe veprën e tij, dritën e fisit, provat e fjalës e të jetës. Në Livadh të Gjatë, midis kalasë së Shenepremtes, majës së Xhitetit e Skremesë së Tollës, Dan Mena brof në këngë, në këngën himn të të paharruarit Naim Plaku: "Këndojnë pushkët nëpër kulla". Tofik Totraku, vëllezërit Hasbajrami, Bekim Damzi i Luznisë, Troci i Reçit e shoqërojnë. Përmes flladit e gjelbërimit ushtojnë këngët e ndizen vallet. Në pllajën e blertë janë dhe Mirjan Elezi e Fiqiri Muça, Petrit Lica dhe Ali Totraku, ardhur nga Shkodra. Tofik Totraku ka marrë dhe rapsodët e shquar Sherif Dervishi i Dibrës dhe Musë Dauti i Hasit të Kukësit.

Prati festoon. Një popull me dritë fjale e dritë jete! Kurorat e maleve të Tollës e të Runjës sikur janë nusëruar, janë bërë me ylberë malli e dashurie, sepse bijtë e brezave të luftës e të punës kanë ardhur nëfestën pagane të Shënkollit. Faleminderit Xhemal Delishi i Selishtës, biri i tokës së maleve, intelektual virtuoz, që u votbesua disa herë dhe la gjurmë fjale e jete, gjurmë të mirësisë!

Midis qindra të ardhurve takojmë edhe Pashk Gjetën e Lezhës, origjina mirditor, mik shtëpie e bese i Gani Lleshit të Lukanit. Katolik e musliman, dy vëllezër, si lisi me dy degë. Në anë të lëndinës, aty ku shërben i palodhuri Zyber Lleshi i Qafë-Murrës me shokë, Tofik Totrakuka shtruar sofrën e bujarisë. Aty këndojnë edhe Sherif Dervishi e Musë Dauti. Aty merr jehonë kënga, drita e provave të mallit e të krenarisë. Ndërkohë, kur po fshihet dielli prapa Tollës së lashtë, kujtoj epikën shekullore:

Krisi pushka në Qafë të Pratis, / lufton Grika e populli i Matit, / kjo Selishta gur kala, / luftë bakan burra e gra, / Bajram Manuka nuk ka ra...

* * *

Festë pagane, festë uniteti e vëllazërimi. Nga këtu bleron dashuria dhe krenaria për vendlindjen, për fisin, për gjakun, për trojet e të parëve. Lum kush ruan traditat, vlerat, mirësinë, lum kush demonstroi provat për vendlindjen! Provat e fjalës janë drita e jetës...

Organizimet komunitare dhe demokracia

Nga Hekuran VLADI*

Demokracia është interesante! Ajo është shumë e mirë për t'u arrirë. Këtë po e provojmë në Shqipëri për afro 28 vjet.

E dalë nga sistemi diktatorial, ku vendim-marrja e centralizuar degjeneroi në censurë të fjalës e më tej në autocensurë, shoqëria shqiptare e gjeti veten në kaos organizimi. Ideologjia e trashëguar, jo vetëm në tekstet shkollore, por edhe në sjelljen e përditshme, u transformua në ideokraci.

Njerëzit, duke rendur pas "mrekullisë së tregut të lirë" u ri-skllavëruan me shpejtësi pas grupeve të interesit, të cilat udhëhiqen nga interesa të ngushta materiale, duke lënë në harresë parime jetësore, si demokracia.

Nga ana tjetër, migracioni nga zonat malore, apo qendrat e varfra, në 4-5 qendra urbane të vendit e më tej emigracioni jashtë vendit, jo vetëm e kanë përgjysmuar popullsinë, por e kanë shpërndarë atë si një mase likuide, e cila merr formën e enës së interesit material, dmth nevojës për t'u ushqyer, apo lakmisë për t'u pasuruar. Kështu që, sistemi shoqëror në Shqipëri nuk funksionon me pjesëmarrjen e njerëzve, por thjesht ndiqet prej tyre.

Që një demokraci të funksionojë, duhet që njerëzit të marrin pjesë, jo vetëm të bëjnë sehir, apo maksimumi të mallkojnë e shajnë ligjbërësit, vendim-marrësit, ligj-zbatuesit, apo vendim-zbatuesit.

Nga ana tjetër, duke qenë se demokracia është një rrugë e vështirë, ata që komandojnë frenat e shtetit, ndjekin rrugën e lehtë, atë të autokracisë. Dhe demokracia largohet në horizont, si avionët, duke lënë një tym të bardhë, që tretet në hapësirë.

Një nga mënyrat e ristrukturimit të demokracisë janë organizimet komunitare.

Por, pse mendoj, që organizimet komunitare mund të prodhojnë demokraci për vendin?

Organizatat komunitare nuk ndërtohen me miq, ose me grupe njerëzish me stile dhe shije të ngjashme, apo me njerëz që thjesht duan dhe kuptojnë njëri-tjetrin.

Organizatat komunitare ndërtohen nga njerëz që mendojnë se janë pjesë e diçkaje që është më e madhe se ata vetë. Ato ndërtohen mbi qëllime të caktuara, që i shohin të realizuara vetëm nga organizimi i tyre.

Gjithashtu, ato ndërtohen të bazuara mbi vlera morale ideale, jo mbi shumatorën e vlerave të individëve pjesëmarrës. Këtë organizim arrijnë ta bëjnë me sukses vetëm ata që kanë aftësinë për të parë vlerat tek të tjerët e për t'i vlerësuar ata si partnerë, jo thjesht vlerat dhe peshën e tyre personale.

Demokracia, kërkon përgjegjësi aktive, e cila mund të shprehet në forma nga më të larmishmet. Organizimet komunitare janë një nga format më frytdhënëse. Rezultatet, që mund të priten nga organizime të tilla, nuk janë vetëm zgjidhja e një problemi të caktuar, apo e disa problemeve, por edhe ndërtimi i komunitetit dhe ndërtimi i demokracisë, ose më së paku aftësia për të prodhuar demokraci.

Për të ndërtuar një demokraci, ne duhet të bëjmë më shumë sesa t'i motivojmë njerëzit të marrin pjesë në qarqe që trajtojnë problemet e jetës, që ndikojnë drejtpërdrejt në interesat e tyre personale. Lakmia njerëzore për të grumbulluar të gjithë pasurinë rreth vetes, bën që mirëqenia të mos rritet në përpjestim të drejtë me rritjen e prodhimit të mirave materiale e kështu konfliktet e rrënojnë ëndrrën për demokraci.



... kur njerëzit organizohen mirë, ata mund të ulen edhe në tryezat e vendimarrjes dhe t'i ndikojnë ato, bazuar në fuqinë që këto organizime kanë.

Kjo është pak a shumë, ajo që ka ndodhë në Shqipëri. Duke ndjekur rutinën degjeneruese për një kohë të gjatë, njerëzit kanë humbur besimin në demokraci, të cilën, nga ana tjetër nuk e kanë provuar kurrë në të vërtetë. Sistemi kaotik i ndërtuar në Shqipëri i ka hequr shumicës të drejtën për të marrë pjesë në një demokraci të drejtpërdrejtë e një sasi tjetër njerëzish nuk gjejnë kohë dhe thjesht neglizhojnë.

Përmes angazhimit në organizatat komunitare, me pjesëmarrjen demokratike në zgjidhjen e problemeve, qytetarët mësojnë të jenë aktivisht përgjegjës. Kjo është edhe një nga përgjigjet se çfarë është demokracia përfaqësuese që, duke zhvilluar marrëdhëniet në një komunitet, zhvillon një popull, zhvillon një komb.

Pasi qytetarët mësojnë të jenë aktivisht të përgjegjshëm, në vend të të mësuarit tek mbështetja plotësisht në mbrojtjen nga një shtet që imponon përgjegjësinë pasive, ata do të bëhen aktivë dhe ndikues në politikën dhe zhvillimin shoqëror.

Pra, organizimet komunitare ofrojnë rrugë shumë të gjerë në rigjallërimin e formave kuptimplotë të pjesëmarrjes së qytetarëve në një demokraci. Ato mund të jenë të vlefshme për demokratizimin e institucioneve, aq sa edhe qeveritë më të mira.

Gjithashtu, ndikimi i organizimeve komunitare mund të kthehet në një drejtësi restauruese pasi ato, në vend të përpjekjes për të bërë politikë personale, kërkojnë mundësinë e ndryshimeve strukturore. E thënë ndryshe, kërkesa për drejtësi ushtron presion mbi drejtësinë e deformuar të ligjit, në mënyrë që ligji të prodhojë drejtësi dhe jo interesa grupesh të vogla klienteliste.

Si përfundim, kur njerëzit organizohen mirë, ata mund të ulen edhe në tryezat e vendimarrjes dhe t'i ndikojnë ato, bazuar në fuqinë që këto organizime kanë. Janë pra, mallkimi i politikanëve, por janë gjithashtu një ilaç për demokracinë. Kjo pasi, organizimi i komunitetit sjell njerëz të pafuqishëm dhe relativisht të pafuqishëm, në solidaritet për të mbrojtur dhe avancuar interesat dhe vlerat e tyre.

* Autori është ekspert në fushën e ekonomisë. Ky shkrim është një refleksion mbi krijimin e "Unioni Lura".

Ka plot njerëz që ankohen sot se nuk kemi punë e nuk kemi tokë. Ka plot njerëz që kur i lut të vijnë për punë, me një pagesë goxha të mirë, në rrallim molle dhe procese të tjera, nuk janë të gatshëm. Familja Kaja jo vetëm që shfrytëzon më së miri tokën e vet, por ka blerë tokë dhe ka marrë dhjetra dynym me qira

Nga Osman XHILI

Zenel Kaja i Gjoricës nuk ishte marrë shumë me bujqësi para viteve 2000. Ndonëse ai vinte nga një familje bujqish të talentuar, për shumë vite kishte punuar si ushtarak, në detyra të ndryshme. Për më tepër ai ishte djali i Bektash Kajës që kishte qenë për shumë vite kryetar i kooperativës së Gjoricës, njeri punëtor dhe që i dëgjohej fjala. Si pikënisje për aktivitetin e ri u bë vëllai i Zenelit, Mediu. Ai punonte prej vitesh në një magazinë të grumbullimit të frutave, në Bolzano të Italisë. Shpesh diskutonte me agronomët më të mirë të rajonit për varietetet më cilësore, kërkesat e tregut, mënyrat e shumëzimit të mollës e plot probleme të tjera të një teknologjie bashkëkohore. Kishte akumuluar shumë e shumë nga kjo përvojë e bukur e mjeshtrave ndërkombëtarë, pa ditur se do ti hynte në punë ndonjë ditë. Një mendim i lindi në kokë dhe nuk i hiqej. Po sikur, të bëja diçka të tillë atje në vendlindje, atje në Gjoricën time, pranë lumit Drin?

Diskutojnë me vëlla Zenelin dhe ky i fundit, pa u menduar shumë, siç janë të guximshëm ushtarakët në vendime, i jep udhë propozimit të vëllait. Ishte viti 2004. Jo se nuk ishin mbjellë blloqe pemësh deri atëherë, por jo të kësaj natyre. Askush nuk kishte guxuar të mbjellë mollët 80 centimetra bima nga bima, brenda rreshtit, a thua se ishin fidanë domatesh. Pa le pastaj që kjo mënyrë mbjellje dhe këto varietete të reja, kërkonin dhe bandiera për mbështetje, sikurse hardhia. Ja kështu filloi ferma e familjes Kaja të shtojë aktivitetin e saj nga njëri vit në tjetrin. E nisi me një dynym, pesë dynymë të tjera, nëntë ... deri tek niveli i sotëm me dyzetë dynymë. Katërmbëdhjetë mijë fidanë të varieteteve të ndryshme, Gran Smith, Golden, Starking, Gala, Fuxhi e Renetë, ka vite që kanë nisur një prodhim të mbarë e cilësor. Në pak vite ajo u shndërrua në një shkollë për fermerët e rinj të zonës e më gjerë. Në vitin 2007 Zeneli fitoi një çmim nga Mada, sa me vlera morale, aq edhe materiale. Shumë fermerë të tjerë filluan të ecin në këtë udhë të bukur, pak të njohur dhe me shumë vështirësi. Parcelat e misrit dhe të fasules u mbushën me rreshta mollësh, mbështetur në tela e bandiera. Agronomi Rakip Kaja, Fatos Kaja, Adem Kaja, Kujtim Kalia, Zenel Dervishi në Bulqizë, kushërinjtë e tyre, vëllezërit Mehmeti, e plot të tjerë e përqaftuan idenë e pemëtoreve intensive dhe mbollën pa hezitim mijëra fidanë. Gjorica sot mund të ketë rreth dhjetë hektarë të mbjellë në këtë mënyrë. Në rrugën e tyre drejt suksesit ata patën shumë pengesa e vështirësi, porse njëri prej tyre ishte më dominanti, sëmundja e kromës. Ishte kjo sëmundje që sulmonte gjethet e reja dhe frutat që sapo kishin filluar rritjen, që jo vetëm shkatërronte prodhimin e vitit, porse kërcënonte dhe vetë pemën, për vazh-

Ferma “Kaja” në Gjoricë, një histori suksesi përmes punës dhe sakrificës



dimësinë e jetës. Ndoshta do të ishin shkullur dhe fidanët e gjorë, sikur të mos kishte zbritur si me magji një aleat shumë i fuqishëm, si Fondacioni Agrinet Albania, me qendër në Korçë. Drejtori i përkushtuar, Tomi Pikuli dhe profesorët e shumtë, që e rrethonin dhe e shoqëronin, bënë më të mirën. U erdhën në krah dhe në ndihmë fermerëve, me dijen, eksperiencën dhe përkushtimin maksimal, duke triumfuar mbi sëmundjet dhe dëmtuesit. Sot fermerët janë bërë mjeshtrë të vërtetë të prodhimit. I njohin me detaje sëmundjet dhe kohën optimale të spërkatjes, duke shtuar gjithnjë e më tepër dijet për çdo gjë që ka lidhje me mollën që kultivojnë.

MEKANIKA NË NDIHMË TË PRODHIMIT

Zenel Kaja e kuptonte që nuk mjaftonte vetëm dëshira e mirë për të synuar objektiva të lartë, por duhej përmirësuar teknologjia dhe mjetet e punës. Sot familja disponon dy traktorë të fuqishëm me shumë agregate bujqësore. Ka dy pompa spërkatëse motorike me kapacitet 500 dhe 1500 litra, dy pirunë për lëvizjen e arkave dhe një fadromë të vogël për nevojat e fermës. 250 arka të mëdha tre kuintalshe dhe qindra të tjera më të vogla, shërbejnë për evadimin e prodhimit nga fusha dhe ferma tek tregu dhe konsumatori.

Mirë, kur konsumatori do të gjendej direkt, por kur ai nuk gjendej për momentin, kur malli duhej të priste disa ditë, javë e ndoshta dhe muaj, si do bëhej halli? Ku

do të qëndronin mollët deri atëherë? Zeneli mendoi që një frigorifer ishte i domosdoshëm për të ruajtur prodhimin. Më se njëqind mijë euro duheshin për ta ndërtuar atë, ku vetëm evadimi i dherave kërkonte diku tek tetë mijë euro. Me shumë sakrificë u ngrit dhe frigoriferi që do të ruante frutat me një kapacitet goxha të madh, prej 350 tonësh. Ai do ti shërbente jo vetëm familjes së Zenelit, por dhe prodhuesve të tjerë, kur nuk do të gjenin tregun për të evaduar prodhimin. Tani, kur kanë kaluar mbi dhjetë vite nga ndërtimi i tij, Adriatiku mendon ta rinovojë paksë, ta bëjë atë me një teknologji bashkëkohore, me ndarje të tjera, ku çdo fermer i interesuar të ketë pjesën e tij të dhomës frigoriferike.

VEPRA QË PËRCILLEN MË TEJ

Zenel Kaja po shihte realizimin e shumë ëndrrave të bukura që kishte thurur, por kishte akoma të tjera më të mëdha. Një ditë, këtu e tre vite të shkuara, jeta e tij u ndërpre, ëndrrat e tij u këputën dhe zemra e tij pushoi, kur ishte vetëm 60 vjeç. Një moshë e bukur, kur eksperiencia arrin kulmin dhe trupi është akoma i fortë për punë. Familja, shokët dhe bashkëpunëtorët e përcollën trupin e tij me dhimbje dhe nderim. Vetëm një bindje dhe një siguri e kishin, se vepra e tij do të përcillet më tej, se ferma akoma më e bukur do të bëhej në të ardhmen, se amaneti i tij do të shkonte në vend. Nuk u gabuan. Dy djemtë e tij, Adriatiku dhe Bektashi, bashkë me nënë

Shqipen e kanë lulëzuar fermën akoma më shumë. Me gjithë vështirësitë e mëdha të vitit, pritët të merret një prodhim rekord prej 1500 kuintalësh, sa nuk ka marrë deri tani asnjë fermer në qarkun e Dibrës.

Ka plot njerëz që ankohen sot se nuk kemi punë e nuk kemi tokë. Ka plot njerëz që kur i lut të vijnë për punë, me një pagesë goxha të mirë, në rrallim molle dhe procese të tjera, nuk janë të gatshëm. Familja Kaja jo vetëm që shfrytëzon më së miri tokën e vet, por ka blerë gati dhjetë dynymë tokë dhe një sasi tjetër e ka marrë me qera. Shumë vite më parë bleu dhe një rrugë për të shkuar te një nga parcelat. Në dy anët e kësaj rruge ka mbjellë dy rreshta me mollë, që sot janë diku në vitin e dhjetë dhe mund të marrë rreth 30 kuintalë mollë. Këtë vit aplikuan për një projekt të Saredit, mbjellje, rrethim dhe vaditje me pika, në një sipërfaqe prej pesë dynymësh, duke u shpallur fitues.

Prodhimi i këtij viti është gati në pjekje, bile disa varietete të hershëm janë vjelur që tani. Familja Kaja, por dhe fermerë të tjerë të Dibrës e kanë një shqetësim të përbashkët, tregun. A do munden vallë këtë vit të lidhen me tregtarët e shumicës? Një firmë nga Kosova “Doni Frut”, ka ardhur disa herë në Dibër, në përpjekje për të lidhur një marrëveshje, në terma afatgjatë, por asgjë nuk është e sigurtë. Për momentin është caktuar koordinatori i kompanisë për Dibrën dhe po bëhen përpjekje për të gjetur vendin për një qendër grumbullimi, që do tu shërbejë fermerëve në vitet në vazhdim. Shteti shumë pak përpigjet për ti ndihmuar. Dy komshinjtë tanë dhe pse të lodhur, Maqedonia dhe Kosova, po bëjnë shumë më tepër dhe subvencionojnë shumë më tepër për bujqësinë dhe blektorinë. Ndoshta një ditë do të binden dhe qeveritarët tanë, të majtë e të djathtë, për të investuar në këtë sektor, tejet jetik të ekonomisë shqiptare. Ndoshta do të jetë vonë atëherë. Të rinjtë do të kenë ikur dhe fshatrat do të jenë shpopulluar.

Jeta rrjedh në Gjoricën e njerëzve të punës, herë e qetë dhe herë e trazuar, si ujërat e lumit Drin dhe të zallit, në të dy anët e saj. Familja Kaja pakësohet pak, kur ndërrojnë jetë dikush dhe shtohet akoma më shumë, kur lindin trashëgimtarë të denjë. Ndërroi jetë Bektash Kaja i vjetër, kryetari i dikurshëm i Gjoricës, një nip i tij me shkollim të lartë, përpigjet ti lartësojë emrin akoma më shumë. Ndërroi jetë Zenel Kaja, që themeloi fermën, një Zenel Kajë i ri, nipi i tij, djali i Adriatikut, i shëndetshëm e me sy të mëdhenj, me siguri do ta çojë më tej veprën e gjyshit.



Mbetjet urbane në Bulqizë, ekspertët e rinj mjedisorë monitorojnë dhe vlerësojnë shërbimin e ofruar nga bashkia

Shoqata Ekspertët e Rinj Mjedisor është themeluar në vitin 2014 si nevojë urgjente për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, rritjen e kapaciteteve duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Qëllimi kryesor është Edukimi Mjedisor i komunitetit me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes qytetarëve, bizneseve dhe qeverisë lokale. SHERM ka zbatuar një sere projektesh në fushën mjedisore dhe aktualisht po zbaton projektin: Monitorimi dhe vlerësimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Bulqizë, ku ka si qëllim përmirësimin e gjendjes aktuale të shërbimit të pastrimit në Bashkinë Bulqizë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbajtjen pastër të qytetit ku jetojnë. Ky projekt po financohet nga Leviz Albania me fondet e Ambasada e Zviceriane.

Ky projekt synon të monitorojë dhe vlerësojë Bashkinë Bulqizë për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, ofrimi dhe diferencimi i shërbimit nga Bashkia në zonën urbane kundrejt asaj rurale. Monitorimi qytetar do të realizohet nëpërmjet vëzhgimit në terren ku për çdo njësi do të ngrihen grupet qytetare monitoruese 3 ose 4 persona, që do bëjnë monitorimin me turne, me foto, video, datat përkatëse se kur u fotografua makina duke marrë mbetjet në kazana çfarë hapash ndoqi ajo etj. Grupi i monitoruesve do të vëzhgojë nga afër sesi realizohet procesi i shërbimit të pastrimit që nga tërheqja e mbetjeve në terren dhe hapat që ndiqen nga Bashkia Bulqizë deri në landfill. Ky monitorim do të realizohet për një periudhë 4-5 muaj. Si është gjendja aktuale e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale dhe ku shtrihet ky shërbim, në cdo fshat në cdo njësi apo vetëm në qendër njësi. Kontinierët e vendosur a përmbushin nevojën e komunitetit apo gjithmonë ata ankohen pran pushtetit vendor për cilësinë e dobët të shërbimit. Në zonat ku nuk ofrohet ky shërbim si është zgjidhur menaxhimi nga komuniteti, apo hidhen në ujë, tokë, natyrë, apo i djegin duke ndotur ajrin e zonës dhe mjedisin. Grupi i monitoruesve do bëjë takime të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së monitorimit për të dëgjuar zërin e tyre dhe për të evidentuar zonat më problematike, dhe sa të kënaqur janë me këtë shërbim dhe sesi menaxhohen mbetjet urbane, hidhen të gjitha në një kosh, apo përdoret metoda e kompostimit të mbetjeve organike duke bërë ndarjen nga ato inorganike. Monitoruesit do konstatojnë numrin e kontenierëve në terren dhe a janë të mjaftueshëm ka nevojë për të tjerë, dhe a mbulohet i gjithë territori i Bashkisë njëjloj si në zonën urbane kundrejt asaj rurale.

Aktivitetet njerëzore gjenerojnë mbetje. Rreth 10% e mbetjeve totale në vendet e BE-së konsistojnë në "mbetje urbane", mbetje që gjenerohet kryesisht nga aktiviteti shtëpiak, ndërtesat publike dhe në një masë më të ulët nga bizneset e vogla etj. Çdo individ gjeneron mesatarisht 0,5 ton mbetje shtëpiake në vit.

Menaxhimi i mbetjeve urbane është një ndër problemet kryesore që sot përballen Bashkia Bulqizë, duke u kthyer në një burim të ndotjes së mjedisit, tokës, ujit dhe ajrit. Në të shumtën e rasteve kontenierët janë të tej mbushur dhe përreth tyre ka mbeturina. Banorët ankohen shpesh për mbetjet që nuk pastrohen përditë, numrin e pakët të kontenierëve dhe mungesa e hapësirave të veçanta për hedhjen e mbetjeve. Gjithashtu gjendja e kontenierëve është në kushte jo të mira. Në qytetin e Bulqizës nuk ka një plan të mirëfilltë për menaxhimin e mbetjeve urbane. Ndërsa në 7 Njësitë Administrative të saj të përbëra nga 63 fshatra, ky shërbim është pjesërisht i aplikueshëm. Ne si organizatë bazuar në punën e mëparshme kemi evidentuar se nga ana e strukturave të bashkisë Bulqize ka mangësi të theksuara për sa i përket planifikimit, menaxhimit, transparencës, edukimit,



Ky projekt financohet nga:



MONITORIMI dhe

VLERËSIMI i ofrimit

të SHËRBIMIT

të menaxhimit të

MBETJEVE URBANE

në Bashkinë Bulqizë



ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjes së komunitetit në menaxhimin e mbetjeve urbane. Nisur nga situata e përshkruar më sipër, puna jonë me këtë bashki do të sjell një radiografi të këtij shërbimi dhe, përmes gjetjeve dhe rekomandimeve ne synojmë përmirësimin e shërbimit, rritjen e transparencës dhe përmirësimin imazhit të Bashkisë Bulqizë. Këtë shërbim Bashkia Bulqizë e ofron nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimit Publik e cila është në vartësi të saj, pra përgjegjëse për cilësinë e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane.

Ne synojmë me këtë projekt që të vejmë Bashkinë Bulqizë përballë përgjegjësisë me situatën reale në terren e cila

“Ne synojmë me këtë projekt që të vejmë Bashkinë Bulqizë përballë përgjegjësisë me situatën reale në terren e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, të rrisë buxhetin që të përmirësojë cilësinë e shërbimit të pastrimit në mënyrë që të mbroje mjedisin nga ndotja që i vjen nga keqmenaxhimi i mbetjeve dhe hedhja e tyre pa kriter në mjedis nga komuniteti. Të edukojmë komunitetin për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e përmirësimin e tij nga ndotja dhe degradimet që vijnë si pasoje e aktivitetit njerëzor dhe duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm”.

DANJEL BICA, drejtues i SHERM

është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, të rrisë buxhetin që të përmirësojë cilësinë e shërbimit të pastrimit në mënyrë që të mbroje mjedisin nga ndotja që i vjen nga keqmenaxhimi i mbetjeve dhe hedhja e tyre pa kriter në mjedis nga komuniteti. Të edukojmë komunitetin për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen e përmirësimin e tij nga ndotja dhe degradimet që vijnë si pasoje e aktivitetit njerëzor dhe duke siguruar zhvillimin e qëndrueshëm.

Mbetjet janë një barrë për planetin, mjedisin, ekosistemet dhe njeriun. Bashkia Bulqize ka përgjegjësinë për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane por rrallëherë ofrojnë shërbim mbulimi universal në të gjithë territorin e saj, zakonisht prioritet i jepet më tepër grumbullimit sesa trajtimit të mëtejshëm të mbetjeve. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve kërkon investime dhe kompetenca që sektori publik nuk është gjithmonë në gjendje t'i sigurojë. Tregu i mbetjeve nuk është thjesht një shërbim publik, por gjithashtu, edhe një sektor i rëndësishëm ekonomik dhe një buxhet i rëndësishëm për pushtetin vendor.

Ky projekt do të ndihmojë Komunitetin e rrethit Bulqizë sesi të tregojnë kujdes ndaj mjedisit për mbrojtjen e tij dhe të njihen me problematikat mjedisore që shqetësojnë vendin tonë ku një pjesë e mire e tyre vijnë nga aktiviteti njerëzor që mund të thuhet që shkaktari kryesor është njeriu. Mbetjet Urbane sot gjenden në çdo vend, në tokë, përrua, rrugicë, fusha etj, që të gjitha këta mbetje në natyrë janë të hedhur nga njeriu pa marrë parasysh ndikimet që ata sjellin dhe rrezikshmërinë që paraqesin për jetën tonë, pasi në një mënyrë apo në tjetrën mbetjet do kthehen si ushqim për ne, në pjatat tona. Prandaj është e nevojshme që Ndërgjegjësimi/ Edukimi për rëndësinë e mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane, ndarja e tyre nga inorganike dhe organike duke i përdorur për pleh organik me mënyrën e kompostimit që është shumë i rëndësishëm dhe miqësor me mjedisin. Sot mbetjet hidhen vend e pa vend në natyrë, ujë, rrugë, ose digjen duke mos menduar për imazhin që ata kanë dhe për ndotjen që japin në mjedis. Prandaj duhet që të gjithë të kontribuojmë në mbrojtjen e mjedisit ku jetojmë për veten tonë duke shijuar bukuritë natyrore që ai ofron. E drejta për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm është një e drejtë natyrore e çdo njeriu, i cili ka të drejtë që të thithë ajër të pastër.

Keni ndonje shqetësim për të ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >



Sikur të kishim rrugë!

Nga **SAMET ZAGRADI**

Unë, si një qytetar i thjeshtë i një zone të varfër dhe pa perspektivë njëkohësisht edhe bashkëvuajtës i gjithë problematikave që Dibra mban në vetvete them që do ishte ndryshe në qoftë se rruga e Arbrit do të ishte bërë me kohë. Gjërat sigurisht që nuk do të ishin kështu siç sot janë vetëm në qoftë se do të kishim një “copë” rrugë. E them një “copë”, sepse distanca nga ajo ekzistuesja është me të vërtetë e madhe. Kudo, në çdo vend të zhvilluar fillimisht para se të bëhej i tillë është ndërtuar rruga që ta sjellë atë në atë gjendje që është. Resurset nuk na mungojnë, dëshira për punë jo, idetë për zhvillim sigurisht që i kemi. Vullnetin për ndryshim do ta gjejmë mjafton që ajo e flamorus rrugë të na vijë në ndihmë për ta arritur këtë gjë. Dhjetëra shkrime si ky, qindra premtime bosh, disa tentativa për punuar dhe asnjë rezultat për të shpresuar që zona më e varfër në Shqipëri të jetë ashtu siç këto njerëz meritojnë të jenë. Rruga e Arbrit prej vitesh mbetet tema kryesore në gojë të çdo dibrani që udhëton drejt Tiranës, në çdo kafene apo kudo në odat me konaqet e Dibrës. Vështirësitë dhe vuajtjet askush nuk di më mire se një Dibran ku çdo ditë rropatet mes tyre për mbijetesën e përditshme.

Sikur të kishim një rrugë gjithçka do të ishte ndryshe! Dibranët ndërtuan Tiranën që në kohën kur ajo ngjante më shumë si një fshat. Që në vitin e largët 1914 kur Serbët dëbuan nga trojet e tyre dibranët ndërtuan lagjen e tyre atje ku edhe sot e kësaj dite ajo lagje mban emrin “ mëhalla e dibranëve”. Me pak fjalë këto njerëz po ndërtojmë jetën mes malesh ku vështirësitë për të jetuar mund të jenë dhjetë fish më të mëdha se në qytet. Dibranët në të gjithë vendin njihen si njerëz punëtorë të cilët kudo që janë mundohen me çdo forcë që puna të bëhet ashtu siç në të vërtetë duhet.

Në Dibër numërohen dhjetëra persona me aftësi ndryshe mes të cilëve një numër i konsiderueshëm fëmijësh. Si në çdo qytet të vogël nuk ekzistojnë qendra të specializuara për to. Në qoftë se do të kishim atë copë rrugë këto shërbime njerëzit do ti merrnin në Tiranë e më pas do të ktheheshin të flinin në shtëpitë e tyre duke kursyer shumë të ardhura familjarëve të tyre. Dializa është një shërbim mjekësor mjaftë delikat dhe për fat të keq shumë të sëmurë mes qindra hallesh detyrohen të jetojnë në Tiranë vetëm për shkak të rrugës. Shëndeti i këtyre qytetarëve nuk përballon dot kthesat e Qafë Buallit, gropat e Klosit apo pesë orë rrugë që bëhen nga Peshkopia për në Tiranë. Ne nuk kemi dhe mjekë por në qoftë se do të kishim rrugë asnjë doktor nuk do përtonte të vinte dhe tu shërbente qytetarëve pasi ato meritojnë një shërbim të tillë, pavarësisht rrugës.

Sikur të kishim rrugë do të kishim një ekonomi më të mirë e si pasojë të rinjtë nuk do të zgjidhnin të largoheshin ashtu siç po bëjnë. Në bulevardin e famshëm të blirëve të rinjtë sa vijnë edhe pakësohen ndërsa ato që janë shëtisin nga një kafene në tjetrën. Askush nuk dëshiron të jetë në atë gjendje, askush nuk ka vullnetin të punojë sepse atë çka prodhon nuk arrin ta shesë. Shumë të rinj dibranë ikin me studime dhe nuk kthehen më, e sikur të kishim një copë rrugë ato do të vinin më shpesh e do kontribuonin dijet për vendin e tyre pasi guri i rëndë peshon në vendin e tij. Të rinjtë e Dibrës si gurë shahu lëvizin në çdo cep të vendit dhe vuajnë pasojat e gënjeshtrave të çdo prazgjedhjes.

Në qoftë se do ishte kjo rrugë Dibra do të ishte atraksioni turistik më i madh i vizituar nga turistët e huaj dhe jo vetëm.

Mjafton të përmendim malin më të lartë në Shqipëri Korabin, Parkun Kombëtar të Lurës cilësuar si mrekulli natyrore, vargmalet e Deshatit, bjeshkët e pafund që me bukuri përallore mbeten fatkeqësisht të pa zbuluar. Për të vazhduar më tej me ujërat termal të llixhave (sipas specialistëve kane vetitë cilësinë më të mirë në Ballkan), kalanë shekullore të Grezhdanit, bulevardin e blirëve e shumë pasuri të pakrahueshme natyrore që mbeten të pashfrytëzuar vetëm nga ajo rrugë që na mungon. Lugina e Drinit përshkon një distancë të madhe të trojeve të Dibrës dhe është një atraksion turistik dhe të jep mundësinë të shijosh pamjet fantastike. Një turist pavarësisht lobimeve të organizatave dhe institucioneve përkatëse nuk vjen sërish kur mendon që vetëm 180 km duhet ti bëjë për të parë Dibrën e si pasojë këto para në qoftë se rruga nuk bëhet nuk do të vijnë në vendin tonë.

Sikur të kishim edhe ne një rrugë fermerëve dhe bujqit dibranë nuk do tu dhimbte koka për shitjen prodhimeve të tyre. Ato punojnë tmerrësisht shumë që prodhimi i tyre të jetë cilësor dhe mbi të gjitha bio, ashtu siç e bën natyra, pa koncentrat. Më thoni ju, a ka më të mira se qershitë e Dibrës, mollët, mishi apo patatja pa asnjë lloj simulantit? Çfarë do të zgjidhni ju për fëmijën tuaj, një lëng molle bio të prodhuar nga mollët e Dibrës apo një gotë me koncentrat dhe të pakëtuar për lëng natyral? Sigurisht që do doni të parën, por kjo është e pamundur në qoftë se kjo rrugë nuk ndërtohet. Prodhimet dhe djersa e të shkretëve fermer do shkojnë dëm, ashtu siç po shkojnë dhe tregu i huaj do sjellë prodhimet me cilësi më të dobët. Qershitë nuk do të kalbeshin, patatet nuk do hidheshin, mollët nuk do ti hante bagëtia në qoftë se rruga do të funksiononte ashtu siç duhet. Mishi i Dibrës do gjente treg të madh në qoftë se ky nder do u bëhej dibranëve.

Në qoftë se do të ishte rruga e Arbrit qyteti i Peshkopisë dhe jo vetëm do të kishte më shumë gjallëri. Artistët, aktorët, sportistët nuk preferojnë të lënë gurët në veshka nga rruga e Klosit për të argëtuar këto njerëz që e duan kaq shumë kulturën. Lëvizja e njerëz do të ishte më e madhe dhe përfitimet monetare dhe jo vetëm do të ishin më të mëdha. Vlera e shtëpive dhe trojeve do të rritej dhe sigurisht kjo rrugë do të ndikonte shumë në zhvillimin ekonomik-kulturor të kësaj zone. Po të kishim rrugë Dibra do të ishte një hap më afër zhvillimit social-kulturor- ekonomik.

Rruga e Arbrit do të ishte një aks rrugor mjaftë rëndësishëm për zhvillim e zonës për arsyen se kjo rrugë do të lidhë Shqipërinë me Maqedoninë. Përveç shkurtimit të kilometrave kjo rrugë do të ofrojë ndjeshëm Dibrën me Tiranën dhe qytetet e tjera më të zhvilluara të Shqipërisë. Pra, me pak fjalë, ndërtimi i kësaj rruge nuk do ti shërbente vetëm Dibrës dhe dibranëve por të gjithë shtetit. Dogana e Bllatës do të fuqizohej dhe do të shërbente si pikë lidhëse të Shqipërisë me vendet e Evropës që do përdorin portet shqiptare për transportin e mallrave më tej. Kjo rrugë vlen më shumë se gënjeshtrat, më shumë se një thes miell... Vlera e kësaj rrugë është e barabartë me atë të vetë dibranëve duke u bazuar në faktin se ato meritojnë shumë më shumë se kaq.

Si çdo qytetar i thjeshtë i zonës më të varfër në Shqipëri, dua të flas për këtë rrugë dhe si unë duhet të bëjnë të gjithë. Duhet të mësohemi të mos jemi të nënshtruar ndaj presioneve klienteliste port ë kërkojmë minimalisht informacion dhe të drejtat tona. Ajo rrugë është shpëtimi i një zone të tërë që çdo ditë vuajnë dhe përfetojnë momente të vështira. Fundja, a nuk paskemi edhe ne të drejtë të jetojmë ashtu siç na takon?

TË JESHË “CUCË” NË KËTË VEND!

Skicë nga **ANGJELINA SULA**

Kam mësuar që përveç të tjerash, të them atë që mëndoj. Të bëj atë që ndjej. Të ngre zërin për atë që më shqetëson. Të ngre kryet për atë që s’mundet. Do kisha dëshirë që të kishte një mënyrë që çdokush të më “dëgjonte”, por megjithatë, nëse akoma çdo vajze i etiketohet “liri e tepër-ar” të paturit e një adrese sociale Instagram-i apo Facebook-u, kërkoj singlerisht ndjesë duke e mbyllur këtu diskutimin, për të folur vetëm pas dhjetë vitesh kur kjo kalbësi mendimi të jetë zhdukur plotësisht. Kalendarit shënon 14 gusht 2018 dhe ja ku jemi. Jetojmë në një familje ku babai vetërespektohet si despot dhe nëna me fëmijët si të nënshtruarit e tekave “burarake” të tij. Të kemi parasysh që psikologjia thotë se gjithë qenia e njeriut të rritur është veçse brumë i shtypur në 1001 forma qëkur ka qenë fëmijë. Rrjedhimisht, edukata familjare trashëgohet. Jetojmë në një familje ku djali mbahet si princ e vajza një shërbyese në sarajet e tij, pa kurrfarë të drejte. Aq sa rëndom dëgjohej kur lind një vajzë: “Mallkue qoftë emni cucë n’këtë vend!” Ku nëna duhet të paguajë me jetë, për çdo “marre” të vajzës së vet. Ku gruaja s’ka të drejtë të dalë jashtë se e shohin burrat. Ku thuhet se: “burgu e rakia për burra janë”. Ku burri ofendon krejt normalisht gruan e vet në sy të fëmijëve, e nëse ajo ngre krye, i përplasët në fytyrë në rastin më të zakonshëm një shuplakë e nxehtë. Ose në rastin më të mirë e zakonshme shprehje “Pusho, se të dhashë 5-lekëshen, e marr nesër tjetrën.” Statistikat tregojnë se një përqindje e konsiderueshme femrash jetojnë në një familje ku dhuna është rrënjësishme e ngulur, e respektohet si një ritual i përditshëm i shtëpisë. Ku ka akoma burra që thonë: “Të rrah se kështu bëjnë të gjithë” Ku gruaja s’mëriton të bëhet e bukur, sepse quhet bishpërdredhur, ndonëse e shoqëruar nga vetë ai. Mos vallë këta burrecë me mustaqe kanë frikë nga vetja, e s’kontrollojnë dot një grua? Ja ç’ndodh! Fëmijët janë amatorë të çdo skene thrilleri, aksioni, aventure e drame zhvilluar çdo ditë brenda mureve të shtëpisë së tyre. E ç’të ardhme presim nga ata, veçse ata vetë protagonistë të këtyre “filmave”? Të filmave tragji-komikë do i quaja unë. Ku nëse babai prish muhabet në raki e sipër me komshiun, fëmijët ndalohej kategorikisht të shkojnë atje, se përndryshe “ të shkojnë të hanë bukë te ata”. Nëse padashje, prapë në raki e sipër pajtohen, fëmijët si me telekomandë komandohen të shkojnë nga mëngjesi deri në darkë te njëri-tjetri (derisa të pinë rakinë tjetër). Kur akujt shkrihen, rrezik edhe përmbytsh nga uji. Ku fëmijët janë të guas, ndërsa kur rriten e sjellin pare n’shipi ,ata janë padiskutim “trimat e babës vet”. Ku fëmijës s’i lejohet absolutisht të shprehë se i pëlqen ai burri ose gruaja që babai e nëna e kanë inat. Nuk është budalla ai, që të mendojë ndryshe nga ata e të ketë gjykimin e tij pa u ndikuar. Të mos flasim për vajzat. Aty dua t’i mësoj fuqishëm, e më vjen keq që ndonjëherë e humbas qetësinë. Jam vetë vajzë dhe vetë kam lindur e jam rritur mes një mjedisi të tillë, ndaj e di mjaft mirë si funksionon jeta për to. Nëse do sugjeroja një zgjidhje, e para do ishte kjo që po bëj tani. TË NGREMË ZËRIN FUQISHËM NË EMËR TË KËTYRE VAJZAVE “PA ZË”. Por padyshim zgjidhja më e mirë është shkollimi. Siç ka thënë edhe Khaled Hossein te “Njëmijë diej vezullues”, “Nuk do mund të ngremë kurrë krye si shoqëri, për aq kohë sa gjendet qoftë edhe një vajzë e pashkolluar”. Ky realitet shqiptar, i një epoke që supozohet se është moderne, sipas mendimit tim, nuk ka ndonjë ndryshim të madh me atë në Afganistan. Ç’shoqëri jemi ne? Ku vajzat që shkojnë në shkollë, etiketohen si të përdala. Ku djali që kërkon nuse është përherë yll i rënë nga qielli, e nëse një vajzë e refuzon për një jetë më të mirë, thuhet se ajo ishte e pandershme. Ku vajza që s’ngrihet në 5 të mëngjesit të pastrojë oborrin, shenjohej me gisht nga gjithë katundi. Si duket, të gjithë bëhen merak kur oborri i komshiut ka ngelë pa fshirë, edhe në orën 5 të mëngjesit pale. Kjo ndodh në fshat. Por të kthesë sytë nga qyteti, që iu thaftë goja atij që e quan akoma “qytet” një vend ku vajzat mbahen të burgosura brenda pallatit, që u kontrollohet edhe fjalëkalimi i Facebook-ut (nëse kanë), nuk lejohen të shkojnë në gjimnaz me pretekstin se janë rritur e bërë si “pela”. Nëse u bie rasti të dalin njëherë në vit diku, do jetë patjetër ndonjë dasëm kushëriri, ku gjithsesi u duhet të mbajnë qëndrim prej të burgosurë për shkak se sytë e plakave rrotull që i sajojnë ndonjë vend për nipin a djalin e filanit, janë më vigjilentë sesa vetë kamerat. Ku i dihet, ndoshta i del fati. Se duhet thënë që shumicës së vajzave, u çelet fati nëpër dasma. Dihet, ajo që ka luajtur më mirë rolin e vajzës së urtë, të edukuar e të turpshme. Normalisht dhe kush ka ditur ta mbajë më shumë kokën ulur se të tjerat kur ka kërcyer. Se ku drejtin shkojmë me këto budallallëqe që po na trashin dita-ditës, nuk ka shans ta marrim vesh. Ndonjëherë druaj mos është kthyer mbrapsht rrota e kohës, por jo, shumë njerëzve u ka ngecur rrota e kohës diku. Aty është ndryshkur prej dekadash. Ka akoma familje që i pengojë vajzat të shohin TV, e sidomos telenovelat, sepse sipas tyre “hapen sysh” e “dalin duersh”. Në fakt kur e mendoj, mirë e kanë. Aq të izoluara sa ndihen në atë shishen me gaz e Coca-cola, keq do shpërthejnë një ditë, nga trysnia e pamëshirshme e fatit. I vetmi “realitet” ku përpigën të jetojnë sadopak janë telenovelat. E mjerueshme. Kurrë ndonjëherë s’ka patur kaq shumë peshë kjo fjalë sesa tani. E mjerueshme...

Më 8 shtator vëllezërit Keta sjellin për shqiptarët eventin më të rëndësishëm të boksit në një qytet shqiptar në Maqedoni

sport

DIBRA E MADHE PRET KAMPIONËT



Gjetan Keta lufton për titullin kampion bote në versionin WBU

Nga Defrim METHASANI

Sashmë e shtuna e 8 shtatorit po afron dhe vëmendja e opinionit sportiv mbarëshqiptar është në Dibër të Madhe, qytetin shqiptar të Maqedonisë, që do të pres kampionët e boksit. Vëllezërit Keta, në vitin e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu, kanë vendosur që të organizojnë pikërisht në këtë trevë të rëndësishme historike, këtë manifestim sportiv, që kalon kufijtë lokal dhe kombëtar, por diskutohet titulli kampion bote. Gjetan Keta, kampioni i Europës në boks, do të ndeshet përballë serbit të Bosnjës, Janjanin mbrëmjen e së shtunës, duke e quajtur këtë përballje një duel në themel. Trajneri, njëherësh promotori i këtij eventi, Ismail Keta, ish kampion bote në kikboks, ka pohuar se përzgjedhja e Dibrës, është respekt për vëllezërit tanë dibranë përtej kufijve fizikë të Shqipërisë, në shenjë mirënjohje në vitin e Skenderbeut, meqë heroi ynë kombëtar, pas kthimit në atdhe, aty zhvilloi edhe një nga betejat e para.

Kjo mbrëmje, do të ketë brenda edhe ndeshje të tjera, ku më i spikatur, është ai mes Ferit Ketës, kampion Europe dhe turkut Karakus, një boksier me shumë përvojë dhe rezultate të larta. Gjithashtu përveç publikut të zjarrtë, do të performojnë mjaftë artistë të shquar, si: Aurela Gaçe, Kastriot Tusha, Greta Koçi dhe Stine.

Mbrëmja nis në orën 19 dhe mendohet të zgjasë deri në orën 23.00, ku i fundit në ring ngjitet Gjetan Keta, ose "Tajsoni i bardhë" siç quhet nga mediat gjermane. Dueli i tij ngjall interes, pasi edhe kundërshtari është mjaft i fortë, pasi kujtoj që ka 28 ndeshje, prej të cilave vetëm 3 humbje, ndërsa Gjetan Keta, ka 26 ndeshje me 22 fitore, prej të cilave 18 me nokaut dhe 4 humbje.

Kjo është një natë historike, sepse përveç sportit, bënë një promovim të shkëlqyer të Dibrës së Madhe që është lënë në hije deri më tani, duke e zgjuar emrin e saj në shumë media kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në ring, do të ngjiten edhe emra të tjerë kampionësh të shkollës "Keta" dhe jo vetëm, si Mikel Alliu, Roxhers Muslia, Bernard Marashi, Kristi Caca e të tjerë.



E gjitha kjo veprimtari me përmasa botërore, do të transmetohet nga RTSH dhe Super Sport. Kampionët tanë janë nisur drejt Bulqizës, ku do të zhvillojnë ditët e fundit përgatitore, në malet e Bulqizës dhe Dibrës, për të marrë më shumë energji dhe forcë që të jenë sa më në formë mbrëmjen e së shtunës.

Biletat janë në treg në: Tiranë, Bulqizë, Shupenzë, Maqellarë, Peshkopi dhe Dibër. Shpresojmë që ashtu si deri më sot, vëllezërit Keta dhe veçmas Gjetani, të na bëjnë krenarë, me një titull kampion bote, që për një shqiptar, është titulli i parë në historinë e boksit shqiptar.



intervistë

Nga Samet ZAGRADI

Ju jeni kampion Europe në një sport që kohët e fundi po lulëzon shumë. A mund të na flasësh pak rreth vetes tuaj?

Më lejoni në fillim të shpreh kënaqësinë dhe privilegjin që po jap këtë intervistë për gazetën tuaj, te e cila, çdo muaj kam lexuar materiale interesante dhe shumë informuese për Dibrën.

Unë kam lindur më 15 dhjetor 1979 në fshatin Tërbac të rrethit të Bulqizës. Që në moshën 11-vjeçare fillova të stërvitesha në sportin e boksit duke u frymëzuar nga personazhet e njohur të filmave. Në viti 1996 si shumë moshatarë të mi emigrova në Greqi, dhe tre vite më vonë fillova arsimin e mesëm. Unë jam i martuar, kam një vajzë, dhe që prej vitit 1999 jetoj me gjithë familjen në Greqi.

Si ia nise rrugës së boksit?

Siç e thash edhe më parë që në moshën 11 vjeçare fillova të stërvitesha në boks. Filmat ishin frymëzimi im ku unë merrja 'spunton' e parë. Në vitin 1999 bëra një ndeshje miqësore në Greqi dhe dy trajnerët Kosta Jaikimidhis dhe Dhimitri Dhimitriu, më pëlqyen dhe më ofruan në ekipin e Pireut. Më pas u stërvita nga një emër i madh i boksit në Greqi, Angelo Stamitiadhis. Kështu, me pak fat, nisi rrugëtimi im në këtë sport që sot është kthyer në profesion për mua.

Si vazhdoi ky rrugëtim deri në ditët e sotme?

Fillimisht fillova si amator duke u renditur në vendin e parë, më pas në vitin 2003 kalova në Kikboksen profesionist. Në vitin 2003-2004 u shpalla kampion i Greqisë në peshën 70 Kg. Në vitin 2005 mora titullin kampion në K1 në kampionatin ballkanik në Athinë në peshën 72 kg. Në vitin 2006 u shpalla nënkampion Europe në Budapest të Hungarisë dhe sërish në 2007 nënkampion në Greqi.

Në vitin 2009 u ndesha në federatën MMA duke u bërë sërish kampion i Greqisë. Në vitin 2015 në evenimentin e quajtur Santa sërish për të shumtën herë u bëra kampion i turneut në peshën 75 kg. Ndërsa më datë 4 qershor 2016 u shpalla kampion Europe në peshën 75 Kg në Petrich të Bullgarisë gjithmonë për ngjyrat Kuq e Zi. Ndërsa ndeshja më e rëndësishme për mua do të jetë në 22 dhjetor 2018 në pallatin Feti Borova të kompleksit Dinamo në Tiranë për kampion bote.

Duke punuar fort vjen edhe suksesi



Një djalë Dibre kampion Europe. Si ndihesh për këtë fakt?

Unë më shumë ndihem krenar që jam Dibran pastaj ndihem mirë që jam kampion. Dibra më lindi, më rriti dhe më bëri kampion. Mençuria, bujaria, mikpritja Dibrane janë prej shekujsh kanë qenë shembull për të gjithë. Ne jemi njerëz punëtorë dhe në të gjitha fushat kemi pasur sukses në të gjithë botën. Unë jam njëri prej këtyre njerëzish që kam punuar fort dhe kam pasur këtë sukses. Çdo i ri duhet të ndjekë ëndrrën që më vonë ta bëjnë realitet atë.

Cila është marrëdhënia juaj me Dibrën?

Të thuash që nuk më mungon Dibra gënjej. Ka 20 vite që jam larguar edhe malli për të kurrë nuk më është shuar. Mundohem të vij shpesh, të vizitoj fshatin tim, Bulqizën, Peshkopinë.

Çdo ditë ajo ndryshon por ca është e vërteta ai vend meriton shumë më shumë. Ata njerëz punëtorë meritojnë tu shiten produktet, meritojnë të kenë një investim në rrugë dhe në aspekte të tjera. Bulqiza dhe bulqizakët duhet të jenë më të pasurit e Europës por fatkeqësisht ndodh krejt e kundërta. Ata po lënë kokën në minierë dhe kjo nuk është e drejtë. Ne të gjithë duhet të llobojmë fort që diçka të ndryshojë në Dibrën tonë të dashur.



Përveç ndeshjes së rëndësishme që do të bësh në dhjetor, cilat janë planet për më tej?

Plane kam shumë, në fakt. Së shpejti do të hap një palestër në qytetin e Durrësit, ku do të ushtroj këtë sport. Mendoj që do të ketë interes, sepse ky sport është mjaftë i bukur. Sigurisht që nuk do të pas dore edhe ndeshjet e mia.

Nga se frymëzohesh?

(Qesh) Pasioni miku im. Ai është motori i energjive të mia. Jo vetëm tek unë por tek çdokush që ka një pasion të caktuar frymëzohet vetvetiu.

Vjen shpesh në Shqipëri?

Mundohem që të vij sa më shpesh që të jetë e mundur. E dua Shqipërinë po aq sa Dibrën. I dua ngjyrat kuq e zi dhe për atë flamur do të luftoj në çdo ndeshje timen.

E kush është ai që jeton jashtë edhe nuk e merr malli për vendin e tij të lindjes? Unë këtu kam shumë miq, familjarë dhe pushimet i kaloj kryesisht në vendin tim.

A mendon se të rinjtë e sotëm janë më

aktiv se në kohën tënde?

Në fëmijërinë time ishte ndryshe. Shqipëria ishte ndryshe atëherë. Unë jam i bindur që në të dy kohët një gjë nuk ndryshon. Puna e pakursyer do të sjell suksesin. Në qoftë se të rinjtë ecin me këmbë në tokë dhe punojnë për talentin e tyre, suksesi do të bëjë zhurmë për çdo kënd.

Kush është Adriatiku jashtë sportit?

Familja për mua si dhe për çdokënd mendoj është gjëja më e çmuar. Vajza si për çdo prind është pika e dobët. Unë jam një njeri i thjeshtë. Jam popullor me çdo kënd, kushdo qoftë ai. Përqipem që të jem i thjeshtë me të gjithë dhe të gjithë.

Çfarë do të doje ndryshe në Dibër?

Dua të ketë më shumë punë. Të ketë rrugë dhe të ndihmohen njerëzit. Dibra ka potenciale të jashtëzakonshme natyrore. Sigurisht që Rruga e Arbërit është gjëja kryesore që të gjithë mezi e presim. Kemi shpresa që së shpejti të udhëtojmë më shpesh në Tiranë. Të ketë investime në të gjitha fushat ku ka nevojë për investim.

printime dixhitale

DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603



Nga Xhafer MARTINI

Në ndërtesën që njihet si Pedagogjika e Peshkopisë dhe që është edhe sot në qendër të qytetit, mësimi ka filluar në vitin 1948, si për maturën e parë, ashtu edhe për nxënës të shkollës së Dobrovës, që u bartën në shkollën e re, ku ishte konvikti. Konvikti në shkollën pedagogjike i përkiste kati i nëndheshëm, ose bodrumi, siç i thoshim ne, ku ishte mensa, kuzhina, magazinat, rrobaqepësia dhe disa anekse të tjera përkatëse. Në katin e fundit ishin dhomat e fjetjes. Dy katet e mesit ishin me klasa. Po kjo ndarje ndryshonte se ishte e njëjta drejtori, e njëjta administratë: drejtori i shkollës ishte njëkohësisht dhe drejtori i konviktit. Krahës nxënësve që vinin për të ndjekur shkollën pedagogjike, kishte edhe nxënës konviktorë që ndiqnin shkollën shtatëvjeçare “Demir Gashi”, por që jetonin në konviktin e Pedagogjikes. Fjetja nëpër dhoma, ngrënia në mensë, veprimtaritë kulturore dhe artistike bëheshin të përbashkëta si shkollë dhe si konvikt. Kështu, si shembull, një kontingjent jo i vogël i nxënësve që ndiqnin shtatëvjeçarën, vinin nga ish - konvikti i Shupenzës, i cili në vitin mësimor 1953-1954 pushoi së ekzistuari dhe nxënësit i sollën për të jetuar në konviktin e Pedagogjikes në Peshkopi. Një prej këtyre jam edhe unë.

Shkolla pedagogjike e Peshkopisë është një shkollë me arkitekturë të përsosur, shumë e përshtatshme për një institucion arsimor, me korridore të gjera dhe plot dritë, me hyrje dhe dalje të shumta, që, edhe kur mbushej plot me nxënës, nuk krijonte rrëmujë dhe furje. Klasat ishin të mëdha dhe ndriçoheshin me nga katër dritare secila, po kështu edhe korridoret. Drita ka një rëndësi të veçantë për shkollën. Tomas Fuller thotë: “Drita, bija më e vjetër e Zotit, është bukuria hyjnore e ndërtesës”. “Të jesh arkitekt i mirë, do të thotë ta lësh dritën brenda”. “Arkitektura është vullneti i një epoke, i përkthyer në hapësirë”, - thotë Roke. Hapësira në shkollën pedagogjike është kudo e pranishme. Në Peshkopi janë ndërtuar mjaft shkolla të reja, madje edhe në vitet e fundit, me projekte të zgjedhura, por asnjë shkollë, si ndërtesë, nuk mund të krahasohet me shkollën pedagogjike të asaj

Pedagogjika

“

Shkolla pedagogjike, për vetë qëllimin që kishte, do të bëhej përbashkuese, unifikuuese, duke përpunuar dhe kanalizuar energjitë në mënyrë krijuese, në përputhje me direktivat e sistemit tonë arsimor dhe të sistemit edukativ në procesin e mbijetesës dhe të formimit të një kolektivi të madh... Energjitë e secilit prej nesh mund të çliroheshin pikërisht përmes individualitetit të secilit dhe jo prej humbjes së tij.

”

kohe. Vendi ku ishte ngritur ishte më i përshtatshmi që mund të bëhej për atë shkollë. Zakonisht shkollat ndërtohen në periferi. Për shembull, nuk mund të ketë një shkollë në sheshin “Skënderbej”, pranë ministrive e të tjera vende që mbahen si qendra të qyteteve. Por shkolla pedagogjike pikërisht aty, në qendër e kishte vendin. Nuk ishte në qendër vetëm fizikisht, por edhe metaforikisht, si vatra e dritës dhe e diturisë, e përparimit dhe e kulturës, që rrezatonte në mbarë qytetin dhe më larg. Ishte e vetmja ndërtesë që jo vetëm nuk stononte nga asnjë pikëpamje, por që lidhej me shpresën dhe dëshirat e çdo qytetari. Ja, aty, në sheshin kryesor të qytetit, me hyrje nga bulevardi i blirëve, në çdo orë të ditës shikoje dhjetëra të rinj dhe të reja, që arsimoheshin për ta përhapur dritën dhe kulturën në çdo skaj të rrethit. Qytetarët e Peshkopisë nuk e kanë kontestuar shkollën pedagogjike për vendndodhjen. Ata kanë kontestuar bustet e heronjve, të dëshmorëve që nuk i shikojnë si të përshtatshëm për vendet ku janë ngritur. Ata kishin pasur gjithnjë ëndërr dhe dëshirë të madhe arsimin, dritën dhe kulturën. Kjo ëndërr u realizua me pedagogjiken. Qytetarët e ngritën në rang

pedagogjiken, duke e konsideruar si universitetin e tyre. Ne, pedagogjikasve, na quanin “studentë”, kurse mësuesve tanë u thërrisnin “profesorë”. Këtë e bënë për respekt, nga dashuria, jo nga ajo çfarë ishim, por çfarë përfaqësonim. Edhe skuadra e futbollit e shkollës sonë quhej “Studenti”. Shkurt, për ata, qytetarët, ne ishim universitarë. Vite e vite më vonë në Peshkopi u ngrit edhe Universiteti, megjithëse filial i Universitetit të Durrësit. Pushtetarë injorantë e të korruptuar e mbushën atë me pedagogë dhe drejtues pa nivel dhe brenda një kohe fare të shkurtër ky institucion i rëndësishëm arsimor degjeneroi aq shumë, sa diplomat e tij u bënë të pavlefshme. Studentë, të pesës e të gjashtës, nuk kishin asnjë aspiratë për të studiuar, mbasi ajo palo diplomë blihej shumë lirë. Me të drejtë qeveria e mbylli atë institucion arsimor.

Po le të shkojmë tek pedagogjika e asaj kohe. Në shkollën pedagogjike të Peshkopisë kanë mbaruar shkollën shumë breza. Këtu unë po sjell vetëm maturën e parë: Zenel Sula, Skënder Sharku, Emin Jashari, Moisi Cami, Besnik Bedalli, Shefqet Hoxha, Ismail Erebara, Mefat Shehu, Avni Agolli, Milaim Peza, Shaip Halilaj, Lutfi Hanku,

Ruzhdi Ndreu, Fehmi Ndreu, Ilir Ramizi, Selaudin Trepça, Hamit Bjaraktari, Tahir Domi, Zija Shehu.

Kurse vajzat e para të shkollës pedagogjike të Peshkopisë ishin: Naxhiye Sahitaj, Lavdie Plaushi, Fanie Hoxha, Selvie Lusha, Bukurie Lleshi, Sanie Berisha, Teuta Kurmaku, Kurrie Lahu, Bukurie Loka, Sanie Zeneli, Tefta Cami, Emine Skënderi. Emrat janë vënë në bazë të një fotografie dhe, për këtë arsye, mund të kemi harruar ndonjë.

Në shkollën pedagogjike kanë ardhur nxënës nga të gjithë fshatrat e rrethit të Dibrës dhe nga rrethe të tjera të Shqipërisë, si: Tropojë, Mat, Lumë etj. U mbledhën dhe u gërshtuan kulturat, dialektet dhe nëndialektet, veshjet e grave dhe të burrave, psikologjitë, mënyra e jetesës, doket, zakonet e të tjera e të tjera. Veçoritë e krahinave nga vinin nxënësit përbënin larmi, diversitet nga pikëpamja etnokulturore dhe këto janë burime pasurimi. Shkolla pedagogjike, për vetë qëllimin që kishte, do të bëhej përbashkuese, unifikuuese, duke përpunuar dhe kanalizuar energjitë në mënyrë krijuese, në përputhje me direktivat e sistemit tonë arsimor dhe të sistemit edukativ në procesin e mbijetesës dhe të formimit të një kolektivi të madh. Përparimi dhe unifikimi do të vinin ngadalë, por jo me qëllim rrafshimi të individualiteteve, diversiteteve, bjerrjes së vlerave fillestare, jo duke i kthyer të gjithë në një “emërues të përbashkët”, por duke bërë integritet të buta të karakterit kulturor që ka si përparësi ruajtjen e personalitetit dhe të dinjitetit të secilit. Energjitë e secilit prej nesh mund të çliroheshin pikërisht përmes individualitetit të secilit dhe jo prej humbjes së tij. Vajzat dhe djemtë e pedagogjikes do të vinin duke u civilizuar dhe kulturuar, duke u përshtatur dhe integruar, por pa u tjetërsuar, pa humbur anën burimore të formimit fillestar. Kjo ishte më delikate për vajzat e reja, që, duke u ndodhur në një mjedis të ri, në emër të ndryshimit dhe të përvetësimit të një kulture të re, të një mënyre të re jetese, mund të mbuloreshin me një lëmysht artificial kulture dhe jo me kulturë të vërtetë. Luftohej shumë aso kohe për emancipimin e femrës. Femra nuk mund të fitonte pushtet dhe autoritet me anë të konferencave të thata dhe banale ku thuheshin të njëjtat fjalë, nuk mund të fitonte asgjë nga puna rutinore dhe formale e kryesisë së gruas; femra mund të bënte ndryshime nga kahja pozitive duke u arsimuar, duke u bërë mjeke, mësuese, inxhinierë, shkurt, duke shkruar drejt një pavarësie relative dhe integruese. Vajzat e para që guxuan të vinin në shkollë, të jetonin në konvikt, të merrnin pjesë në mbrëmjet e vallëzimit, të mësonin të kërcenin me burra, të merrnin pjesë në grupet artistike, në veprimtaritë sportive, shkurt të bënin atë që nuk e kishin bërë kurrë, patjetër do të ndesheshin edhe me një opinion frenues. Opinioni përgjithësisht është negativ. “Opinioni është një qen që leh për diçka, të tjerët lehin me të”, thotë një fjalë e urtë kineze. Kurse Rixha shprehet kështu për opinionin: “Opinioni publik është një tiran vulgar, arrogant, anonim që në mënyrë të vendosur e bën jetën të pakënaqshme për cilindo që nuk është i kënaqur me të qenit mesatar”.

Vajzat që në fillim erdhën me kostumet tradicionale të krahinave të tyre, u veshën si qytetare. Ky, natyrisht, ishte një hap përpara, por ishte e dëmshme që kostumi popullor të flakej tutje si i padobishëm, i turpshëm. Përkundrazi, ato kostume duheshin ruajtur, që, për raste festash dhe ditësh të tjera, vajzat e reja dhe të bukura t’i vishnin që të mos humbej ajo larmia dhe bukuria që sollën në fillim. Veshja ka të bëjë shumë për njeriun. Sidomos për vajzat e reja.

* Shkëputur nga libri “PEDAGOGJIKJA DHE YJET E SAJ” i autorit Xhafer Martini

Bëj pajtimin tënd me



përmes emailit

<rrugaearbërit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA

është vetëm në versionin PDF.

Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit

ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

*Ne nuk jemi gazetë
e pavarur, ne jemi
gazetë e lirë dhe
pavarësia jonë
garantohet vetëm
nga mbështetja e
lexuesve...*



Nga prof.dr. Bajram XHAFA

Pedagogjikja jonë sivjet ka 70 vjetorin. Shkol-la e Mesme Pedagogjike e Peshkopisë i hapi dyert e saj më 1948, plot 70 vjet më parë. Ishte shkolla e parë e mesme në gjithë rrethin e Dibrës, rreth që shtrihet nga Lura dhe Kalaja e Dodës në veri deri në fshatin Llangë, në jug, që tani i është aneksuar rrethit të Librazhdit. Por ajo do të shërbente edhe për rrethet e tjera verilindore të vendit si Mat, Mirditë, Kukës, Tropojë, Krujë nga furnizohej me kontigjente nxënësish. Në këtë kuptim, ajo kishte karakter regjional. Rrethi i Dibrës dhe vetë Peshkopia si qendra e një rrethi të madh do të kishte peshën më të madhe. Ishte shkollë profesionale e destinuar të përgatisë mësues për katër klasat e para të shkollës fillore, aq shumë të nevojshëm për vullnin që mori zhvillimi i arsimit në këtë periudhë. Por shumë prej atyre që mbaronin këtë shkollë jepnin mësim edhe në shkollat 7 vjeçare (unike).

Shkolla të mesme pedagogjike atëherë kishte në Shkodër, në Elbasan, pasardhësja e Normales me famë dhe në Tiranë, pasuesja e Institutit Femnor “Nana Mbreteshë”, pa këtë emër të “mallkuar”. Shkollës së Peshkopisë iu dha si emër nderi “8 Nëntori”, në referim të datës së themelimit të PKSH-së, çka në thelb ishte, si në çdo gjë, një egidë (égida, mit. egjidë-mburojë e Zeusit) ideologjikë me efekte propagandistike.

Me rastë jubilesh për Pedagogjikën kanë shkruar edhe më parë, për shkollën, për mësuesit, për seriozitetin e saj, për rezatimin dhe vepritaritë kulturore, artistike e sportive etj. Prof. dr. Muharrem Dezhgiu, ish nxënës i saj e çonte vlerën e saj në shkallën e një universiteti. Shkrimtari dhe studiuesi Xhafer Martini ka bërë gjithashtu një libër për të. Duke kujtuar shkollën, kujtojmë pjesën më të bukur e më flurore të jetës sonë dhe përtërihemi, përtërijmë mbase edhe të tjerët, por japim edhe mesazhe për fëmijët, për brezat që vijnë. Kujtimet e vegjëlisë janë ushqim i shpirtit. Unë dua të jem pak më “personal” në ato që dua të kujtoj, por gjithsesi, besoj, aty kanë ngjashmëritë edhe shumë të tjerë.

Shkollimi i djemve dhe vajzave të fshatit, në përgjithësi bartin “histori” pikante, ndonjëherë edhe ndonjë dramë dhe, sado të ndryshme, ato kanë pika takimi. Unë, shkruesi i këtyre radhëve i takoj atij brezi të shkolluarish që Filloren dhe Uniken (edhe kështu quhej shkolla 7 vjeçarje) i kreu nga fundi i të pesëdhjetave të shekullit të kaluar. Që nga klasa VI deri në të XV, dhjetë vjetë pa dâ i kam ndjekur me bursë shteti, me jetë konvikti. Nga këta, pesë vjetë në konviktin e Pedagogjikes. Në atë konvikt atëherë kishte edhe një kontigjent nxënësish që ndiqnin shkollën 7 vjeçare të Peshkopisë, sepse në fshatrat e tyre ende nuk ishin hapur të tilla. Njëri nga ata isha edhe unë. Po, si ndodhi që u gjenda në atë konvikt dhe pastaj u bëra “konviktor i përjetshëm”?

Më Peshkopinë isha “njohur” që në fëmijërinë e hershme. Kisha probleme me shëndetin prandaj im atë, pasi më vinte kaluar në atë mushkën e zezë, më shpinte për vizitë në spital të Peshkopisë. Atëherë nuk kishte penicilina dhe sëmundjet e mushkërive ishin rrezik i madh, por doktor Fredi, Fred Paparisto, që baba i thoshte doktor Feriti, mori angazhime të forta dhe ja doli. Gjithsesi, ecejaket qenë të shumta dhe Peshkopinë mund ta shihja shpesh, madje edhe rritjen e saj. Bulevardi i ri dhe një gjenerator dritash elektrike në xhadenë poshtë prefekturës së sotme që bubllonte sapo fillonte errësira i jepnin dimension dhe integritet qytetit.

Pasi mbaruan filloren në fshat më 1957, Agim Xh., Beqir L., Elmaz L. dhe Sabedin T. kishin vendosur të ndiqnin 7 vjeçaren në Shupenzë si nxënës vullnetarë mbasi Kovashicën nuk e kapte rrezja e detyrimit të 7 vjeçares. Unë isha shumë i dashuruar me tufën, dhentë dhe dhinë e mia.

Duke kujtuar Pedagogjikën e Peshkopisë

Duke e ditur lidhjen time emocionale me ta, im atë m’u drejtua me një ton që nuk lente hapësirë për diskutim: do të shkosh edhe ti në shkollë në Shupenzë me shokët. Ma kishte zënë njëherë më parë, por e pata kundërshtuar. Pastaj la një periudhë maturimi. Shkurt muhebeti, më shumë me detyrim se me vullnet, fakt që pati edhe një “mikrodramë”, të cilën nuk po e zgjas, shkova dhe unë dhe kreu klasën V. E fillova me mërzi të madhe, pasiguri e frikë, zvarrë-zvarrë, me mendje hava e mungesa të mëdha, por rrugës fillova të zgjohej dhe e mbylla me fletë lavdërimi. U ngjita. Ç’mund të dijë një fëmijë për jetën, për avënin e saj?

INTERMEXO: NGRITJA E KOOPERATIVËS BUIJËSORE NË FSHAT

Bërthama e kooperativës bujqësore në fshat ishte krijuar më 1955 me ndonja 7-8 familje, por ishte sa për emër. Ndërkohë që vazhdoja klasën e pestë, viti 1958 ishte vit sulmi për kolektivizimin e bujqësisë. Në fshat zbarkoi ekipi i kolektivizimit me të deleguar të qeverisë (se, parti e qeveri njësoj ishin) për ngritjen e kooperativës. Për rëndësinë politike që kishte problemi, ekipi përbëhej nga autoritetet më të larta të partisë dhe pushtetit në rreth, përforcuar me personalitete edhe nga Tirana, me figura të luftës që kishin bërë luftë dhe ngrënë bukë në Dibër (kjo e dyta peshonte më shumë në lidhjen morale të dibranit).

Kishin një javë që në Kovashicë bëhej “luftë” për kooperativën. Aty në shkollën e fshatit. Ditën dhe natën. Kap njërin e lësho tjetrin. Por Kovashica nuk luante nga vendi. Duhet të ishte muaji prill 1958. Një ditë, im atë me atë shtatin e lartë si lis ndërsa po zbriste drejt shkollës ku bëheshin mbledhjet, Ramiz Leka, një mësues i ri nga fshati, i thotë sekretarit të parë, Tahir Minxhazit: E shikon atë burrë që po vjen, ai i duhet kooperativës, se ai e mban edhe vetëm atë e s’ka nevojë për të tjerë; Punon sa për dhjetë vetë, si traktor. Këta të tjerët që ke pare këtu janë kot, nuk i ke për punë. Ata vetëm llafe kanë se në punë nuk bëjnë një metelik. Liman e quajnë. Pikërisht aty e përqendroi vemendjen kryesore edhe ekipi.

Limani i pa shkollë dhe emocional, i bindur në varfërinë e mjeteve në fushën e luftës me llafe, se për tërheqje litari kush mund t’i delte, ra në hall të madh. Në ato spartakiadat midis lokaliteteve, kur ngulte këmbën në një gropëz dhe uqë e bënte enkas, nuk kishte traktor që ta shkulte dhe garën gjithmonë e fitonte Shupenza. Por këtu puna ndryshonte. Prandaj fliste pak dhe nuk hynte në arsyetime se shpejt mund ta “lidhnin” me fjalë. Vetëm përsëriste deri në mërzitje: Nuk mund të hyj në kooperativë sepse jam i vetëm, sapo jam ndarë me vëllaun, nuk kam krahë pune, kam një tufë fëmijë për të rritë, se të gjithë janë për bukë goje etj. kësisoji. Dhe si fjalë të fundit, ‘do të më vdesin fëmijët për bukë’. Ky ishte fisheku i fundit i “ligjërimit” të tij.

Ato të ekipit hidheshin pastaj në degën tjetër. Ti sh. Liman ke qenë edhe partizan, ke luftuar kundra armiqve, ke dhanë prova si trim e patriot, prandaj,... por këto ishin fjalë që këndeji i hynin e andej i dilnin, madje as nuk i arrinin fare deri tek veshi. Partia tek ti ka një patriot të vërtetë e luftëtar të vjetër...llaf për mbasnesër, thoshte me vete. Në një moment tensioni e nervash, lodhjeje e dobësie, me një zemërim të shtirur, Zoi Themeli, që zotëronte edhe teknikat e punëve të ministrisë së Brendshme iu “hakërrye” me ton të fortë por edhe miqësor: “Po të vdesin fëmijët e mi, le të vdesin edhe të tutë; fëmijët e tu do të vdesin atëherë kur më parë të vdesin të mitë. Këtë ta garantoj unë” dhe iu hodh në qafë. E “lidhi”, e preku në burrërinë e malësorit, me fjalë e me gjepte. Kishte fjalë më të madhe? Çdo kundërshtim i mëtejshëm iu duk paburnri. Epo burri qëndron, por jo në paburnrinë e tij, mendoi. Kur tjetri dorëzon fëmijët e tij, edhe të tutë nuk janë më të mirë. Gjithë këtë rixhâ, gjithë këta burra, duhet të kenë një hall të fortë, përtej jetës. Ka rixhâ më të madhe që mund t’i bahet burrit? Njeriu duket në të pame. Vështirë të dalloje ndonjë hile në gjithë këtë këmbëngulje. Këtë gjë, ata nuk po e bënin për veten e tyre.

Trupmadh dhe i fuqishëm siç e kishte bërë Zoti, të gjithë i kishin sytë dhe shpresat tek ai. Do të qëndronte apo jo. Dukej si mur fortëse. Pa dashjen e tij, puna e nxorri në ballë. Po ra

ai, binte krejt kalaja. Përgjegjësia tashmë nuk ishte vetëm personale. Ra ngushtë, por më së fundi u thye. Me gjysëm zëri shtoi: Sëpaku të më çoni fëmijët në shkollë. Unë vazhdoja klasën e pestë. Me gjithë qejf i thanë dhe iu hodhën në qafë. Limani u dorëzua, Limani u dorëzua, thanë shokët e mëhallës. Në fakt shokët ishin lodhur e dorëzuar me kohë, por deshën një alibi për t’ia “lanë peçën” tjetrit.

Ndërsa Limani zgjati dorën, një tjetër dorë u zgjat me lapsin kopjativ dhe një copë letër në dorë (formular tip) kishte qenë në gatishmëri dhe... katranosi një zhgarravinë si punë firme. Ajo s’ish firmë por...krisi automatiku me breshëri, gjëmoi dhe, u ça qielli. U “hapen” vorret në Kodër të Xhamisë, Maja e Sharrës ku flinin rrënojat e fortifikimeve romake u tronditën. Edhe maja e murrëtyer e Kishës, rrënojat e së cilës qëndronin mbi kodrën e lartë e të rrëpirët në formë piramide “luajti” vendit. Ishte trandur dheu.

Pastaj hodhën firmat edhe të tjerët pa bërë fjalë. Gjithë ajo luftë e gjatë “heroike” i la vendin komikes. Si koncesion për firmën që do të hidhte, Haliti, krejt i papërgatitur ç’të kërkonte si kundërpeshë, tha t’i jepnin një leje djalit që e kishte ushtar në Berat. Shumëkush qeshi. Në vend, i thanë, pa diskutim. Qamili kërkoi ëndërrën e vjetër: t’i jepej leje dyqani, të hapte përsëri aktivitetin privat që ia kishin mbyllur. Mendonte të bënte edhe njëherë ndonjë allishverish si dikur në kohën e Italisë me Kontin Ferra, atë tregtarin e famshëm nga Kruja. Ishte një kërkesë reaksionare, por ia pranuan dhe e lanë të shesë nja dy vjet ca çingërrima në mes pluhurit të pazarit të Shupenzës. Im atë krenohet më vonë për kërkesat e tij largpamëse që kishte bërë, për shkollën, për dijen, për të ardhmen. Mixhës Mersim që s’bënte ndonjë punë përveçse zotshpijëllikun dhe ndonjë transport në shpinë të mushkës, i erdhi në shteg. Or vëlla, ty të pakam mbajtë unë. Sapo u ndave nga unë dhe u bane vetë zot shpije, e dorëzove vatanin. Mixha, ndër të paktët, nëmos i vetmi në fshat, hyri në koope pas tre vjetësh.

Përballë shkollës së fshatit ku revolucionari agrar i Kovashicës malore po shënonte “kthesën e madhe” leniniste, qëndronte e heshtur e mosbesuese xhamia e vjetër e fshatit me minaren e shkurtër mbi çati dhe “Vorrin e Mirë” ngjatë saj që ushqente shpresat për dermanet e pa derman. Që viti (1958) kur dhe Hoxha i Madh, hoxha i bukur por i sertë i fshatit, Shaqir Tomja, tashmë e la këtë dynja. Në fakt kishte katër vjet që ai e kishte lënë Kovashicën me gjithë Tri Gjurrat e ftohta dhe ishte vendosur në Gjoricë.

VERË - 1958

Atë verë të nxehtë e kalova mes baltës dhe pitave (qerpiç) duke ndihmuar babën (i cili bënte ustain) për ndërtimin e avllisë dhe ngritjen e një ahri për bagëtinë, dhjetë metër të gjatë dhe mbi tre meter të lartë. Një konak i vërtetë. Kishim dalë tym më vete dhe dilnin nevoja të reja. Duhet të përgatisja baltën për pita dhe ngritjen e murit. Të bëja punëtorin ndihmës; të afroja gurët, të bëja e të furnizoja mjeshttrin me baltë dhe pita. Baltën ta ngjisja përmjet një shkalle druri me kopankë mbi njërin sup dhe pitat t’i trasportoja me tezgë (tezgjërë). Pastaj punët e tjera në arnitë dhe kopështhin që ishin larg (prashitje, ujitje, mbushje e mistririt), tek Gjurma e Te(j)me, në Shullë e në Kishë (Kajshë, një kodër e lartë përmbi Mëhallën e Epër) për drutë e dimrit, me vu mullarët e gjethëve, që ishte një torturë e vërtetë.

Me që ra puna e gjethëve, nja dy “thërmija” nga tradita dibrane, për gjethët:

1. Prej lemerisë që i kishte futur aksioni i vumies së gjethëve gjatë vapës së gushtit, një dibran kishte marrë arratinë. E kishte mbajtë vrapin në Stamboll. Pas ndonja 20 vjetësh kishte takuar një refugjat të cilin të sapo ardhur, dhe kur pa se ishte shqiptar, e kishte pyetur se nga cila krahinë ishte. Nga Dibra, i tha ai. A venë më gjethë atje në Dibër, e kish pyetur. Ende nuk i kishte dalë e keqja e gjethëve. Me këtë rast baba më pasuronte anën historike të problemit.

2. Qazim Sermenja, një i ri nga Katundet e Epra, nga Selishta, aty nga viti 1954, një ditë gushti po vinte gjethët për bagëtinë për dimër. Vapa e gushtit, djersët çurkë, ndezja e lëkurës që i shkaktonte fërkimi për trupi i dushkut dhe fshikullimet e thuprave të thata të degëve ja ngritën

ampermetrin. I shkoi mullarit në majë dhe po i vinte krifën (kraffën) e fundit që do ta siguronte mullarin e gjethes nga pika e shiut por iu sos durimi. E kapi damari, la punën, zbriti nga mullari dhe ja mbathi. E ndali vrapin në...Amerikë.

Të kthehemi ku ishim, tek punët e fshatit. Pa numrim. Natën duhej të flija jashtë për të kullotur mushkën e re nëpër hamullore. Me dy lëkurë të rrjepura nën brinjë, një jastëk të vogël dhe një velenxë si mbulesë, vështroja yjet dhe bisedoja me ta. Pastaj ngrihesha kur rrezja e parë e diellit më lante atje lart në Rrafshë të Melicës me kafshën ngarkuar, i gatsëm për t’u kthyer në shtëpi. I nxirë e i regjur nga ajo verë e mundimshme, mos të raftë shorti me punue me babën tim se të “delte” shpirti. Vetë ishte punëtori i madh e nuk i linte kusur e për punë kishte shokë veten. Këtë e kërkonte edhe nga të tjerët. Por ishte edhe një tjetër, që ishte “dexhal”. Ne bëjmë njëmijë pita në ditë, më thoshte, ndërsa Liman Xhiveshi në Okshatinë, i vetëm bën dy mijë pita në ditë. Shembull ma konkret për emulacion nuk kishte. O Zot! Unë ende isha një kërhí dhe duhet të matesha me dexhalin. Më kaliste mirë, për të ardhmen. Më vlejti shumë, por puna e krahut nuk m’u nda gjithë jetën. Qenka me të shkruar. Krushku i hollë e i gjatë, bjen n’zanat që t’la yt atë.

Duke e kthyer kokën mbrapa, nga lartësia e mbi 70 vjetëve që më rëndojnë mbi supe, kam frikë të them se ndoshta ka qenë pjesa më mbresëlënëse në jetën time. Kurrë nuk e kam përjetuar më pas atë mobilizim e angazhim familjar, atë harmoni, frymë të lartë e solidaritet të mrekullueshëm. Motra e madhe vinte të më zvendësonte për pak kohë tek balta, ndërkohë që duhej të hidhej pastaj në frontin e punëve të nanës që kishte fëmijën për gjiri. Me mbush ujë në gjurrë, me fshi oborrin, me marrë krane e me ndezë zjarrin për përpunimin e bylmetit dhe, me dalë në punët e kooperativës, nga vinte zëri i çjerrë e gjithë nervozizëm i brigadier Faikut. Ishte a s’ishte 15-16 vjeç. Edhe për vëllaun e vogël që po bëhej dhjetë vjeç, kishte punë sa të të hajë zogu i qejfit.

Gjymtyrët e mekanizmit familjar funksiononin në harmoni e mirëkuptim. Baba ngrinte mure, dikush bartte baltë, dikush mbushte ujë, dikush fuste gjanë e gjallë në vathë, dikush i mjetle, dikush kruante kusinë e tamlit, dikush...Një simfoni e gjallë e jetës njerëzore. Si mizat e dheut (milingonat) ose më mirë të them, si bleta. Vetëm gjyshja me atë xhupen e malësorese prej shajaku të bardhë dhe gajtana të zes (bijë Gjuras) rrinte në divanhanen e freskët dhe bënte sintezën e mbi 80 viteve të jetës së saj: Kanë ardhë kohë të këqija; mjerë ju që u kanë zanë. I thoshte këto, megjithëse kishte parë e kaluar në jetën e saj tri herë zjarrin dhe shpatën e soldateskës serbe duke ikur me djepin në shpinë e fëmijët kapibaç, si dhe dy luftëra e Mëdha. Në gjithë atë ngarkesë pune, shqetësimesh e tensioni, nuk mbaj mend ndonjë zemërim a hatëmbetje dhe, mbi të gjitha...kishte plotë të qeshura. Zhurmë, jetë, rritje; puna ecte, hidhnm shtat.

NGJITJE NË “KTHESË TË FORTË”

Baba paskesh pasur projekte dhe programe afatgjata. Nga fundi i gushtit, pas një dite të gjatë 18 orëshe punë kapitëse, sapo u ngrit sofrja, baba i thotë nënës, ashtu enkas: Nesër bane hazër atë voc se do të shkojmë në Peshkopi. Do të bëjmë regjistrimin në shkollë. Fjalët ishin të natyrës urdhëruese, pa hapësirë për diskutim. Gjërata ishin të njohura. U gëzova. Do çlirohem, nga puna. Nanës i theri në zemër. Do të ma largojnë djalin. Në heshtje e me sytë e mbushur, ajo palosi një këmishë pëlhurë që e kishte prerë dhe qepur me dorë të vet, një palë mbathje po ashtu dhe një kanotjere që ma kishte dhuruar djali i hallës për një sebeb dhe i futi në një strajcë të vogël. As një gjel plaçka. Kaq ishte gjithë “paja” ime. Kanotierja më gëzonte më shumë. E veshja për herë të parë dhe, kur të luaja top, do të dukeshja njëllor si fëmijët e qytetit. Ama kisha një palë pantallona kadifeje blu të fortë, padyshim shumë të bukura. Fundet e këmbëzave të tyre ishin të përshkuara nga lastikë që i mbledhin pas këmbës, jo të lëshuara. Kështu ishte moda e fshatit. Për këpucë as që më shkonte mendja. Opinga lastiku dhe, nga ato me gjalma dhe çajça si skep pule, që kur hapeshin në majë, dukeshin si goja e hapur e dallëndysheve të vogla kur e ëma u jep ushqim. Jo nga ato me rripa lastiku, se ishin më të shtrenjta.

(vijon në faqen 16)



Duke kujtuar Pedagogjikën e Peshkopisë

(vijon nga faqja 15)

I larë e i qëruar dhe me opingat shtërguar fort, të nesërmen herët u “hypëm këmbëve” dhe morëm rrugën via Kovashicë - Qafa e Shtushajve – Gjurma e Mazhicës, në Qafë të Hoteshit, tek Ura e Telit e në Peshkopi. Me qylafen e bardhë mbi krye, baba para unë mbrapa, drejt e në seksion të arsimit, në fund të bulevardit. Hymë në një zyrë e vogël ku brenda gjetëm dy inspektorë, njëri në ballë e tjetri në qoshe. Urdhno xhaxhá, çfarë deshe, pyeti i bezdisur? Kam ardhë të regjistroj djalin në shkollë. Regjistrimet janë mbyllë xhaxho, plani asht mbushë, nuk ka ma regjistrime. Por mua ma ka dhanë fjalën Tahajr Bixhozi, i thotë baba me theks dibran emrin e sekretarit të parë. Shoku Tahir nuk asht këtu. Ka shkue në Moskë për studime. Oh, i mjeri unë. Nuk kanë thanë kot se kur ngrihet të kcejë fukaraja, griset lodra. Inspektori tjetër në tavolinën në qoshe të zyrës, zhytur mbi shkresat e tij u përmend dhe ngriti kokën. Po, tha, shoku Tahir ka lanë porosi me shkrim dhe tregoi letër-porosinë. O Zot të qofsha falë! Paska qenë burrë, mendoj baba. E bekoftë Zoti!

Me telefon mori n/drejtorin e konviktit të Pedagogjikes, Medat Agollin. Do të paraqiteni tek konvikti i shkollës Pedagogjike, na tha, tek ajo ndërtesa e madhe. Të çliruar nga pesha e gjithçkaje, e dyshimit dhe e pasigurisë, fluturuam për atje. Në ndërtesën madhështore të Pedagogjikes hymë nga dera kryesore. Sipër saj, në katin e dytë ishte një ballkon për të cilin mendova se duhet të shërbejë si tribunë për të mbajtur fjalime. Se kështu ishte atëherë, popullit i mbaheshin vazhdimisht fjalime dhe ai ushqejhej me to. Apo për t’u folur nxënësve për punët e shkollës. Sipër tij ishte edhe një tjetër ballkon, por ai nuk mendova se mund të shërbente për fjalime se nuk mund t’i flisje popullit kaq në havá, por me gojë nuk thashë ndonjë gjë nga frika se mos them ndonjë budallallëk.

N/drejtori, një burrë fisnik, na priti ngrohtë dhe plot ëmbëlsi. Ishte shpirt njeriu. Si i zoti i shtëpisë që ish, pas pyetjeve miqësore plot mirësjellje, shënoi ç’duhej, pastaj tha: Djalni lene këtu dhe ti, i tha babës, kthehu pa merak në shtëpi, sepse për djalni do të kujdesemi ne. Qysh sot në drekë do të hyjë në forcë. Dhe u ngrit e i dha dorën. Baba mori rrugën e kthimit në fshat, ndërsa unë, pasi u solla pak deri sa erdhi koha e drekës, zbrita shkallët dhe drejt e... në mencë, në katin poshtë. Kishte mish me lëng dhe makarona, dy gjellë. Më kishte marrë urija. Dreka shumë e shijshme. Ishte standard shtetëror e jo për hatër, siç bante nana kur, për të më favorizuar, mernte fteren, lugën me tëlënë dhe ndonjë kokërr vezë, si trajtim i veçantë për barrën e rëndë që më ishte ngarkuar para kohe. Edhe kjo mund të kishte ndopak “probleme”, se të tjerët i kishin sytë kapur. U futa në grazhd të qeverisë, në bukë të grintë, të grunjtë. (Gjatë gjithë periudhës 45 vjeçare të socializmit enverist, fshati hante vetëm bukë misri dhe t’ia bënte duanë fort).

Kujdestare e konviktit ishte një mësuese e re, me sjellje të ëmbël e me një fytyrë engjellore. Çalonte nga njëra këmbë, por Zoti e kishtë kompensuar me virtute të larta njerëzore. Ishte si melek. Sa nevojë kisha për butësi dhe ëmbëlsi, sepse sapo kisha lënë shtëpinë dhe njerëzit e mi. Isha si i shushatur. Më kishte ra për hise pjesa e parë e alternativës së fatit: “Ëngjej dhe djaj”. Pasdite dola “shëtitje”, se në qytet njerëzit shëtisin. Nuk ua marrin për keq. Isha i lirë. Asnjë angazhim. Nuk më thërrisnin më as dhentë as dhitë, as dy lopët që duheshin lidhur e më pas zgjidhur që t’u jepje ujë, as mushka e re e pashilume, as ara e as livadhi, as radha e hurd-hës për kopështin. Askush dhe asgjë. Fshati është i rëndë. E flaka tutje robërinë e fshatit. Ua lashë të tjerëve. Ç’do të jenë duke bërë në këtë kohë? Nana? Punë pa numërim. Shpejt do të vinte akshami për të mjelë lopën, dhentë e dhitë me kusinë e zezë në dorë në të cilën i binin lotët pa dâ. E dija. Po vëllau, po motrat ç’farë bënin në këtë kohë? Të gjithëve dhe të gjithave u kisha kthyer shpinën. Më dukej pabesi. Shpejt ndjeva një boshllëk. Ç’bëhej atje në këtë orë me...kur nuk isha unë? Më kaploi një mall dhe keqardhje. Për kë? Për të gjithë, për gjithçka. Ua kisha bërë me hile.

INTERMEXO

Mora poshtë nga Pazari, ndërsa lartë ngjiste të përpijetën e xhades së kalldramtë plot mundim një makinë e vjetër, sovjetike, një zis nga ato të viteve ’30. Në kabinën e shoferit ishte rehatuar një burrë që i binte fizarmonikës. E kishte lshu në dizën. Me sy të perënduar dhe i zhytur në ëndërrime, shoqëronte

Në vendin ku ishte vendosur dhe në raport me ambientin që e rrethonte, ndërtesa katër katëshe e Pedagogjikes kishte një pamje madhështore. Në trajtën e një katërkëndëshi këndrejhtë, me pozicion ballor të ekspozuar nga jugu, pamja e saj binte mbi bulevardin kryesor dhe të vetëm të qytetit, nga trotuari...

një këngë nga ato të vaktit që ta këpuste shpirtin. M’u ngulit në vesh dhe m’u fut në shpirt vetëm një gjysëm vargu që arrita të kap: “O nji hajse shkretë”. Varg që kishte brenda gjithë dramën shqiptare, dramën dhe tragjedinë. Këngë vaji shoqëruar me një melodi edhe më të përvojshme. Nga ato me fund tragjik të djalit të vetëm dhe të një nëne të mbetur qyqe me dy duart në gj. Të ngjethej mishi. Për nga motivet ishte e përngjashme me një tjetër këngë, vaji natyrisht edhe ajo, dy vargje të së cilës m’i dridhnin telat e zemrës, këngë që në thelb kishte mallkimin: “Oj u thaftë mor ky Mali Zii-e./ Si s’u gjet o nji ujë me pii-e” dhe që përfundonte me nji “ani-se”, që do të thotë se kanga mbaroi.

Duhet mësuar shqiptari me mesazhe të tilla të vuajtjes, të tharjes, të shkretimit edhe kur ka gëzime. Asgjë s’duhet ta ketë të sigurtë. E keqja dhe mjerimi duhet t’i tkurrë zemrën e t’i molisë shpirtin, t’i bëhet rrobë. Grupi i këngëve të mjerimit duhet t’i bëhen lajtmotiv i jetës. Në çdo formë që të përcillet, zëri është komunikim me Zotin. Vetë fjala lahut (ë) vjen nga arabishtja, la (h)-ut) që do të thotë, “zë për atje lart”, “zë për tek Zoti”. Çdo këngë është një kumt. Duket si një strategji edhe për këngët, folklorin, kulturën, dhe shpirtin e shqiptarit Psikoza e mallkimit: u thaftë, u shkrettë, u djegtë, u përvëlloftë! Shqiptarit duhet t’i bëhet psikozë vuajtja dhe mjerimi; të përballojë natyrshëm dhe pa u çuditur fundin tragjik që i përgatitet. Vetëm kështu duhet të mendojë.

Për të kështu është gatuar jeta. Jeta e tij në fije të perit. Pa të ardhme. Edhe Shqipëria një ngrehinë me ditët të numëruara. Një zgjidhje e përkohshme, kalimtare. Këngë si një thirrje, një lutje e një kumt drejtuar Zotit me vetëdashje nga vetë viktimat. Sapo kishte mbaruar periudha e dasmave për Sh’mëri, që, më së shumti është kohë e përzgjedhur për dasma në Dibër. Duhet t’i ketë lënë pa mend dëgjuesit e tij, mendova. Ishte Ismail Seferi, këngëtar i njohur i dasmave dhe ahengjeve që unë mezi ç’prisja ndonjë rast për ta dëguar. Si pararendës kishte Tufik Manukën, fizarmoniçisti i parë popullor dibran.

SHKOLLA DHE KONVIKTI

U regjistrova në “Demir Gashi”, klasa VI B. Aty do të bënim mësimet, para dite. Pastaj gjithçka do t’i nënshtrohej regjimit të konviktit të shkollës së mesme.

Në orën 05.30 zgjimi, higjiena e mëngjesit dhe rregullimi i krevatit. Një orë studim. Në orën 07.00 ngrënia e mëngjesit. Në orën 08.00 fillonte mësimi, pesë ose gjashtë orë mësimi. Në orën 13.00, ngrënia e drekës. Pastaj fillonte koha e lirë. Në orën 16.00 fillonte studimi: katër orë me nga një pushim 5 minutash. Konviktorët e 7 vjeçares e bënin studimin në një klasë më vete. Gjatë studimit kishte qetësi sa nuk kuptohej nëse ka nxënës në shkollë apo jo. Studimin e drejtonin vetë nxënësit, njëri prej të cilëve caktohej për të mbajtur qetësinë. Një edukator (kujdestar konvikti) “mbante rregullin”. Ora 20.00 - darka. Perfekt. Brenda asaj ndërtese kishte gjithçka nevojitej. Ishin të gjitha kushtet për formimin e një personaliteti të gjithanshëm, siç thoshte padagogjia.

Në vendin ku ishte vendosur dhe në raport me ambientin që e rrethonte, ndërtesa katër katëshe e Pedagogjikes kishte një pamje madhështore. Në trajtën e një katërkëndëshi këndrejhtë, me pozicion ballor të ekspozuar nga jugu, pamja e saj binte mbi bulevardin kryesor dhe të vetëm të qytetit, nga trotuari i të cilit e ndante një rrip i gjatë toke kthyer në lulishte gjithë gjelbërim e lule. Hyrjen kryesore e kishte nga krah u djathë, poshtë ballkonit, që përdorej më pakë, por kishte edhe një hyrje tjetër, po ballore, nga e majta. Bulevardit i bënin hije plepa të mëdhenj kanadaje, ndërsa trotualet në pjesën më të madhe ndaheshin nga lulishtat e bukura e të mirëmbajtura të qytetit nga parmakë të ulët druri të lyer me bojë. Cili i huaj erdhi në Peshkopi dhe

nuk u mrekullua nga pamja e saj, bulevardi i saj, lulishtat e saj. Nga gjysma e parë e viteve ’60, pasi u ngrit edhe Hotel Turizmi, diplomati Javer Malo mbeti i sugjestionuar nga pamja e bukur dhe kul-tura qytetare e Peshkopisë malore rrëzë Korabit, nga bulevardi dhe lulishtat e saj. Dhe shkruajti me përshtypje magjie. Turizmi, një “Hotel Dajti” rrëzë Korabit. Nga mezi i viteve ’70, plepat do të zevendësoheshin nga blirët me aromën e kandshme e qetësuese dhe pamjen impresionuese.

Kati i parë i Shkollës ishte nën tokë dhe e merrte në mënyrë të kufizuar dritën nga dritare të shkurtëra që uleshin poshtë tavanit deri mbi sipërfaqen e tokës jashtë. Këtu ishin vendosur menca, kuzhina, magazinat, lavanteria, ambientet higjenike, dhoma e punës dhe ambiente të tjera rezervë. Të gjitha këto i lidhte një korridor i gjatë me gjysëm dritare lart nën tavan që fushnin dritë nga oborri i pasëm ku ishin ambientet sportive. Në korridor ishin vendosur në rresht komodinat ku nxënësit kyçnin librat dhe ndërsesat e tyre.

Kati i dytë dhe i tretë, kështu po i quajmë, ishin destinuar për mësim. Klasat ishin të mëdha, të bollshme, me tavane të larta, me dritare gjithashtu të mëdha që fushnin pa kursim dritë dhe ngrohtësi. Kati i katërt shërbente si fjetore: nga e djathta për djemtë, në të majtë për vajzat. Në fillim të të ’60 –ve u bë një shtesë trekatëshe duke i dhënë ndërtesës formën e “L”-së, gjë e zakonshme me shkollat tona. Aty u vendos Shkolla Ushtrimore, ndërsa kati i tretë i saj u përdor si fjetore për vajzat. Bri saj, nga ana e oborrit u ngrit edhe një palestër klasi me të gjitha standardet bashkëkohore.

Pedagogjika e Peshkopisë ishte një ndërtesë luksi për kohën, dhe e tillë mbeti edhe më pas deri kur e “rinovuan” me ca xhamllëqe që ja humbën shijen dhe origjinalitetin, shkollë që, brenda një çatie i kishte gjithë ç’nevojiteshin: mencën për ngrënje dhe kuzhinën ku Shukriu ushtronte artin e kulinarisë (gatimit) që thuhej se e kishte nxënë në Stamboll. Aty ishin klasat, në dy katet e mesit, për mësim paradite e për studim pasdite; kishte klasë më vete për muzikën ku priste profesor Muniri (Shehu) me violinat e mandolinat e tij për të mësuar me vegël muzikore Këngën e gjelit, Nxënësin e rregullt, Bariun e vogël por edhe Lulja e allit e Moxartit e ndonjë pjesë tjetër nga klasikët e mëdhenj. Se edhe profesor Muniri ishte me të “vjetrën”. Poshtë ishte edhe “klasa” e punës me dru ku profesor Bujari (Elmazi) ushtronte skulpturën; pastaj, biblioteka e shkollës, mbushur me libra që e “menaxhonte” profesori i letërsisë dhe rrethi letrar; salla e kulturës me tavolinat e pingpongut, të shahut. Edhe palestra aty ishte, edhe ushtrimorja, shkolla filllore model për të praktikuar mësimdhënien; edhe fjetoret aty ishin, lart, nën çati. Nuk kish se ç’të na bënte as shiu as të ftohtit. Të gjithave ua kishim “lagur”. Edhe lavanteria po aty ishte ku Nanë Tixhja na lante rrobat dhe çarçafët (pastaj ia lehtësuan “pe-nalitetin” dhe e çuan si punëtore në kuzhinë; kishte qenë me biografi).

Klasat e mëdha me tavane të larta, me dritaret e mëdha që binin mbi lulishtën dhe bulevardin e qetë të qytetit plot gjelbërim, të rreshtuara vetëm nga njëra anë e korridorit, model i kohëve kur hapsirat ishin me bollëk. Si ndërtesë thuhej se ishte e mod-ëllet amerikane. Korridori me ato pllakat prej granili të lustruar që shkëlqenin dhe dritaret e mëdha nga fillimi deri në fund fushnin gjithë Dritën e perëndisë brenda. Nuk ishte si ato shkollat që u bënë më vonë, në vitet ’70, kur klasat e vendosura në të dy anët e korridorit e merrnin dritën e diellit nga një dritare e vetme si nga fundi i një tuneli.

Në orën 5,30 vinte xha Veseli (herë tjetër xha Haliti) që përshkonte dhomat e fjetjes duke i rënë ziles, një kumbonë dhishë, e duke e shoqëruar me ndonjë thirrje të butë prej prindi për zgjim. Higjiena e mëngjesit, fizkultura dhe 1 orë studim para se të hahej mëngjesi, buka dhe pastaj mësimi. Pasdite bëheshin 4 orë studim. E drejtonin vetë nxënësit. Gjatë studimit nuk lejohej të lexoje romane, por me pak kujdes, tolerohej. Edukatori (kujdestari) vigjëlonte herë pas here duke përshkuar korridoret. Një kalim nëpër korridor e thyente heshtjen dhe jepte sinjale paralajmëruese. Disiplina, gurçe. Thënia e pedagogut të njohur çek Komenski: “Shkolla pa disiplinë si mulli ri pa ujë” qendronte në korridor si e murosur. Natyrisht, disiplinë e fortë, por jo si në ato seminare të kishtarë.

Nuk kishin hyrë ende tre komponentët e shkollës së revolucionarizuar: mësim-punë prodhuese-edukim fizik e ushtarak, por formimi i personalitetit ishte i plotë. Kishte programe mjaftueshëm edhe për edukatën e punës, edhe për edukimin ushtarak.

Shkollë prej vërteti, tamam shkollë. Inercia që vinte nga tradita e shkollës kombëtare nuk mund të shpëla-hej shpejt dhe lehtë.

Edhe përgatitje ushtarake (MLKA – Mbrojtja Lokale Kundra Ajrore) bëhej, edhe grupe teatrore kishte në shkollë, rrethe letrare, muzike, sportive e çfarë të doje. Mundësi për përgatitje të gjithanshme. Shkollë e rrethuar nga tri anët me lulishte plot me lule shumëngjyrëshe që Agush Selishta, lulishtari i famshëm i Peshkopisë, u rrinte gjithë ditën mbi kokë me zorrën e ujit në dorë, me capën dhe gër-shanën për capitje e krasitje. Mbi të gjitha, i ruante me një vigjilencë “prej xhandari” nga shkeljet e “trafikut” apo ndonjë top lastiku. Kthimi përsëri i topit në lojë nuk kalonte krejt lehtë e pa ndonjë ndëshkim.

Oborri i pasëm i shkollës shërbente si kënd sportiv, pajisur me fushë volejbolli, basketbolli, madje dhe futbollit. Aty në një kënd kishte paralele hekuri dhe një hekur për ushtrime që ftonin të rinjtë të shpinin gjymtyrët e të kruanin kurrizin sa herë t’ua deshte qejfi. Madje edhe shkallë suedeze e ku ta di se çfarë tjetër. Të kacavireshe e të luaje gjithë ditën, natyrisht në orët e lira. Përfund oborrit kishte vend për të rreshtuar edhe një turrë e gjatë drush ahu për dimër.

Prapa shkollës nga e djathta e saj, në fund të lulisjtes shquante madhështore në mes të qytetit, Shtëpia e re e Kulturës dhe e Krijimtarisë Popul-lore “Haki Stërmilli” me një arkitekturë klasike (huazim sovjetik) që frymëzonte qytetari. Edhe aty kishte rrethe të teatrit, të muzikës, madje edhe për pjano. Tani e mendoj se këto mundësi nuk ishin as për fëmijë të nobilitetit në shtetet e zhvilluara perëndimore, veç atyre parelinjëve.

“RILINDJA IME”

Më 1 shtator fillonte shkolla, datë që nuk para lëvizte. Ishte ditë solemne dhe merrte pamje shen-jtërie. Në rreshtimin e shkollës sipas klasave, zura vend nga fundi. Isha i sapoardhur, i panjohur. Në fillim rreshtoheshin vajzat, pastaj djemtë, kryesisht qytetarët. Kishte edhe nga fshatrat e afërt: Doho-shisht, Pilafe, Pollozhan që zinin vend nga fundi i rreshtit. Për natyrë, i ndrojtur dhe i rezervuar, fillova të njihem nga pakë. Në Shupenzë ishim njëlloj, “homogjenë”, edhe pse të ramë nga Malësia, ndërsa këtu ishte pak më ndryshe. Qytetarët, më serbes e të çlirët, të veshur më mirë, më të emancipuar. Djemtë me pantallona të shkurtëra, jo fort burmoure, por kështu e ka qyteti, kultura. Katund e adet; jo, adet qyteti. Pas nja dy a tre javësh shkova me leje në shtëpi. Kujdestari i konviktit mund të jepte leje për të shtunën mbas dite deri të dielën në darkë. Nga fshatrat Kovashicë, Zogje e Shtushaj ishim një “koloni” e vogël, që na bashkonte rruga. Rrahman Leka dhe Ramazan Koleci të shkollës së mesme dhe dy a tre të tjerë të 7 vjeçares që na voliste ta bënim rrugën në këmbë. Duhet të ishim ndonja 25 km. Për makinat nuk mendonim, sepse edhe s’kishte, edhe s’kishim hesap. Kthimi i parë në shtëpi, si nusja n’pashi...përmallime dhe emocione që s’thuhen. Në kthim të djelën pasdite bashkoheshim rrugës një nga një, me nga një torbë të vogël herë me molla e herë me ftoj, herë me arra a gështenja të ziera. Dardha gjithfarëlloji kishte në Shtushaj dhe, dardha me famë, në Hotesh, por ne u kalonim anash dhe i shihnim nga larg me sytë e mendjes. Kurse për gështenja ishte Mazhica, sa edhe emrin ja vunë “Gështenjas” kur Mbreti Zog më 1938 urdhëroi shqiptarizimin e emrave të fshatrave dhe vendeve, por Evropa nuk i la shqiptarët të shqiptarizohen e të “zanë vend” në vend të vet. U futi një agresion fashist, si fillim dhe më pas e nëpërmjet tij një revolucion komunist.

Në shkollë u ambientova shpejt. Nga shkolla e Shupenzës vija me një bagazh të mirë për shumicën e lëndëve. Sidomos në aritmetikë, ku mësues Shefqeti (Uka) na kishte “mbathur” mirë. Kjo më dha dorë dhe besim në vetvete. Mësues Kiçoja (Kalami), që e kishim edhe mësues kujdestar, kur i shtroja në dërrasë të zezë ato shprehjet aritmetike me tre llojë kllapash (rumbullake, katrore dhe gjarpërushe), a ndonjë nga problemet, i entuziazmuar nga siguria ime thirrë gjithë entuziazëm: “fenomen”, “fenomen”. Nuk e dija kuptimin e asaj fjale, por duhet të ishte fjalë e “madhe”. Shpejt mora “nam” të mirë. Vetëm unë i dija pikat e dobëta, që vinin nga bekgraundi i trashëguar. Një rast, ndërsa po bëja ushtrimin, siguria ime me njëfarë karshillëku me dorën e majtë në xhep dhe shkumësin në të djathtën, duke imituar mësuesin e dikurshëm, e bëri nervoz mësuesin, prandaj m’u drejtua: “dorën nga xhepi!”. Nuk dëgjova mësues. “Dorën nga xhepi!” dhe i mëshoi zërit. Kurrë më nuk e bëra atë gjest prej kapadaui, sa edhe sot përpiqem t’i ruaj duart.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Vargjet e Naimit tregojnë se ai e ka bërë Shakespeare-in të shprehet shqip, të komunikojë me ne, të na ndihmojë të zbulojmë natyrën e ndjenjave që fshihen thellë brenda nesh dhe brenda çdo njeriu, në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendet

154 sonetet e Shekspirit në gjuhën e Naim Berishës

Nga Arjan A. BEJKO


Të shkruash mjafton të dish vetëm shkrim e këndim, ndërsa të përkthesh duhet të jesh i shumanshëm. Disa shkrues, pa qenë fare shkrimtarë, shkruajnë libra të mirëshitshëm, që rrëmbejnë vëmendjen e masës, duke luajtur me kuriozitetin, padurimin dhe dëshirën e saj për t'u dukur me kulturë. Përkthyesi nuk e ka aq të lehtë. Ai që përkthen duhet të jetë shkrimtar, poet, muzikant, historian, psikolog dhe mbi të gjitha, një udhërrëfyes i mirë në labirinthin e mistereve të letërsisë. Përkthyesi i aftë nuk kthen mekanikisht vetëm fjalët nga njëra gjuhë në tjetrën, por, njëkohësisht, ai transmeton ndjenjat, mesazhin, kontekstin historik, frymën e kohës kur zhvillohen ngjarjet, bashkë me melodinë e brendshme të prozës apo poezisë që ai i paraqet lexuesit. Kjo detyrë tejte e vështirë kthehet në një punë çfilitëse si mundimi i Sizifit, kur autorët që duhet të përkthehen quhen Shakespeare, Dante, Goethe (Gëte), Balzac apo Edgar Allan Poe. Të përkthesh me nivel kryevepra të letërsisë botërore është ndoshta po aq e vështirë, sikur të shkruaje vetë mrekulli të tilla. Nëse shkrimtari gjenial i ka në mendje dhe në zemër përjetimet që shkruan, përkthyesi duhet të futet me durim në mendjen dhe zemrën e autorit dhe jo vetëm kaq. Ai duhet të futet edhe në mendjen dhe zemrën e lexuesve të vendit të tij, të cilët kanë tjetër gjuhë, kulturë, psikologji, shije, mentalitet, traditë dhe mënyrë jetese nga autori i kryeveprës së përkthyer. E prapë kjo nuk është e gjitha. Përkthyesit i duhet shpesh të ndërmarrë me fantazi dhe imagjinatë edhe udhëtime kohore duke kapërcyer shekuj të tërë, e ndonjëherë edhe mijëvjeçarë.

Para disa muajsh mora si dhuratë «Sonetet e Shakespeare-it» të përkthyer nga miku im Naim Berisha, i cili më kërkoi, miqësisht, të jepja mendimin tim, për punën e tij të apasionuar, e cila i kishte kushtuar atij orë të panumërta në disa vite. Këtë punë kaq të vështirë e mora me gëzim përsipër, sepse Naimi nuk është thjesht vetëm një njohës i mirë i gjuhës angleze, por ai ka shkruar gjashtë romane dhe disa libra me poezi. Njëkohësisht ai është edhe një këngëtar i pëlqyeshëm si dhe një kantautor i njohur, pra nuk i mungon veshi muzikor, për të kapur melodinë e fshehur brenda vargut. Veç këtyre, ajo që më nxiti më tepër t'i përkushtoj një pjesë të çmuar të kohës time përkthimit në fjalë, ishte vlerësimi im për përkushtimin që Naimi i kishte falur këtij përkthimi, për të kënaqur lexuesit shqiptarë, për t'i ushqyer ata me një nga kryeveprat klasike, sepse sot kjo gjë është lënë në harresë dhe një armatë e pathyeshme fjalë-kthyesish, e nxitur vetëm nga fitimi, përkthen pa u lodhur dhe pa e vrarë shumë mendjen bestseller, pa asnjë vlerë letrare. Naimi e dinte mirë se me sonetet ai nuk fiton, por vetëm dhuron. Dhuron kohë, gjumë, energji, ndjenjë dhe para të tijat pa fituar asgjë materialisht, përveç mirënjohjes për brezat që vinë më pas. Për këtë arësye jam munduar të jem sa më realist në vlerësimin e punës së tij gjigante, gati-gati, vetëmohuese. Mendova se do ta kisha tepër të vështirë, por përkujdesja dhe dashuria që ka treguar Naimi për vargun, ma lehtësoi shumë punën. Vargjet e Naimit tregojnë se ai e ka bërë Shakespeare-in të shprehet shqip, të komunikojë me ne, të na ndihmojë të zbulojmë natyrën e ndjenjave që fshihen thellë brenda nesh dhe brenda çdo njeriu, në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendet. Më mirë se shkrimi im flasin disa nga vargjet e shqipëruara me aq dashuri dhe pasion nga Naimi. Që në sonetin e parë autori të befason me gjetjet e tij. Ja disa vargje, mbresat e të cilëve nuk të shqiten kollaj, por të pëshpërisin në vesh melodinë dhe përmbajtjen e tyre. Soneti 1: I kredhur je, në sytë dritë e jetë/ Flakën me shpirt, gjallë, ti fort e mban./ Ose më tej: Ti je stolia e mbarë ruzullimit/Grishës i parë i pranverës së pashoqe./

Në sonetin e dytë do të shijoni këto vargje: Kur dyzet dimra ballin të të ftohni/ Dhe bukurinë të të zvetënojnë. / Stolitë, e dashur, që, dikur të ngrohni./ Do të kthehen në zhele, që të trish-tojnë./

Po kapërcej pak në sonetin e pestë, megjithëse me keqardhje, sepse vargjet e përkthyer nga Naimi e meritojnë të gjitha vëmendjen e lexuesit. Soneti 5: Me punë të fisme kohët bukur ngriten/ Të gjitha mrekullitë ku sytë tanë pushojnë./ Soneti 9: Bota do të jetë e veja jote/ Pa një djalë tëndin e lë në vaj/ Kur çdo e ve tjetër do të shohë gëzimplotë/ Sytë e të shoqit te fëmijët e saj./

Për të krijuar kryevepra duhet të falësh diçka



nga brendësia jote, duhet të shuhet diçka brenda shpirtit tënd - thotë gjeniu Edgar Allan Poe. Për mendimin tim, Naim Berisha na ka dhuruar mjaft shkëndija të çmuara të shpirtit të tij krijues, për të na ngrohur sadopak me zjarrin e ndjenjave shekspiriane.

Ja se ç'kam zgjedhur deri tek 30 sonetet e para:

Soneti 10: Pash sytë e tu, krijoi fytyrën tënde/ Që bukuritë në ty, t'i kundrojmë me ëndje./ Soneti 12: Kur shoh ndonjë vjollcë, që vyshket, ul kokën/ Dhe në argjend e kthen floknajën e zezë./ Soneti 13: Kështu bukuria që ti mishëron/ Do të përsëritet, as do kish limit/ Me djalën e dashur, që ty të pason/ Kështu, djalë pas djali, gjer në infinit. Soneti 15: Krenarë në rini, pastaj, befas, zhduken/ Nga maja me borë, shemben në greminë./ Për ty, unë përlëshem me shiun dhe erën/ Për ty, sfida dimrin dhe të sjell pranverën. Soneti 16: Vetëm bukuritë, të shpëtojnë jetën/ Dhe arti kur mbarset me të vërtetën. Soneti 17: Bukurinë tënde në vjershat e reja/ Sikur t'i qëndisja gjithë hiret e tua/ Dritën e qashtë të dyve tu të shprehja/ Gjepuraldo të thoshin. Poet i hutuar! Soneti 18: Dhe pse krenare, vdekja kurrënjëherë/ S'ka ç'të bën, n'artin tim mbetesh monument/. Soneti 20: Natyra të bëri veç si femër flirti/ Unë pranoj miqësi, por jo ç'të do shpirti/. Soneti 21: Dhe zë e qëndis pa vend krahasime/ Me lulet më të bukura, me diell dhe hënë/ Me gurë të çmuar, me të rrallët suvenire/ Dhe me të tjera gjëra, që, ende, s'janë thënë/. Soneti 22: Se gjithë bukuritë që shkëlqejnë në ty/ Janë të zemrës sime, si petkat e holla/ Që të rrinë në shtat, me sa bukur/ Si ti në zemrën time, lulja që vetë mbolla/. Soneti 23: Fjalën e heshtur të dashurisë, lexo/ Porsi bukuria dhe ti me sy dëgjo/. Soneti 24: Në hulli të zemrës, lule e selitur/ Ka për xham dritaresh sytë e tu të bukur/ E sheh, për njëri-tjetrin sytë sa na vlejnë?/ Imi të pikturoi, yti u bë dritare/. Soneti 25: Heronjtë e betejës, trimat luftëtarë/ Nga libri i nderit si retë mund të treten/ Pas një mijë fitoresh veç një herë po ranë/ Fshihen krejt çfarë dhanë për botën, për veten/. Soneti 26: Pres një çast, kur ylli që më prin/ Me sy më të ëmbël, të më shoh një ditë/. Soneti 27: Ah, shpirti im, me sytë e imagjinatës/ Hijen tënde sjell në terr të syve të mi/ Që si një brilant në errësirën e natës/ Natën fut të zezë e bën të vetëtijë/. Soneti 29: Lakmoja unë, vërtet, një tjetër fat/ Të akecilit pamje sikur ta kisha unë/ Miqtë e dikujt dhe talentin në art/ Patjetër do t'më bënin të lumtur shumë/ Po aty vjen edhe mbyllja si përgjigje e qartë/ Aq i lumtur ndihem me kujtimin tend/ Sa dhe mbret të jem, nuk më shkon ndër mend/. Soneti 30: Më mallëngjejnë kujtimet e kohës së ikur/ Lotin me lot, vrerin me vrer e vras.

Vargjet e zgjedhura nga sonetet 31 deri te soneti 60:

Soneti 32: Uroj të vdesësh shumë kohë pas meje/ Kur vetëm eshtrat të më kenë mbetur/ Të shohësh këtë shkrim si vija rrëkeje/ Që shkroi dikur, i dashuri yt i tretur/. Soneti 33: E kam shijuar në jetë hijeshinë/ Kur dielli i agut, malet i pushton/

Dhe mbështet kryet e artë në luginë/ Dhe lumin e qetë e praron/. Soneti 37: Ç'magjeps në botë, e shoh tek ti/ Dhjetëfish më shumë ndjej lumturi/. Soneti 38: Edhe gojëlidhuri, flet bukur për ty/ Se gjuhën ia zgjidh, me dritë dhe me ëndje/ N'm'i pëlqefshin shekujt, ah, këta sonete/ Unë do të mbart dhimbjen, ti lavdinë për vete/. Soneti 39: Veç dashurisht bie në mendime/ Si ta sjell unë pranë, atë që është larg/. Soneti 40: Po ta fal vjedhjen, kusar, sharlatan/ Dhe pse më vodhe i shtyrë nga frika/ Mes fukarallëkut, vodhe fukaranë/ Tallja e dashurisë, m'e keqe se thika/. Soneti 41: Dhe kur flirton një femër buzagaz/ Vallë cili mashkull s'do t'i thurë kurorë/. Soneti 43: Dita më bëhet natë, kur ti më sheh në sy/ (nje gjetje fantastike, pra, kur më sheh ti, më errën sytë) Nata më bëhet ditë, kur n'ëndërr të shoh ty/. Soneti 44: Pikëllim nuk kam pse ti larg je tret/ Kudoqofsh, mendimi ka gjasë të të gjejë/ Ai tejshpon porsi një shigjetë/ Dhe di çfarë bën, dhe di ku të vejë/. Soneti 46: Zemra dhe sytë e mi, fort po përpichen/ Si portretin tënd të bukur ta ndajnë/ Sytë zemrës kot ia mohojnë soditjen/ Këtë gjë zemra e di krejt të sajnë/. Zemra këmbëngul se është shtëpia jote/ Porsi një kështjellë, që kurrë s'e shpoinë sytë/ Por sytë këtë gjë, poshtë e flakin prorrë/ Thonë se brenda tyre rron ndriçimi yt/. Soneti 47: Kur për një kundrim, sytë ndjenë mungesë/ Psherëtiu zemra me lotët e syve/ Pastaj, rëndom, zemra sytë m'i thërret/ Kur ndonjë ëndërrim e ka mrekulluar/. Ata, nëse flenë, portreti yt ia mbërrin/ Syve dhe zemrës t'u falë lumturinë. Soneti 49: Në pendimin tim të fortifikuar/ Asaj kohe unë i kundërqëndro/ Kundër vetes ngrihem i disafishuar/ Vuaj të drejtën tënde, që kurrë s'e mohoj. Soneti 50: Më tërheq vëmendjen me fjalët: shih pas!/ Sa rrugë ke bërë, nga shpirti aq të ndanë. Soneti 51: Për dëshirën time s'do të ketë Pegas/ Pegas të rilindur prej dashurisë së dliër. Soneti 52: Ndoshta për këtë dhe festat kanë hije/ Ngaqë ndodhin rrallë, hijeshojnë vitin/ Si gurët e çmuar n' gjerdanë nusërie/ Imazhin tënd, kurrë, s'e prishin dot. Soneti 56: Le të jetë ky rast vetëm një moment/ Porsi deti që ndan dy brigje/ Kur sy të dashuruar, në secilin breg/ Presin që në det të duket një anije. Soneti 57: Nuk di të ankohem për orët e gjata/ Teksa të pres me kurm e shpirt të ngrirë/ S'dua ta kujtoj vdekjen që pata/ Ditën që më the: "Ika, lamtumirë!/. Soneti 59: Si në libra të lashtë të të shoh portretin/ Që ty ta fiksuam poetët madhështorë/. Të shoh dhe njëherë ç'thotë bota e vjetër/ Për madhësinë tënde që po prin në botë/ Oh, them se poetët e gjithë kohës së lashtë/ Më pak gjëra të bukura kanë dhënë me art.

Perzgjedhjet e mia nga soneti 61 deri te soneti 90:

Soneti 62: Në gjithë qënien time ka lënë shënjë/ Një mëkat i quajtur "vetëpëlqimi"/ Aq shumë thellë ai ka hedhur rrënjë/ Sa është i pamundur, tashmë, shërimi/. Veç teje në zemër, jo nuk mbaj askënd/ Gjallëroj pleqërinë me buzagazin tend. Soneti 63: Kur të të shoh vesën e dritës rinore/ Duke rënë nën hijen e mbërmysjes murgeshë. Soneti 64: Kur shoh gërmadhat si gropa rufeje/ Them, Koha do ta fshijë edhe yllin tim/ Mendim si një mort, që s'guxon tas ngasësh/ Më vjen të qaj, sa frikë të humbasësh. Soneti 65: I tmerrshmi mendim: Kush mund t'ua ndalë/ Kthetrave shfarosëse të Kohës, stolitë...!/. Kush do të bëjë të pamundurën, vallë?!/ Kush s'do t'i lerë të vyshken bukuritë?!/ Askush, por nëse ndodh, vërtet, një gjë e tillë/ Në qiellin e zi ti do të jesh një yll...! Soneti 66: Të shoh dituritë gojëmbyllur nga mbreti/ Fëmijën e padenjë t'i shes menditë të atit/ Të shoh të drejtin të vritet nga i veti/ Dhe jetën e zezë, këtë robinjë të fatit. Soneti 68: Ajo përfaqëson veç një kohë të shenjtë/ Kur s'kish zbukurime, veçse natyrore/ Kur vera nuk bëhej për të shitur mendtë/ As nuk visheshin varret për stolitë, prorrë. Soneti 69: Lulja e bukur pa një erë të mire/ Nuk zgjon interes në kohë dhe hapësirë. Soneti 70: Lulen më të bukur lakmon dhe krimbi/ Kur ti një kopsht me lule, befas, i ofron. Soneti 72: Oh, nëse të thotë bota ngastare/ Ç'vlerë kisha unë që ti më deshe/ Edhe pa vdekjes, harromë, moj shpirt, fare/ Thuaj që s'më pe as të mirë, as të keqe/ Veçse për mua mos trillo asgjë/ Mos më ngjit më lart se ç'u ngjita vetë. Soneti 73: Në mua është stina

ku ca fletë vajtojnë/ Të verdhët qajnë rininë dhe blerimin/ Në degët që lëkund era, mezi rekojnë/ Altarë të rrënuar, ku zogjtë cicërinin. Soneti 74: Kurmi le të më shkojë në dheun ku kam lindur/ Shpirtin ta le ty, o mikja ime e shtrenjtë/ Në shpirtin që të lë, aty është dhe vlera/ Që do të rrojë me ty, pasysim, ngahera. Soneti 75: I lumtur ndihem kur më merr trishtimi/ Njësoj si kopraci me paratë në xhep. Kur jam me ty, ndihem vërtet, mire/ Dua të gjithë globin të bëjë dëshmtarin. Soneti 76: Dhe uni im. si diell që mplaket përditë/ Tregon çfarë është thënë, t'vjetrën përsërit. Soneti 77: Pasqyrë të mendjes ke të bardhat fletë/ Kridhu në këtë libër që të drithërohesh. Soneti 78: Me muzën time ji krenare, pra/ Se në ty u lind, në ty ajo merr flake. Në mua je, e gjitha, arti im, je diell/ Nga padija ime dije, më ngrite në qiell. Soneti 79: Veç vjersha ime kish bukurinë tënde/ Se vetëm unë, herët, ta njoha bukurinë/ Tash që e humba këtë zë thëllënze/ E ngrysur Muza ime po lyp tjetër stinë. Soneti 80: Kur shkruaj për ty ndjej drithërimë/ Mendoj dikë tjetër duke të qëndisur/ Ai, natyrisht, po ndjek udhën time/ Me hiret e tua vjershën ka stolisur. Hapësirën tënde, unë mund ta bëj zap/ Në më dhënc pak ndihmë, o hënë e bukurisë/ Ani, barka ime dhe pse sa një arkë/ Anijen e tjetrit dhe mund ta përmbysë. (Aliteracioni shumë i bukur në dy vargjet e fundit. Edhe mbyllja e sonetit më pëlqen shumë. A.A. Bejko). Në ngadhënjefsha unë, më përket lavdia/ Përndryshe i mbytur jam nga dashuria. Soneti 81: Janë monumente vargjet e mia/ Për sytë e nesërm, brezat që vijnë/ Në të gjitha gjuhët që ka njerëzia/ Veç emri yt do të ketë shkëlqim. Soneti 82: Në vargjet e tyre mjaft ngjyra kanë vënë/ Por faqet e tua pa gjak i kanë lënë. Soneti 84: Poeti që guxon dhe nis për ty e shkruan/ Njëse të pasqyroj, ka vërtet meritë. Soneti 86: Drejt teje dhe çmimit tënd të lartë/ Anija krenare e vargut të tij/ Ç'ma veniti frymëzimin tim të artë/ Dhe molin që e rriti me aq dashuri. Soneti 88: Për hiret e tua do nxjerr në pasqyrë/ Dhe ndonjë të fshehtë që më bën të prapë. Soneti 89: Për hatrin tënd dhe veten do ndëshkoj/ Atë që ti urren, s'mund ta dashuroj.

Perzgjedhjet e mia nga sonetet: 91-120:

Soneti 91: Para teje s'më hy në sy as fisi i pare/ Më shumë se pasuria ti më bën të pasur/ S'më duhet moda, langonj e zagarë/ Në ty gjej çfarë do një zemër e plasur. Soneti 93: Kur qielli të bëri, e kish dhënë vendimin/ Në sytë e tu shtëpinë të ketë mirësia. Ti mollës së Evës aq shumë do t'i ngjaje/ Në shpirt të mos ishe njësoj si në pamje. Soneti 96: Me sa adhures do zhgënjehesh ngaherë/ Njëse gjithë favorët do t'i vije në jetë/ Njëse s'je e tillë, më shumë të ka hije/ Ty dhe emrin tënd, ju kam si dy yje. Soneti 98: Dimër s'ish, po dimër dukej në çdo vend/ Unë mikloja lulet, sikur imazhin tend. Soneti 100: Vështro Muzë e ngrysur, si kohë e pabesë/ Asaj që dua, ballin ia ka zbehur/ Në pastë ndonjë rrudhë, hiqja me kujdes/ Që koha për të, të mos kalojë e heshtur. Soneti 103: Mos më shaj nëse nuk shkruaj më tepër/ Pa shihu në pasqyrë dhe do marrësh vesh/ S'e përballoj dot këtë kryevepër/ Ndaj ndihem këqullur me vargjet zhveshë. Soneti 105: Besë, pamje e mirësi këtu mbetëm/ Ky trinitet vargjet m'i skalit/ Ah, ç'mrekulli, vallë, si nuk çmen-dem/ Prej kësaj magjie që mua më mahnit. Soneti 106: Hiret e tua janë, thjesht, profeci/ E bukurive që ata kanë ëndërruar/ Dhe pse s' të panë, të thurën poezi/ Por s'munden si duhet me të hyjnizuar. Soneti 109: Në k'të botë gjithë gjërat më duken të kota/ Për mua, moj zemër, veç ti je bota. Soneti 110: N' atë qiell të ndritshëm, uromë: mirë se vjen! N' gjoksin tënd ku dashuria si diell shkëlqen. Soneti 112: Se nuk pyes aspak si bota më quajnë/ N'se ti më vlerëson kur të dal si mbrojtës/ Ti në zemrën time aq shumë je selitur/ Sa bota pa ty, do të ish venitur. Soneti 113: Gjithçfarë syri sheh: të vlefshme, të pavlefshme/ Gjëra të shëmtuara ose dhe të pashme/ Mal apo det, ditë e net t' skëtrishme/ Korb a pëllumb, krejt i bën të ngjashme. Veç mallit për ty, s'kam gjë në kujtesë/ Unë, shpirti besnik, syri i pabesë. Soneti 115: Vargjet që gënjëjnë ndër vargjet e mia/ Janë ato që thonë "më shumë s'mundem të të dua"/ Se s'kish ku të shtrihej, më thoshte arsyeja/ Afshi i dashurisë brenda në mua. Soneti 117: Se miqësi lidha me gjithëfarëloj njeriu/ I fala gjithkujt të drejtën tënde të plotë/ Se i hapa velat çdo ere që fryu/ Dhe ika aq larg soditjes tënde të ngrohtë. Soneti 119: Ç'kupa me lot sirenash unë ktheva/ Nga llumi më i zi se ferri kulluar/ Ç'shpresa dëshpërimi në shpirt këmbëva/ Sa herë humbisja fitoren e ëndërruar. Soneti 120: Unë t'i kam falur, e dashur, të këqijat/ Në më paç pak hatër, falmi dhe ti të miat.

(Vijon në faqen 18)

Leo, ka një dashuri të madhe për muzikën “Pop”

Leo me krijimtarinë e tij, ka për qëllim qasjen dhe dashurinë që ai ka për vendlindjen e prindërve. Duke u rritur me kulturën, historinë dhe vlerat shqiptare në familje, ku flitet shqip, ai këtë verë vendosi t’ia dedikojë Shqipërisë me këngën më të re “What i Like”. Edhe pse pjesa më e madhe nuk e njeh, apo nuk e ka dëgjuar, ai në këto vite ka punuar me pasion e përkushtim për të garantuar emrin e tij si një artist i pëlqyer, ku njerëzit e duan muzikën dhe zërin e tij.

Nga Halil TEODORI

Kur flitet për muzikën ndërkombëtare, atë muzikën që pushton skenat më të mëdha botërore, që rrëmben dashurinë e miliona dashamirësve në gjithë Globin, menjëherë mendja të shkon tek shqiptarët e famshëm të skenave prestigjioze, tek ata që dëshmuar botërisht prejardhjen e tyre dhe provuan se ishim, jemi dhe do të mbetemi një kombe me vlera, tradita dhe kapacitete konkurruese. Lista e atyre zërave, atyre emrave, atyre kapaciteteve promovuese të talentit dhe përkushtimit, sfidës dhe suksesit, është e gjatë e ndër ta mund të renditim; Rita Ora, Dua Lipa, Bebe Rexha, Albert Stanaj, Era Istrefi, Enisa Nikaj, Seven Saraçi, Leo Krkuti, etj., etj., të cilët na prezantojnë denjësisht me artin dhe performancën e tyre. Sepse ata janë një energji e pashtershme e forcave përtëritëse dhe aftësisë për të pjesëmarrë denjësisht në sprova dinjitoze suksesi.

E ndërsa ne përcjellim me shumë dashuri dhe pasion secilin prej tyre në rrugën e famës dhe suksesit, vërejmë së kësaj gjësie i është shtuar edhe një tjetër shpërthim i fuqishëm talenti dhe pritshmërisë sfiduese. Është fjala për shqiptaro-amerikanin Leo Krkuti, 22-vjeçarin e lindur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me origjinë shqiptare. Prej kohësh ai ka spikatur për talentin e tij në muzikën “Pop” si këngëtar dhe si tekst-shkrues. Vitet e fundit ka bashkëpunuar me studiot muzikore më në zë në Nju-Jork, si një tjetër shqiptar që ka arritur të jetë në Billboard-et e magjishëm të Times Square-it. Si një tjetër shqiptar i suksesshëm që nëpërmjet videoklipit të realizuar më të fundit në Kosovë me Kompaninë muzikore “Enter-media”, lider në fushën e muzikës në Shqipëri, ka mundur të ngjitet në podin e famës. Leo me krijimtarinë e tij, ka për qëllim qasjen dhe dashurinë që ai ka për vendlindjen e prindërve. Duke u rritur me kulturën, historinë dhe vlerat shqiptare në familje, ku flitet shqip, ai këtë verë vendosi t’ia dedikojë Shqipërisë me këngën më të re “What i Like”. Edhe pse pjesa më e madhe nuk e njeh, apo nuk e ka dëgjuar, ai në këto vite ka punuar me pasion e përkushtim për të garantuar emrin e tij si një artist i pëlqyer, ku njerëzit e duan muzikën dhe zërin e tij.

Përveç se një artist me perspektivë, ai është dhe një i ri i edukuar, i cili ka mbaruar studimet për financë dhe marketing në një ndër universitetet e njohura të Nju-Jorkut, “Pace University”. Një pjesë të mirë të kohës ai ia dedikon bizneseve familjare. Leo është modeli i një të riu që di të jetë i përgjegjshëm, po aq edhe ekspresiv, kur bëhet fjala për të realizuar ëndrrat e tij. Ai ka trashëguar bujarinë dhe zemërgjerësinë e shqiptarit të mirë. Sepse është kjo frymë me të cilën ai është ushqyer.

Leo, ka një dashuri të madhe për muzikën “Pop” dhe që në moshë të vogël ka kuptuar që rruga e tij është vetëm arti dhe muzika.

Ai ka publikuar një album, dy debutime, disa single-a, muzika e të cilave është pëlqyer jashtëzakonisht shumë duke kaluar mbi 100,000 pëlqime në platformat e mëdha si I-tunes dhe Spotify, etj. nëpërmjet talentit të tij dhe fansave që duan aq shumë muzikën që ai bën.



Leo Krkuti

një tjetër shqiptar i madh në muzikën “Pop”

INTERVISTA

Si dhe kur nisi pasioni juaj për muzikën?

E mbaj mend si tani, isha vetëm 10 vjeç kur kuptova sa shumë e dua muzikën, dhe në moshën 12-vjeçare nisa të krijoja çdo gjë vet, të regjistroja, miksoja, të shkruaja tekste dhe deri tek editimi. Muzika është pjesë e rëndësishme e jetës sime dhe dëshiroj ta vazhdoj dhe në të ardhmen.

Këtë pasion për muzikën, e keni të trashëguar nga familja apo mbetet një ëndërr vetëm e juaja?

Do thosha është një trashëgimi, pasi dhe babai im, asokohe ka qenë i njohur për pasionin që ka pasur gjithmonë për muzikën, dhe botën e artit në përgjithësi. Ai ende sot vazhdon të ruaj dashurinë për muzikën shqiptare, gjë e cila më ka ndihmuar dhe mua të njoh vlerat e muzikës shqipe.

Kur ka dalë në treg albumi juaj i parë?

Në moshën 17 vjeç, ka qenë debutimi im i parë komercial në platformën e medias online të titulluar “MCM”, ndërsa në moshën 19-vjeçare arrita të përfundoj projektin me titull “Just Leo”.

Ky ishte projekti për të cilin kisha punuar kaq fort, por fatmirësisht doli me sukses, u pëlqye nga të gjithë dhe isha shumë i lumtur të shihja veten në zemër të “Times Square”, mes mijëra reklamave e artistëve të tjerë të huaj. Të dy projektet që përmenda mund të gjenden në platformat e mëdha si I-Tunes, Spotify, etj.

Si e kujton ‘singel-in e parë “Ven Aq”?

Si mund ta harroj këtë këngë e cila doli para dy viteve, dhe korri sukses më shpejt sesa prisja duke kaluar mbi 100,000 pëlqime.

Ashtu sikurse mbeten po kaq të rëndësishme edhe debutimet e tjera si “No Talking” “Run Wild” “Chained”, “NY to LA”.

Çfarë synon të arrish? Cila është ëndrra juaj?

Të arrij aty ku i takon një artisti të vërtetë, sepse një që e do artin dhe punon fort për të, pa diskutim do i shpërblehet dhe unë dua që me talentin tim të bëj krenar gjithashtu dhe të gjithë njerëzit që besuan në ëndrrën dhe pasionin tim për muzikën, në veçanti familjen time.

Cili është projekti më i afërt?

Kam shumë projekte në vijim, më i afërti do jetë këtë verë, një bashkëpunim me një ndër kompanitë më të njohura të muzikës në Kosovë, siç është “Entet- media” ku jam tepër i lumtur për bashkëpunimin e këngës më të fundit “What i Want”

Ju keni lindur në Amerikë, por flisni shqip?

Flas pak por jo rrjedhshëm. Po e mendoj seriozisht të hy në një kurs të mësoj një shqipe të pastër pasi do dëshiroja shumë një ditë jo shumë të largët të këndoja dhe në shqip.

Si të dukët Shqipëria, të pëlqen ta vizitosh?

Sigurisht që e vizitoj shpesh, e me shumë dashuri kthehem në origjinën time, në vendlindjen e prindërve siç është Dibra, një vend aq i bukur e me njerëz të mrekullueshëm, por dhe Kosova është një vend i mrekullueshëm me njerëz fantastik.

Përveç muzikës, si e kaloni pjesën tjetër të kohës?

Jam gjithmonë i zënë, pothuajse shumë pak kohë të lirë ka në përditshmërinë time, pasi unë menaxhoj dhe bizneset e familjes, së bashku me vëllain tjetër Benin, e pjesën tjetër të ditës deri në orët e vona të natës e kaloj në studion time duke krijuar muzikë apo tekste.

154 sonetet e Shekspirin në gjuhën e Naim Berishës

(Vijon nga faqja 17)

Përzgjedhjet e mia ndermjet soneteve: 121 deri te 154.

Soneti 121: Nuk e do rregullin i ligu mbi tokë/ I quan të gjithë të ligj se do që t’bëjë shokë. Soneti 122: N’së mbaj me vete bllok, që të të kujtoj/ Ndoshta, ka të ngjarë se mund të t’ harroj. Soneti 123: Gjithçka do të bëj, moj kohë zemërgur/ Për inatin tënd unë besën s’e shkel kurrë. Soneti 124: Jo, ishe lindur larg leqeve të shortit/ Dhe luksit krekosës, imazhit të qeshur/ Jo s’ka nevojë të vesh para të fortit/ Maskën servile që të gjithë kanë veshur. Dëshmoj për satrapët, që njerëzit shfrytëzojnë/ Bëjnë aq mirë kur vdesin, se bëjnë keq kur rrojnë. Soneti 125: N’ themele të përjetshme pse të rrëmi/ Për një drithërimë, që më shkakton ëndje/. Soneti 128: Sa i kam për zemër preklat që lodrojnë/ Pëllëmbën të puthin, paj buzët e mia/ Që digjen prej pasionit, faksin e vështrojnë/ Lumturinë e drurit, djegur nga zilia. Soneti 129: Mbytja e shpirtit në b’rrakë paturpësie/ Afshi në veprim, kur s’mbërrin në akt. Soneti 130: Dua t’i ndiej fjalët edhe pse e di/ Muzika më fort s’më deh dhe s’kam nge/ Ende s’kam parë duke ecur një hyjni/ Po kur ec e dashura, s’ di në shkel mbi dhe. Soneti 132: Unë sytë e tua i dua aq shumë/ Ngaqë e dinë moj, se ti më përçmon/ U ngjyen në të zi se u dhimsem unë/ Me ëmbëlsinë-zehër teksa më kundrojnë/ Gjithë qënien tënde, dhimbja ta kish ndritur/ Sikur ti të qaje gjithë brengat e mia. Soneti 135: Detin fryjnë lumejtë kur bien shira/ Breg më breg e rrit mbretërimin e bukur/ Sikundër dhe ti e pasur në dëshira/ Prano dhe timen, bëmë dhe mua t’ lumtur! Soneti 136: Më quaj «asgjë», ani, mos më duaj/ Në një «askush» si unë, do gesh lumturinë. Soneti 137: S’gjykan drejt as zemra dhe as sytë e mi/ U krodhën në një llum gënjeshtash pa kufi. Soneti 138: Kinse shpresoj se, njëmend, i dukem djalë/ Edhe pse ndodhem bash në muzg të jetës/ Shtirem naiv dhe ia përpij çdo fjalë/ Në fund, hoqëm dorë të dy prej së vërtetës/ Kështu, njeri- tjetrin ne gënjejmë gjithmonë/ Duke u ndjerë mirë me dyfytërsinë tone. Soneti 139: Mjaftohu me gjuhë, me sy mos më plagos/ Mund dhe të më vrasësh, veçse pa dredhi/ Se do një tjetër, thuaje para syrit tim/ Dhe tjetrit, o shpirt, mos ia bëj me sy/ Jo, nuk është mirë të mbytem në mashtrim/ Kur unë para teje dridhem si këthi/ Dhe falma mua zjarrin tënd, furishëm/ Ndryshe, mos më lër as vdekur, as gjallë/ Vritem ose digjem, t’ shpëtoj sa më parë. Soneti 140: Në do të mos çmëndem dhe ti të mos vuash/ Veç sytë falmi mua, zemrën kujt të duash. Soneti 141: Jo sytë e mi, qebesa, ata s’të duan/ Ngaqë ty të shquajnë një mijë të këqija/ Po zemra që s’i vë re mangësitë e tua/ Se është e çmendur nga dashuria. As pesë shqisat, as mendja e hutuar/ Kësaj zemre të ngratë, ç’t’i bëjnë nuk dine/ Më kot mundohen për ta shëruar/ Që kjo ta zhdukë, ndërkaq, robërinë. Soneti 142: N’së nuk i jep tjetrit atë që lyp dhe vetë/ Asgjë s’do të marrësh nga dyert që troket. Soneti 145: “Urrej”- ajo kishte thënë pa shpoti/ Dashuroj fort jetën time dhe “Jo ty”. Soneti 147: Të dija të bukur si diellin, për besë/ Por qenke natë ferri, qenke korbë e zezë! Soneti 148: Mjerë unë, për sytë që më vuri në ballë Dashuria/ Sy që s’më thonë çfarë sodisin/ S’mund të shohin mirë sytë që dashurojnë/ I zbeh pagjumësia dhe kripa që l’shon loti. Soneti 150: Cila fuqi ta jep këtë pushtet të forte/ Që zemrën skllave ma mban nën dobësitë/ Të mohoj çfarë shoh dhe be të bëj më kot/ E dielli jo, s’e bëka natën ditë? Sonet 151: Kur të quaj «shpirt», nuk është se shtihem/ Për hiret e tua, herë bie, herë ngrihem. Soneti 152: Që të falja dritë, verbova sytë e mi/ I bëra të thonë: ç’nuk shihnin në fakt. Soneti 153: Prej zjarrit të shenjtë të dashurisë, burimi/ U nxeh, u bë zjarrmi e pashterueshme/ U shndërrua në llixhë, ku, gjer më sot, njerëzimi/ Shërohet nga sëmundje të pakuptueshme/ S’m’u gjet kurrë, as llixhë, as llaz, as varr/ Veç sytë e saj që i dhanë Kupidit zjarr. Soneti 154: Më e bu-kura nimfë, pishën ngriti lart/ Pishën që legjione zemrash kish bërë shkumb/ Kështu, gjenaralin e dëshirës më të zjarrtë/ Një nimfë virgjëreshë, e zhveshi në gjumë.

Duke lexuar këtë libër, të përkthyer aq bukur, ti njihesh me kryevepren e lavdisë më të madhe letrare të të gjitha kohërave, William Shekspir! Po-etin dhe shqipëruen artistik të kësaj kryevepre, Naim Berishën, e uroj për vepra dhe shqipërimi të tjera dinjitoze!

Arjan A. BEJKO, shkrimtar, përkthyes

KALENDAR HISTORIK

shek. V p.e.s. - qershor 2009

VITI NGJARJET

(vijon nga numri i kaluar)

1892- U ndërtua në fshatin Kërçisht Kisha e Shën Mitrit, kulturë anon nga kultura bizantine. Është shpallur Monument kulture në vitin 1970.

1893, tetor - Lindi në Zogje Aqif Lleshi. Pati disa funksione si: Komandant i Çetës Territoriale të Fushë Shehrit; komandant i policisë në qytetin e Dibrës së Madhe, 9 shtator-16 nëntor 1943; deputet në kuvendin e Maqedonisë dhe në Federatën Jugosllave në tetor 1945; Kryetar i Këshillit Popullor të Komitetit ekzekutiv të Ohrit, gusht 1945. Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të qytetit të Dibrës së Madhe me rrethinë, nëntor 1945-shtator 1950. Arratiset nga Jugosllavia më 4 shtator 1950. Vdiq në Tiranë, më 8 nëntor 1983.

1893 -Lindi në qytetin e Dibrës Ferit Jegeni. Mësimet e para i mori në vendlindje dhe Manastir, të mesmen në gjimnazin turk të Selanikut. Nga viti 1913-1920 punon si sekretar krahine në Maqellarë. Në vitin 1921 emërohet mësues në Patin të Matit. Nga viti 1922-1925 është krahinar në Gollobordë, ku arriti të hapte 7 shkolla shqipe në fshatrat: Trebisht, Ostren i Vogël, Klenjë, Borovë, Steblevë, Lejcan, Llademericë. Në vitin 1923 emërohet drejtor i internatit “Dibra” të Peshkopisë. Nga viti 1925 – 1930 është përsëri drejtor i Internatit “Dibra” të Peshkopisë. Në vitin 1930-1936 e gjejmë në seksionin e bursave në Ministrinë e Arsimet. Në vitin 1937 del në pension si invalid. Vdiq në Tiranë, më 11 nëntor 1963.

1894- Lindi në qytetin e Dibrës Hafiz Sherif Langu. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmen në Manastir dhe të lartën për teologji në Stamboll. Mori pjesë në Kuvendin e Madh të Dibrës, shkurt 1899, Kongresin e Dibrës, 23-29 korrik 1909, Kuvendin e Vlorës 1912. Ka qenë kryetar i klubit “Bashkimi Dibran”, 1908. Kryetar i ulemave në Shkup 1938-1941, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar 1941-1947. Ka qenë një nga inspiruesit më të përkushtuar të arsimimit të dibranëve në gjuhën shqipe. Mori pjesë me armë në dorë kundër turqve osmanë dhe shovinistëve serbë. Serbët e arrestuan në vitin 1936 me akuzën si organizator i “Kryengritjes së Dibrës”. Në vitin 1947 regjimi komunist i Tiranës e arrestoi me akuzën “agjitacion e propagandë” dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, por bëri vetëm tre vjet. Vdiq në Tiranë në vitin 1877.

1894 - Shaqir Daci i qytetit të Dibrës i mbështetur nga Mersim Dema hapi një shkollë shqipe në Homesh.

1895, 5 maj - Lindi në Maqellarë Fiqiri Dine. Mori arsim ushtarak në Austri. Në 1924 arratiset me Ahmet Zogun në Jugosllavi. Më 28 nëntor 1938 i jepet grada kolonel. Më 23 janar 1943 emërohet MPB në qeverinë e Eqrem Libohovës. Nga 17-29 korrik 1944 mban postin e kryeministrit. Më 1 shtator 1946 arratiset në Greqi. Vdiq në Belgjikë më 26 nëntor 1960.

1895, 7 maj - Lindi në Oranik (Shehër) të Dibrës shkrimtari demokrat Haki Stërmilli. Vdiq në Tiranë, më 17 janar 1953. Shkroi në disa gjini si dramet: “Dibranja e mjerueme” dhe “Dashni e besniki” në 1923, “Agimi i lumnueshëm” 1924, “Irena e bukur”, 1929, “Tania”, 1930, “Kosovarja” (tragjedi), 1931, “Suta” (dorëshkrim), “Trashgimtarët tanë”, 1950, “Luftëtarët tanë (dorëshkrim), 1952, “Sikurtë isha djalë” (roman) 1936, “Burgu” (letraro-dokumentar), 1936, “Shtigjet e lirisë” (ditar), botuar 1968, “Kalorësi i Skënderbeut”, botuar 1968, “Afsh dhe hov zemrash” (dorëshkrim) dhe studimin “Dibra në prag të historisë”, dorëshkrim, 1940.

1899, 27 shkurt - Themelohet “Besëlidhja e Dibrës”. Mbahet Kuvendi i Parë i Qernanicës.

1909, 24 korrik - Mbahet Kuvendi i Dytë i Qernanicës, i njohur në dokumentet e kohës si Kongresi i Dibrës.

1910, 10 maj - Hapet shkolla e parë shqipe në Zerqan me mësues Mustafa Sulën.

1910, 18 maj - Lindi në qytetin e Peshkopisë Munir Shehu. Kompozoi këngët: “Bulqizakja”, “Shkon djali termale”, këngën “Jashar Kola”, “Liqeni i Ulzës”, etj. Pas vdekjes iu botuan studimet, “Gjeneologjia e fisit Shehu”, Tiranë, 1999; “Dibra në vitet 1840-1860”, vëllimi i parë. Vdiq më 31 mars 1990.

1912, 18 janar - Hapet shkolla e parë shqipe në Bllacë me mësues Jashar Zenelin.

1912, maj - U mbajt “Kuvendi i Dheut” në “Gropat e Ukut”, mbi Boçevë, me pjesëmarrjen e 5000 malësorëve nga Gryka e Vogël, Luznia, Gryka e Madhe dhe Bulqiza.

1912, qershor - Shpërthen kryengritja e përgjithshme kundërosmane në Dibër.

1912, gusht - Çlirohet Peshkopia nga pushtimi i gjatë osman.

1912, 25 dhjetor - Shpërthen kryengritja kundërserbe në Grykë të Vogël.

1913, 2 janar - Bie heroikisht në luftë kundër serbëve, tek ura e Topojanit, Iliaz Hoxha nga fshati Trebisht i Rekës së Poshtme. Lindi në vitin 1875.

1913, 1 maj - Lindi Haxhi Lleshi. Më 20 qershor 1942 caktohet komandant i Çetës së Dibrës, më 26 korrik 1943 komandant i Batalionit Partizan të Dibrës; zgjidhet anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NC, anëtar i Qeverisë Demokratike Popullore; emërohet Ministër i Punëve të Brendshme (23 tetor 1944-18 mars 1946), zgjidhet deputet në Kuvendin Popullor (1945-1991),



emërohet Ministër Shteti, mars 1946 - mars 1950; dekretohet Presidenti i Republikës, 1 gusht 1953 –21 nëntor 1982; zgjidhet anëtar i KQPPSh (1956-1991). Në vitin 1963 i jepet titulli “Hero i Popullit”. Vdiq në Tiranë, më 1 janar 1998.

1913, 21 shtator - Shpërthen kryengritja e përgjithshme kundërserbe në gjithë trevën e Dibrës.

1914, 14 prill - Hapet shkolla e parë zyrtare shqipe në qytetin e Peshkopisë dhe Trebisht, me mësues Haki Sharofin dhe Ramis Qatja.

1915- Hapet farmacia e parë në Peshkopi nga Faik Tomini.

1915, 7 qershor - Shovinistët serbë vranë në Gëzden të Steblevës atdhetarin gollobordas Hazis Lila. Lindi në Steblevë në vitin 1868.

Qeveria e Ismail Qemalit e dekretoi prefekt në Klenjë. Luftoi e mbrojti etnicitetin shqiptar të krahinës së Gollobordës.

1915, 2 dhjetor - U zhvillua Lufta e Kaushit (Trojak) kundër Divizionit serb të Nishit.

1916, 1 janar - Trupat ushtarake bullgare të dislokuara në Shkup futen në Peshkopi.

1916, korrik - Trupat ushtarake austro-hungareze pushtojnë Dibrën.

1917, 18 maj - Lindi Sali Ferhat Hoxha. Mësimet e para i mori në Kastriot dhe medresenë në Tiranë. Nga viti 1940-1967 ka qenë myfti në Pogradec, Lushnje dhe Peshkopi. Më 1991-1995 kryen detyrën e kryemyftiut të Shqipërisë. Në vitin 1975 përktheu kuranin. Ndërroi jetë në Peshkopi, më 5 mars 1995.

1918, tetor - Trupat serbe, “Detashmenti i Ohrit” pushtojnë Dibrën.

1920, 13 gusht - Mbahet Kuvendi i Arrasit.

1920, 15 gusht - Shpërthen kryengritja kundërserbe në të gjithë trevën e Dibrës.

1920, 18 gusht - Ngrihet Prefektura e Drinit, me tri nënprefektura: të Homeshit, Hasit dhe Qendrës, me prefekt Ramiz bej Dibrën (Qoku).

1922, 8 mars - Dibranët, të udhëhequr nga Elez Isufi, Ramiz Daci dhe Halit Lleshi nisën një lëvizje për demokratizimin e vendit, që u quajt “Lëvizja e Marsit”.

1922, prill - Hapet internati “DIBRA” në shtëpinë e Shehat Shehut.

1922, 26 prill - Ngrihet Zyra e Postë–Telegrafisë.

1923, 27 janar - Doli i pari ligj për pyjet dhe kullotat i bartur nga kodi turk i bujqësisë. Nga ky ligj Ahmet Zogu mori 2750 ha tokë në Dibër.

1923, 11 prill - Formohet dega e shoqërisë “Djelmnia Dibrane” në Peshkopi me kryetar Raif Kadiun, këshilltar Sulejman Shehun e Haki Sharofin, sekretar Rustem Ymerin dhe arkëtar Ahmet Myftarin.

1923, 14 prill - Hapet shkolla e parë femërore në shtëpinë e Bajram Iliazit, me mësuese Nazmie Pashollin.

1923, 4 qershor - Lindi në Tiranë Jashar Mezelxhiu. Mësimet e para dhe të mesme i mori në Tiranë, të lartën, 1955-1958, në shkollën politike “Vladimir Iliç Lenin” të Moskës. Në vitin 1939-1943 përfshihet në lëvizjen antifashiste të kryeqytetit dhe patifunksione të ndryshme gjatë luftës. Në vitin 1953 dhe 1958-1964, 1964-1976, 1976-1982 ka qenë Sekretar i Parë i Komitetit të Partisë në Rrethet

Peshkopi, Elbasan, Sarandë. Nga viti 1982-1985 vihet në krye të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës. Ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë në të gjitha legjislaturat nga viti 1954 deri në vitin 1985. Në nëntor të vitit 1966 zgjidhet anëtar i KQ PPSH. Në vitin 2001 del në pension. Ndërroi jetë 2 janar 2002.

1923, 12 qershor - U vra në pazari e Peshkopisë Halit Lleshi. Kishte lindur në fshatin Zogje në vitin 1881.

1923, 28 nëntor - U hap Internati “Dibra” në Kastriot me drejtor Haki Sharofin.

1923 - Arriti për herë të parë makina në qytetin e Peshkopisë në itinerarin: Maqellarë–Peshkopi me shofer Ismail Ramën (Melani).

1924, 16 mars - Krijohet Dega e Shoqërisë “BASHKIMI” të Dibrës me kryetar Taf Agollin.

1924, 15 dhjetor- Elez Isufi organizon mbrojtjen e qytetit të Peshkopisë nga forcat bielllogardiste, serbe e zogiste.

1924, 17 dhjetor - Vritet në Peshkopi Sufë Xhelili kundër forcave serbe, bjelllogardiste e zogiste. Lindi në vitin 1862.

1924, 30 dhjetor - Ndërron jetë Elez Isufi. Lindi në Dardhë të Dibrës në vitin 1861.

1927, 9 nëntor - Shoqëria Industriale Tregtare “ANONIME” (S. I. T. A) pranon ofertën për transportimin e kripës në Peshkopi.

1928, 1 shkurt - Lindi në Dardhë të Dibrës rapsodi, koreografi, studiuesi, njohësi më i mirë i traditës dibrane Hazis Ndreu. Hazizi është autor i disa librave si: “Valët e Drinit të Zi”, 1966; “Një trim i Skënderbeut në Dibër”, 1969; “Këngë e vargje rapsodike”, 1971; “Ordinaci”, 1973; “Tregime alegorike dibrane”, 1983; “Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet arbërore”, 1997; “Dibra në udhën e historisë”, 2003” (pas vdekjes). Vdiq në Peshkopi, më 12 qershor 2000.

1928, 19 korrik - Filluan punimet për hapjen e rrugës Ura e Çerenecit – Librazhd, me një gjatësi 50 km.

1928, 27 shtator- Dr. Ihsan Korça emërohet Drejtor i Dispancerisë në Peshkopi me një rrogë mujore 500 fr. ari.

1928, 8 dhjetor - Zbriti për herë të parë në fushën e Kastriotit aeroplani i shoqërisë italiane “ADRIA aereo Lloyd”. Udhëtimi Tiranë –Kastriot u bë për 27 minuta.

1929, 5 prill - Hapet zyra e Hipotekave në Peshkopi.

1931, 22 mars - Filloi të zbatohet dita e diel ditë pushimi.

1931, 2 prill - Riorganizohet Shoqëria Sportive “Dibra” me kryetar Sali Morinën.

1932, 18 korrik - Filloi shërbimi ajror Tiranë–Peshkopi çdo të enjte.

1932, 21 gusht - Zhvillohet i pari kampionat i atletikës me pjesëmarrje 21 djelmohave.

1935, 3 mars - Formohet Shoqëria Sportive “BASHKIMI DIBRAN”.

1935 - Vdiq në Stamboll Haxhi Vidan Dibra. Lindi në fshatin Rimnicë te Rekës. Studimet e larta për teologji i bëri në Stamboll. Në 1900 jep mësim në medresenë e Uskudarit. Shkroi vepra letrare-filozofike-fetare. Ish anëtar i shoqërisë “Bashkimi” të Stambollit. Qe pjesëmarrës aktiv në Kongresin e Manastirit, 1908.

1937, 2 prill - Vdiq në Tiranë gruaja e parë dibrane që mësoi të lexojë e të shkruajë shqip Zenepe Hima (Qoku). Zenepja ishte vajza e Xhemal Pashë Qokut dhe gruaja e atdhetarit veteran Dervish Hima.

1937, 19 tetor - Drejtoria e Përgjithshme e “Ala Littorias” në Itali autorizon degën e saj në Tiranë që të kryente udhëtime për në Peshkopi në çdo kohë që paraqiteshin 4 persona që paguanin vajtje – ardhje.

1938, 6 prill - Ra në brigjet e lumit Ebro të Spanjës, aty ku derdhet lumi Guadalkivi, në verilindje të kodrave të Kaspës dhe Gandise luftëtari internacionalist Ramis Varvarica. Lindi në qytetin e Dibrës së Madhe në vitin 1900. Mori pjesë në kryengritjen e gushtit 1920 përkrah Elez Isufit. Luftoi për triumfin dhe mbrojtjen e Revolucionit të Qershorit 1924. Emigroi në Francë në dhjetor të 1924. Në vitin 1926 bëhet anëtar i PK Franceze. Në vitin 1936 rreshtohet me brigadat internacionaliste që luftuan kundër fashizmit në Spanjë në fillim në batalionin “Edgar Andrea” dhe më vonë në Brigadën e 12 Garibladit në Estremador me funksion komandant i Intendecës të Batalionit të Tretë.

1938, 16 shtator - Zhvillohen zgjedhjet për Këshillin Bashkiak të qytetit. Kryetar zgjidhet Faik Shehu.

1939, 7 prill - Ra në Durrës kundër fashistëve italianë Isak Metalia. Lindi në Strikçan në vitin 1898.

1939, 7 prill - Ra në Durrës kundër fashistëve italianë Ramadan Veliu. Lindi në Homesh në vitin 1915.

1939, 15 prill - Trupat fashiste të Musolinit pushtuan Peshkopinë. Kjo shënoi përfundimin e pushtimit të gjitha qendrave kryesore të prefekturave të Shqipërisë.

1939, 30 maj - Shoqëria italiane “Al Italia” filloi të kryejë shërbime ajrore 3 herë në javë: të hënën, të mërkurën dhe të premten.

1941, 11 prill- U pushkatua nga fashistët italianë Ejup Cami, Musa Cami dhe Mexhit Lezi. Të tre kishin marrë pjesë në qëndresën e organizuar dhe të udhëhequr nga Haxhi Lleshi, më 6 prill 1941, kundër fashistëve italianë, që sulmuan popujt e Jugosllavisë.

1942, 13 maj - U ekzekutua me varje, në burgun e Tiranës, Ferit Ramadan Xhajku. Lindi në fshatin Tren në vitin 1917.

1942, 29 shtator- Vdiq nga torturat në burgun e Peshkopisë, Heroi i Popullit Nazmi Rushiti. Pjesëmarrës në grupet komuniste të Shkodrës më 1936; shok i Qemal Stafës, Emin Durakut, Tom Kolës. Në janar—prill 1939 burgoset nga Ahmet Zogu, në prill 1940 - tetor 1941 internohet në Ventotene të Italisë, ku e mbajnë deri në vitin 1941. Më 8 nëntor 1941 bëhet anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare. Në 1942 vjen në Dibër për punë partie. Në shtator, bashkë me Demir Gashin, marrin pjesë në vrasjen e kapitenit fashist në Zerqan Stavri Jahos.

1942, 20 nëntor - Ra në Symizë të Mallakastrës Gjok Preg Doçi. Lindi në Lurë në vitin 1922.

(vijon)



Nga HAKI PËRNEZHA

Në historinë e veprimeve luftarake që orditë osmane kanë kryer në territorin shqiptar, ajo në Çidhën, e gushtit 1466, përbën pasqyrën më të qartë të barbarive të kryer mbi njerëzit në të gjithë Ballkanin. Studiues të shumtë i janë qasur kësaj ngjarjeje dhe përmasat e saj sot janë bërë objekt diskutimesh shkencore. Njëri prej tyre do të shënonte: “Njihen masakra mbi ushtarë të dorëzuar, mbi burra të thirrur në kuvende dhe të masakruar po aty, të krerëve të thirrur në gosti e të helmuar po aty. Por masakër mbi gra, fëmijë dhe pleq të pafajshëm, me njerëz të paarmatosur..., njihet vetëm ajo e Çidhnës”(1) Sot, njoftimet për veprimet çnjerzore të kryer nga osmanët mbi shqiptarët, janë të shumëta dhe vijnë nga dy drejtime. Duke u nisur nga burimi nga vijnë njoftimet, ndahen në dy kategori:-njoftime që vijnë nga pala e dëmtuar dhe njoftime që vijnë nga ana e armikut (osmanët). Ajo që i dallon këto dy lloje burimesh është qëndrimi personal i shkruesve. Te grupi i parë është shumë evident (Barleti, Muzaka, Biemi etj.) përshkrimi i ngjarjeve me një ndjenjë të thellë dhimbjeje në zemër për shqiptarët të cilët sa e sa herë ishin vënë në zgrip të mbijetesës. Ndryshe qëndron puna kur lexon shënimet e qatipëve osmaë. Ata i kanë përshkruar masakrat e kryera në popullsinë e pambrojtur çidhnake (e më gjërë) me nota të thella ngazëlluese deri në kënaqësi(!). Duke mbetur te Çidhna, po sjellim në vëmendje se masakra e kryer më 1466 mbi këtë popullsi ishte e dyta në radhë, pasi sipas Tit Liv-it në vitin 169 (para krishtit) Perseu shkatërroi qytetin e Oenes-ë, i cili mendohet se ka qenë në Çidhën.

Tani le t'i kthehemi asaj të 1466. Që në fillim duhet thënë se kjo trevë, vazhdimisht, që nga 1443, ishte në vëmendjen e sulltanatit. Kjo tregohet edhe nga shënimet e njërit nga kronikanëve osmanë , Kristobulos. Ai shënon se situata në Dibër të Poshtëme asnjëherë nuk kish qenë e qetë, ndaj dhe “Perandori Murat, babai i perandorit Mehmet, i kish sulmuar disa herë këto zona; ai iu vërsul qafave, shkatërroi një pjesë të mirë të vendit të tyre, i la ushtarët të plaçkisnin dhe pushtoi disa kështjella, ku bëri plaçkë të madhe. Mirëpo nuk ishte në gjendje t'i nënshtrohte ato përfundimisht...”(2) Pra siç kuptohet, situata para masakrës, në Dibër të Poshtëme, si kudo në Mbretërinë e Kastriotëve, ishte vërtetë “shqetësuese”. Situatës së trazuar politike i shtohet edhe gjendja e rëndë ekonomike e fshatarëve si dhe kërdua që po bënte murtaja në popullsi. Dibranët ishin të ndërgjegjshëm se fakti që ata ishin vendorigjina e familjes së Gjergj Kastriotit, i ekspozonte ata para furisë së ekspeditave osmane. (Dhe kjo do të vërtetohej në kohë: 19 beteja u zhvilluan në

Masakra e Çidhnës (1466)



Foto 1. Drejtimet e forcave osmane per marrjen e Çidhnës. Skicë e punuar nga autori.

këto teritore.) Në planin e mbrojtjes, strategjik, Dibra, megjithë përpjekjet e Gjergj Kastriotit, nuk i kishte mundësitë reale në përballje frontale me ushtritë osmane, ndaj dhe shfrytëzonte aleatin e vetëm-territorin. Pikërisht për këtë arsye, në fortifikatën natyrore të Çidhnës, me të marrë vesh ardhjen e ordive osmane, mijëra dibranë mblidheshin, strehoheshin atje. Kështu ndodhi edhe në verë të vitit 1466. Sulltan Mehmet Fatihu në qershor të këtij viti kish rrethuar Krujën. Menjëherë, sapo morën këtë lajm, mijëra dibranë, fëmijë, gra e pleqë, i drejtohen Çidhnës për të qenë më të sigurtë. Sipas njoftimeve që vijnë nga Barleti e Biemi, mësojmë se Gjergj Kastrioti, për të siguruar këto njerzë kish lënë një forcë të armatosur, numri i së cilës shkonte deri në 6 mijë veta. Kuptohet se këto nuk ishin pjesa e shëndosh e ushtrisë së tij, por duhet të kenë qenë njerzë të moshuar por që mund të kryenin edhe mbrojtjen e zonës. Për të krijuar ide më të qartë mbi mënyrën e vendosjes së gjithë atyre banorëve në atë vendstrehim natyror, po vemë në dukje se pozicioni gjeografik i Çidhnës, e lejonte një gjë të tillë. Shumica e banorëve ishin vendosur në vendndenjejet e pafundme të Shehut të Thatë dhe në shpellat e shumëta që ndodhen këtu. Një pjesë tjetër, ajo

që ishte e aftë për punë , ishte e vendosur në shtëpitë e fshatit dhe në Xhitet i cili ndodhej aty ku sot quhet Fusha e Sale. Gjithë këta njerzë jetonin me prodhimet bujqësore të arëve të fshatit si dhe me qumështin që merrnin nga tufat e panumërta të dhive të cilat gjatë gjithë vitit jetonin në Trojë, në kreshtat e Shehut të Thatë. Pjesa tjetër që përbënin forcat e armatosura ishin të ndarë në dy grupe ku njëri ishte i stacionuar te Kepi i Xhitetit dhe duhej të mbronte portën hyrëse në fshat. Grupi (apo batalioni) tjetër i luftëtarëve, ishte i vendosur në Kalanë e Qafë Kalasë (kjo kala ndodhet vetëm 150 ml mbi vendin e quajtur Trojë. (Edhe sot është e gjallë kjo udhe dhe ky shteg). Vetë çidhnakët që u duhej të lëviznin jashtë fshatit, përdornin një portë (shteg) të fshehtë i cili ndodhej rreth 500 ml mbi Kep të Xhitetit. Nëpër këtë shteg të cilin pak kush e dinte, kalonte udha malore që lidhte Shasharin (e Ruse) me Varrin e Jovanit. Pikërisht këtu do të zhvillohej ajo që ka hyrë në histori si Masakra e Çidhnës. Për këtë masakër, kronisti Tursun shkruan: “Aq shumë plaçkë që fletë e që nuk fletë grabitëm...(3) d.m.th është grabitur gjithshka, përfshi “plaçkën që flet” (nënkupto: gra e vajza të reja si dhe djemtë të cilët do t'i shisnin si skllevër). Sipas të njëjtit kronist në tregun e skllevërve “...vajzat e djemtë vlenin 3-4 mijë akçe...”(4) d.m.th, sipas një përlllogaritjeje, fitimi nga shitja e një njeriu, ishte rreth 1000 dollarë. Kjo ishte njëra mënyrë që motivonte lukunin e ushtarëve osmanë në plaçkitje. Pikërisht për këtë arsye, vëren O.Shmid, gjithë trevat shqiptare çdo pranverë “dridheshin nga frika e ardhjes se ordive osmane”(5). Pas vdekjes së Sulltan Muratit, asgjë nuk ndryshoi

për shqiptarët. Sulltan Mehmet Fatihu rrethoi Krujën. Pas dështimit para mureve të kështjellës, ai kthehet në Elbasan, kontrollon punimet për ndërtimin e kalasë së Elbasanit dhe aty i lind në mendje e kthehet të ndëshkojë njerëzit dhe të afërmit e Skendërbeut. Sulltan Mehmeti sipas kronistëve, shfrytëzoi luginat, udhët e shkurtëra nëpër male, marshoi me shpejtësi për të mbërritur afër Çidhnës. Nuk është e vështirë të konstatosh tmerrin që kanë përjetuar të shkretët banorë çidhnakë të pambrojtur. Them i pambrojtur, pasi askuj nuk i shkonte në mend se Sulltan Mehmeti, kinse po largohej pas dështimit para Krujës, devijoi udhën dhe erdhi në Çidhën. Ndërsa Barleti është më i qartë, kur na tregon situatën dhe zhvillimin e ngjarjeve në këtë krahinë: “... Mehmeti II dështoi, megjithatë, nga disfata e tij nxori mësim që do të kishin pasoja të rënda për Arbërinë. Gjatë marshimit të kthimit që vijoi, la një pjesë të ushtrisë në luginën e Drinit të Zi, pranë Çidhnës, vendbanimit të vjetër të Kastriotëve, një tradhëtar u tregoi osmanëve një zonë të veçantë, pasuesve të tij, për t'i strehuar në vend të sigurtë që nuk doli i tillë. Ky vendfshhejeje u kthye në grackë. Osmanët bënë këtu një kasaphane të tmerrshme, si shpagim për dështimin e fushatës së tyre. Shumë nga njerëzit më të afërt të Skënderbeut, duket u vranë në këtë masakër, ose humbën, gratë, fëmijët, të afërmit e tyre...”(6) Në një njoftim tjetër po nga Kristobulos dëshmohej me kënaqësi(!), se si fshatra të tërë u dogjën me flakë e tym . Ja se si ky kronist bizantin, e përshkruan më gjërë e gjatë dinamikën e kësaj ngjarjeje: “Mehmeti II dërgoi trupa me karro





Foto 2. Pozicionimi i forcave osmane

Foto 3. Vendndenjet e banorve

në çdo luginë dhe përpjetë në çdo kullotë e bjeshkë, duke varur njerëz dhe bagëti, ose duke i rrëmbyer ato... Në fillim marshuan shpatarët, pastaj shigjetarët dhe bakstrarët, si dhe gjuajtësit me hobe. Qetë – qetë e hap pas hapi, vinte pas tyre këmbësoria që shtynte prapa kryengritësit, gjersa i asgjësonte në luftime, kështu u mor majë pas maje e kështu u dogjën me flakë e me tym, edhe skutat më të fundit. Asnjëherë më parë nuk kishin përdorur osmanët një taktikë të tillë luftarake. Asnjëherë më pas nuk do t’ua vinin më osmanët malësorve këmbën mbi zverk si atëherë. Muhameti II e kish arritur fitoren, me një luftë totale. Regjistrat tatimor osmanë dëshmojnë për suksesin e kësaj taktike, që në Mat e në Dibër shkatoi një katastrofë të vërtetë demografike.”(7)

Përmasat e shkatërrimeve të bëra nga ushtria turke tregohen edhe në disa shënime tjera të kronikanëve tjerë osmanë. Ja si shkruan njëri prej tyre: “...Bërthama e vendeve të Skënderbeut u shkretua tërësisht, fshatrat u bënë shkumb e hi, pjesë të mëdha të popullatës u shuan. Të shumtë ishin njerëzit që vetëvriteshin për të mos rënë në duart e osmanëve.”(8) Ndërsa një tjetër na sjell informacione që kanë të bëjnë edhe me katastrofën humanitare që përgatiti Sulltani: “...Ushtria Osmane e kishte përpirë e zhveshur krejt Arbërinë, drithin e kishin korrur ende të blertë, kishte ngrënë deri edhe gjethet e pemëve; gjer lart në Shkodër s’kishte më shpresa për të korra...” (9) Një tjetër kronist shënon: “... Fati i Arbërisë së rrënuar shkatoi në Perëndim dhe në Lindje, pikëllim dhe tronditje edhe habi të thellë. Kronistët e kohës regjistrojnë e dëshmojnë gjendjen e mjeruar të vendit e megjithatë ajo nuk ishte nënshtruar ende.”(10)

Ordia turke, përbëhej nga njerëz të pangopur e plaçkitës, të cilët mezi prisnin t’ju jepej komanda për plaçkë dhe dinin vetë se ç’të bënin... pas tyre mbetej vetëm shkretëtira. “... Armiku përshkoi fushat dhe malet ... sa që në një qark prej 4 miljesh...nuk rri më në këmbë asnjë shtëpi, nuk jeton më asnjë njeri.”(11)

Mendojmë se lëvizja e forcave osmane drejt Çidhnës ka ndjekur këtë rrugë: Nisja nga Elbasani, ka shfrytëzuar grykëdaljet për në Dibër a Mat dhe pastaj nga Bulqiza mendojmë se ka lëvizë për në Katër Grykët. Këtu një pjesë e ushtrisë ka lëvizë pranë Kalasë së Stelushit, luginës dhe ka dalë në Pllajë mbi Sinë. Ky formacion do të shkatërronte Kalanë e Skënderbeut në Qafë Kala . Pjesa tjetër e ushtrisë ka zbritur poshtë nëpër luginën e Murrës, në Muhurr dhe aty një pjesë e saj ka marshuar për në Sinë nga ku Xhitetin e Çidhnës e kish si në pëllëmbë të dorës. Pjesa më e madhe në numër e ushtrisë ka marshuar nëpër Zbinec dhe është stacionuar tek Ferra e Pashës (Fushë Alie). Kjo pjesë e ushtrisë do të shkatërronte fortifikimin në Kep të Xhitetit dhe më pas të Xhitetit në Çidhën. Sipas Barletit, por edhe sipas gojëdhënave që ende tregohen në gjithë trevën e Çidhnës, një banor i shitur, u tregoi turqëve shtegun e fshehtë nëpër të cilin mijëra jeniçerë depërtuan deri afër vendndenjës së çidhnakëve. Sulmi nga të gjithë drejtimet ka filluar në të njëjtën ditë. Nga Pllaju, mbi Sinë në dy sheshpushime ishin vendosë bateritë e topave të dardhës të cilët hidhnin papushim gjyle mbi muret e kalasë së Skënderbeut.

Forcat turke të vendosura në Sinë, lëvizin drejt vendit të quajtur Devar (foto nr 2). Nga aty janë hedhë gjyle mbi banorët e vendosur në Sheh të Thatë. Pjesa më e madhe e ushtrisë që vinte nga Ferra e Pashës u nda në dy pjesë: një batalion do të sulmonte rojet në Kep të Xhitetit, ndërsa pjesa tjetër, më e madhe në numër, nëpërmjet shtegut të fshehtë, hyjnë në brendësi të Çidhnës dhe atje kasaphana do të ishte e llahtarshme. Numri i banorve të masakruar sipas Barletit është 8 mijë ndërsa Biemi shënon: “...30 mijë burra, gra fëmijë e pleqë e midis tyre edhe 8 mijë luftëtarë.”(12) Mendojmë se numri 8-12-30 mijë është i diskutueshëm por mjafton që edhe 5 mijë veta që ajo masakër të jetë e pashoqe në Ballkan. Imagjinoni se sa fshatra u shkretuan, mijëra shtëpi mbetën bosh. Luftëtarët çidhnakë e të zonave përreth kur u kthyen gjetën mijëra copëra trupash e gjymtyrësh të shqyer nga egërsirat. Goditja ishte shumë e rëndë dhe veprimet ishin gjakatare e shnjerezore. Në deferin e 1467, fshatrat e

Çidhnës dhe zonave tjera përreth, dalin me një numër të kufizuar banorësh.

Mjaftojnë këto fragmente për të pasqyruar terrorin e ushtruar mbi banorët çidhnakë në ato vite. Është e kuptueshme se askund tjetër forcat osmane nuk janë treguar më mizore se sa në “vizitat” që i kanë bërë kësaj krahine dhe kjo, për faktin e thjeshtë se këtu banonin të afërmit e trimit Skënderbe. Pikërisht në këtë kohë lufrash të tmerrshme e shkatërruese, në Çidhën lindi dhe u këndua kënga e Fushë - Banit: Hej, n’at Fush Ban po thurret ni za,/ Hej, gjith’ çidhnakët hoxhum kan ba. Hej, n’Kep Xhitet po vikatka zani,/ Hej mbidhi burra, o ke Fushë-Banit/ Hej, prej Qenoku po vjen ushtria,/ Hej, me djeg k’solla, ene shpia./ N’thikë jan vu grat’ e f’mia./ Mazun bahet Kep Xhiteti,/ Na përvëloi sulltan Mehmeti./ Greu popull fukara,/ Mçefni cull’ e mçefni gratë!/ E t’i çojmë n’Shehe t’Thatë./ Kërcet topi shpat e m’shpat,/ Përcjell Seta ujë e gjak./

Që nga ajo ditë, e më pas, sipas gojëdhënave, të mbijetuarit e masakrës, çdo të diel shkonin tek ishin varrosur të varrët, uleshin mbi një ledh dhe, sipas traditës, bënin vaj kolektiv. Zëri e



FOTOLAJM

Ne fshatin Kastriot te Njesise Administrative Kastriot, filloi puna per ngritjen e memorialit qe i kushtohet Familjes se Kastriotit. Ky memorial eshte mbeshtetur nga Keshilli i Qarkut Diber, ne kuadrin e “Vitet te Skenderbeut”.



Foto 4 Forcat osmane perballe Kalase dhe Shehut te Thate



Foto 5. Kepi i Xhitetit, porta hyrese per ne Çidhen




Foto 6: Levizja e forcave osmane nga F.Alie per Çidhen

kuja e përbashkët oshëtinte kodrave e përcillej shpat më shpat, duke i bërë malet të dridheshin nga dhimbja. Për shkak të vajit të përsëritur, ky vend u thirr që atëhere “Lugu i Vajit”. Aty ngjitas me “Varret e të Vrarëve” ndodhet edhe një toponim tjetër, “Varret e Cullve”. Aq kishin pasë mundësi të bënin çidhnakët në atë kohë të turbullt: të hapnin dy gropa: në njëren u futën fëmijët dhe në tjetrën të mëdhenjtë. Njëra gropë u quajt Varri i të Vrarëve dhe tjetra Varri i Cullëve. Që të dy këto toponime lidhen me Masakrën e Çidhnës, e jo vetëm toponimet e përmendura por në çdo pëllëmbë toke në këtë periferi gjenden pafund kocka njerzish.

Katastrofa demografike në mënyrën më të qartë shprehet në regjistrat osmanë të 1467(13). Nga një vështrim i thjeshtë vetëm në Dibër të Poshtëme nga 59 fshatra, pas Masakrës, 45 prej tyre kanë nga 2-10 shtëpi. Sipas një përllorarit-jeje: 45 fshatra me nga 5 shtëpi mesatarisht bëjnë 225 shtëpi X 7 banorë për çdo shtëpi, baraz me një popullsi prej 1500 banorësh. Krahasoni këtë numër frymësh me ato që u ndodhën të grumbulluar në Çidhën (10 mijë). Pra në këtë kasaphanë humbën jetën mbi 8 mijë banorë. Duke ndjekur shënimet e bëra, 116 vjet më pas, në Deferin e 1583 numri i banorve në të njëjtët fshatra të Dibërës së Poshtëme, është 10 fishuar. Pra Dibërës iu deshtë më shumë se një shekull të ripërtërihet nga Masakra e zhvilluar në Çidhën.

Pas kësaj masakre të tmerrshme, dhe sidomos pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, filloi ikja masive e banorëve , shumica drejt bregdetit të Shqipërisë dhe më pas drejt Pulias. Ja se si e përshkruan O.Shmid këtë fakt: “...krejt Arbëria po arratiset drejt Puljes me gjithë familje e katandi...”(14)

Kjo situatë e krijuar në një farë mënyre jep përgjigje edhe pyetjes se pse në regjistrimet e mëvonëshme, humbet patronimi “Kastrioti”. Kështu shkurt Masakra e Çidhnës, megjithë humbjet e shumëta njerzore, e vendosi këtë Krahinë në qendër të vëmendjes të opinionit historiko-shkencor, duke e bërë të lehtë pranimin e e origjinës dibranë të familjes së Kastriotit.

Referencat:

1. Këbej, B. “Origjina dibrane e Skënderbeut” fq 54.
2. Kristobulos, te Radoniq; cituar nga “Skënderbeu” i O.Shmid fq 264.
3. Burime osmane fq 100.
4. Po aty fq 101.
5. Kristobulos...si më sipër, fq 264.
6. Barleti M. “Historia e Skenderbeut” fq 376.
7. Kristobulos ...si më sipër, fq 276.
8. Po ai, po aty, fq 406.
9. Shmid O. “Skënderbeu” fq 23.
10. Po ai fq 380.
11. Sabiano S.; “Shtojca e Burime” fq 14.
12. Frashëri K. “Historia e Dibrës” fq 123
13. Grup autorësh: “Dibra në Dëfterët osmanë” fq 364.
14. Shmid O. “Skënderbeu” fq 378.

PROPOZIMI

“KËTU KA BURRA!”,
HIMNI I DIBRANËVE

Nga ADEM NAZIFI

Në kushtet e një dileme për të shijue deri në fund rehatinë në shtëpinë e bleme pas një periudhe të gjatë vështirësish fitoi nevoja për të mbeshtetë djalin në përpjekjet për një jetë ma të mirë...dhe me 31 Maj 2002 mbas udhëtimit për Tiranë - pa dashtë të them se u largova nga Peshkopia, me të cilën më lidh lindja e rritja në moshë ,dinjitet, punë me pasion e ndershmëri, deri sa dola në pension.

Nuk due të përdori fjalën largim, sepse aty kam shtëpinë ku lindi, aty kam mahallen dhe kujtimet me kojshitë e bashkmoshatarët e fëminisë, nostalgjinë për “rrugën e ngushtë” , bulevardin me aromën e blinit dhe për gjithë infrastrukturën urbane të qytetit, ku do të vecoja “Lulishten 1 Maji” të ideueme me fantazi e pasion nga i nderumi Rexhep Doda, i cili me nxitjen dhe ftesën drejtue çifteve të rinj për të frekuentue lulishten, luajti një rol të pa konkurueshëm në emancipimin shoqnor, ashtu si bashkëshortja e tij me ekipin e vollejbolit të vajzave.

Nuk due të pranoj konceptin largim , sepse pavarësisht nga ndryshimet që kanë pësue, ruaj kujtimet për institucionet dhe ndërmarrjet apo kooperativat ku shërbeva ,mes kolektivave respektiv ku më duhet të veçoj respektin dhe mirënjohjen për drejtuesit si Azis Shehu , Thoma Zhupa , Hysen Mata , Ahmet Përleka, Ramiz Osmani, Festim Pishtari, të cilët me edukatën dhe provojën që sfidonin edhe rastet kur mungonte arsimimi i plotë, më ushqyen dashurinë për punën, si faktorin bazë të atyre sukseseve që arrita dhe vlerësimeve që mora.

Ndonëse moshë dhe gjendja shëndetësore ma vështirësojnë përshkrimin e 170 km rrugë, në kushtet e një jete pasive (do ta queja) në ndihmë të përjashtimit të fjalës largim ,më vjen gazeta “Rruga e Arbërit” me shkrimet kushtue personaliteteve të krahinës , bukurive e vlerave të natyrës si perspektivat e zhvillimit të saj; më vjen aroma e kënaqësisë që më shfaqet edhe kur shoh nje targë DI, e cila më shkakton dridhërimë të pa kontrollueshme të të gjithë trupit, pa fol për rastet kur ndesh e komuinkoj me një “katundar” me kësulën karakteristike. E pa përshkrueshme ka qenë dhe mbetet ndjesia që më dha një bashkudhëtar në autobuzin urban, i cili kur po ndaheshim më pyeti - prej nga je? - dhe në interpretim të përgjigjes time më shtrengoi dorën dhe më tha: “Ke të drejtë të ndjehesh krenar, sepse Dibranet, ndyshe nga të ardhurit e tjerë, kanë ditë të çmojnë mikpritjen, të respektojnë shenjtërinë e pronës, të integrohen denjësisht, madje të sjellin edhe kulturë qytetare.” Nje kompliment ky vërtet joshës.

Për të shmangun ndjenjën e vetmisë që stimulon jeta pasive e moshës së tretë ,për të përjashtue mundësinë e largimit, përpiqem të fshej kujtesën me albumet fotografike dhe muzikën, për të sfidue distancën.

Sjell në mendje miq si Ali Xhika, Hashim Methasani, Ramadan Kurti, Sabetin Methasani, Shahin Kamberi, Haxhi Doci etj., që me inteligjencën e tyre vrojtonin, analizonin dhe interpretonin në mënyrë befasuese eventet që përjetonin dhe zakonet e doket tradicionale të krahinës, të cilat ushqenin vendosmerinë për të mos u ndiem i larguem.

Një ndikim veçanërisht të fuqishëm për të sfiduar largësinë më jep vendi i prehjes së të ndamëve nga jeta, ku përvec prindërve dhe të afërmve pushojnë personalitetet midis të cilëve do të përmend të ndjerin Myfti Sali Ferhati që të imponon respekt, nderim e krenari të ndjehesh bashkëqytetar me të.

Nderkohë muzika me vlerat e saj emocionuese që fillon me këngët kushtuar Atdheut e Flamurit, të interpretueme nga Ansambli LIRA i Korçës; vijon me këngët kushtue gjyshes, nanës ,fëmijës; për t’u çel rrugë këngëve të krahinës të përcjelle nga fyelli e çiftelija që sfidojnë orkestra dinjitoze,që fillojnë me Haxhi Maqellarën dhe vazhdojnë me këngët kushtue betejave për mbrojtjen e vatanit dhe rolit të kreshnikëve Elez Isufi, Mahmut Daci etj., te interpretueme me origjinalitet nga Azis Ndreu për te vijue me elegjitë (do t’i queja) kushtue vështirësive dhe fatëkeqesive të jetës së brezave pararendës, të interpretueme me ndjenjë e finesë nga Liri Rasha, është një tjetër përçues brilant i ndjeshmënisë së refuzimit të largimit.

Dhe ja, ma në fund erdha tek qëllimi i këtij shkrimi.

Nga fondi i artë i muzikës kushtue përpjekjeve dhe sakrificave në mbrojtje të vendit dhe traditave e zakoneve tona te shumë respektueme kam vecue këngën “Këtu ka burra” ,të interpretueme me ndjenjë e patos nga Qerim Sula, për ta propozue si himn të dibranve.

Nuk e di nëse asht legjitim propozimi im, veçse unë insistoi se kjo këngë dhe ky interpretim meriton të titullohet himn qoftë edhe si përjashtim.



“Penën time nuk e shes!”

Dibranit Halim Laçi i jepet titulli “Qytetar Nderi” i Krujës

Nga VIRON KONA

Në një ceremoni të bukur të organizuar nga Bashkia Krujë, më 23 qershor 2018 z. Halim Laçi, iu dha titulli “Qytetar Nderi” i Krujës, bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Krujë Nr. 40, datë 30.04.2018.

Mernin pjesë qytetarë të Krujës dhe Fushë-Krujës, kuadro të rrethit, të ftuar nga Tirana, Dibra, Mati, Shkodra, Mirdita, Lezha, Vlora si dhe pjesëtarë të familjes Laçi. Ishin të pranishëm dhe: z. Rahman Rraja - deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, z. Mehmet Deliu - përfaqësues i Bashkisë Krujë, Drejtor i Burimeve Njerëzore, z. Faik Xhani - Kryetari i Bashkimit të Përgjithshëm të Pensionisteve të Shqipërisë, z. Haxhi Tafa - ish deputet, z. Osman Vladi - intelektual nga Lura, z. Agim Nuna - drejtori i Arsimit, Krujë, etj.

Ceremonia u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë, sa miqësore dhe zyrtare, e shoqëruar me këngë e valle. Fjalën në emër të bashkisë e mbajti drejtori i Burimeve Njerëzore të Bashkisë Krujë z. Mehmet Deliu. Ndërmjet folësve të shumtë, mbajti një fjalë të shkurtër edhe shkrimtari Viron Kona, të cilën po e botojmë në këtë numër gazete:

Ndihem i nderuar që marrë pjesë sot në këtë ceremoni të vlerësimit me titullin Qytetar Nderi i Krujës të z. Halim Laçi. Nuk ka asgjë më të madhe në jetë sesa të dojë dhe të vlerësojë qyteti dhe njerëzit ku ti jeton, sepse aty je i njohur, aty është jeta dhe vepra, aty është rrethi miqësor e familjar, të dashurit, miqtë dhe shokët, ata që të njohin më mirë në situata nga më të ndryshmet ku njeriu ka rastin dhe mundësinë të tregoj vetveten, të zbulojë vlerat dhe të tregoj se kush është ai për familjen, për shoqërinë, për vendin dhe kombin.

Halim Laçi është i Dibrës po aq sa edhe i Krujës, emri i tij është i madh atje, por edhe këtu dhe, më vjen mirë të them se emri i Halim Laçit vezullon edhe në Shqipëri, madje edhe në diasporë me krijimet e tij brilante atdhetare, për jetën dhe të ardhmen, për lirinë dhe për kombin shqiptar.

Të rrallë janë ata artistë, tek vepra dhe repertori i të cilëve afishohen dhe kombinohen aq bukur llojet e artit dhe mjeshtëritë: krijues, koreograf, instrumentist, rapsod, drejtues, udhëheqës artistik, moderator. Është një shumëllojshmëri që shumëkush do ta kishte zili e që pasohet me: 250 tekste këngësh, shumë prej të cilave pasurojnë e nderojnë albumet e mjaft këngëtarëve të njohur të Shqipërisë, ndërkohë që ky personalitet artistik, është pjesëmarrës dinjitoz në të gjitha festivalet folklorike

kombëtare 1967-2009, i dekoruar shpesh herë si rapsod, valltar, krijues, interpretues. Mbi të gjitha, njeri i mirë.

Halim Laçi është në zemrat e dëgjuesve dhe shikuesve, vepra e tij përmendet në biseda, në avllitë krutane dhe odat dibrane, në Fushë-Krujë dhe kalanë e Krujës, në Reç, Lurë dhe Radomirë, por ai ndodhet mes tyre edhe fizikisht, vazhdimisht i kërkuar, nga këngëtarë e kompozitorë, veçanërisht për tekstet e bukura dhe të frymëzuara, i kërkuar nga populli për ta përjetuar bukurinë e artit të tij, por edhe për librat e tij: “Nuk Harrohen”, dhe “Shqipëria e dashur”, që janë libra me vlera të mëdha ideore dhe atdhetare, homazh dhe nderim për dëshmorët dhe heronjtë e kombit, por edhe për njerëzit e thjeshtë, që e shprehin heroizmin e tyre në përditshmërinë e jetës, të heshtur dhe të pa fjalë, me vepra.

Halimi është nga ata krijues rapsodë që di t’i përgjigjet flak për flak realitetit dhe jetës, ai thur vargje, e ndez këngë duke shprehur lajtmotivin e jetës së tij:

“Për trojet shqiptare,
Do të shkruaj derisa të vdes,
Jam betuar në gjakun e të parëve,
Penën time nuk e shes”.

Halim Laçi i është edhe një veprimtar që se ka shokun, ai me kolegë të tjerë, organizon dhe zhvillon veprimtari të bukura e tërheqëse për banorët e qytetit dhe të krahinës; sjell në kujtesë dhe prezanton me artin e valleve dhe këngës, historinë dhe jehonat e shekujve, duke lartësuar në piedestale arti trimat që ranë për liri, dëshmorët e atdheut, por edhe njerëzit e punës dhe të jetës, ata që me shpirt të zjarrtë e zemër të madhe zhvillojnë demokracinë shqiptare drejt vlerave më të mira evropiane.

Ky poeti i nderuar, valltar e koreografi i shquar, ky njeri i urtë, fjalë-mençur e fjalë-bukur, i dashur si ai, i vendosur, krenar dhe me kurajë, që respekton më tepër se gjithçka të vërtetën dhe lirinë, edhe tani në moshë disi të thyer, i shërben pa u lodhur dhe me dinjitet atdheut, nderon dhe respekton me fjalë zemre popullin dhe historinë e tij, i ngrë himn lirisë, të vërtetave të jetës dhe heroizmit popullor.

Është një vendim i drejtë ky i Bashkisë së Krujës për këtë vlerësim që i bëhet sot Halim Laçit. Kjo na gëzon të gjithëve, gëzon atë vetë, familjen, rrethin miqësor e shoqëror, por gëzim për këtë vlerësim i kalon kufijtë e Krujës dhe Dibrës, është gëzim i të gjithëve.

Ta gëzosh titullin Halim Laçi!

Me jetë të gjatë, të gëzuar dhe të lumtur!

Mos pushoftë pena jote e ndritshme për atdhe e për Shqipëri, për Kombin Shqiptar!

Faleminderit Bashkisë për këtë vlerësim!

Faleminderit të gjithëve!

I përjetshëm kujtimi i mikut tim, Vesel Skerja!

Per shkak te nje semundje te pasherueshme, u nda nga jeta ne moshen 69 vjecare Vesel Skerja, bashkeshorti i motres sime, Bukuries, duke lene ne pikellim te thelle familjen, tre djemte e tij te shtrenjte, Delfinin, Lutin dhe Florin, nipat dhe mbesat, sa te vegjel aq dhe te dhembshur, si dhe gjithë te afermit, fisin dhe farefisin e tij te gjere!

Sherbimi qe i bene familja, djemte dhe nusët mund te thuhet se ka qene i jash-tezakonshem. Djemte e derguan te atin, ne fillim, ne klinikat private me te mira te vendit dhe me pas edhe ne ato jashte shtetit. Asgjë nuk mbeti pa bere per Veselin. Megjithese semundja qe shume e rende dhe perparimi i saj i pandalshem, Veseli, i mesuar ne jete me veshtiresi, cuditerisht, asnjehere nuk renkoi, asnjehere nuk u dha! I paepur deri nje jave perpara sa te na jepte lamtumiren e fundit, ai e perballoi semundjen ne kembë, duke mos u shtri per asnje cast. Dhe ky perballim i tij ka zgjatur jo me dite, por me vite, per me sakte, gusht, 2015 - gusht, 2018.

Me fjale te tjera, vete jeta i kish spikatur atij si vecorine me te dallueshme: shpirtin e qendreses. Shpirt te cilin e manifestoi deri ne momentin kur, perfundimisht, mbylli syte per te mos i hapur me kurre! Vesel Skerja e

dashuronte aq shume jeten, sa beri cmos qe te linte pas nje emer te mire. Ai zbriti nga Zimuri i bjeshkeve te Korabit dhe u vendos ne fillim ne qytetin e Peshkopise, ku kreu detyra te rendesishme si nepunes dhe intelektual, (si pershembull: drejtues artistik ne Ndermarrjen Bujqesore Peshkopi, drejtor kantieri, shef kuadri ne Parkun e Mallrave, nepunes ne Bshkimet Profesionale, instructor partie, detyra ne te cilat, gjithmone, mbronte, pa rene ne sy, te drejtat e popullit te vuajtur dhe fukara) dhe pas viteve '90 u transferua ne kryeqytet.

Qe ne rini te hershme spikati tek ai talenti ne muzike, ne kenge e, sidomos, ne valle. Ne menyre autodidakte dhe jo vetem, ai mesoi te luante bukur ne fizarmonike dhe te drejtonte grupe amatore artistike. Me pas u be i njohur si kengetar, vecanerisht, me kengen "Dibra jone ne brigje te Drinit", kenge e cila eshte e fiksuar dhe ne sekuencat e nje filmi dokumentar per Dibren. Perpos ketyre, Veseli shkelqeu gjithmone si nje valltar popullor profesoinist, jo vetem ne veprimtarite kulturore-artistike brenda rrethit, por edhe ne ato ne shkalle kombetare, madje, deri ne festalet e Gjirokastres, e tjere.

Si bashkeshort e prind ai ka qene dhe mbetet nje shembull per t'u ndjekur! Tre

djemte e tij duhet te jene krenare per babane, per edukimin qe u beri me virtytet me te vyera te shqiptarit, si: atdhedashuria, mikpritja, vullneti dhe dashuria per shkollen dhe sidomos per punen e ndershme!

Me veshtire, gjithsesi, do ta kete, tashme, motra ime! Asaj do t'i mungoje pergjithmone shoku i jetes, i cili, deri ne nje jave para se te ikte, bridhte Tiranen ne kembë per te gjetur ilacet kunder diabetit tridhjetevjecar te se shoqes, te ciles, ne ditën e pare kur i shoqi zuri shtratin per te mos u ngritur me, asaj i prene ne spital njerin gisht te kembes, si nje harac per semundjen e gjate dhe te pakurueshme!

Kujdesu per kembën!- i kishte thene i shoqi. Se paku, te rrosh ti sa me gjate qe t'i kesh ne sy femijet, amanetin tim!

Ashtu e semure, motra diji te beje gajret, sic I thone! Ajo drejtoi, me se miri, si nje kryezonje gjithë mortin disaditor te te shoqit, pa lene menjane dhe vajtimin e thekshem te tij si nje vajtojce e dhembshur muhurrake!

Zoti e paste shpirtin e Tij, atje lart, ne parajsën qiellore! I përjetshëm kujtimi i paharrueshem i mikut tim, i shokut tim, Vesel Skerja! Familjes dhe femijeve iu paste lene uraten!

NAIM BERISHA

KUJTESË

Nazmi Kolarit, kujtesë në 20 vjetorin e ndarjes nga jeta



Dibra, sinonimi i dijes dhe trimërisë, ndër shekuj lindi dhe rriti breza, të cilët e bënë atë të gëzonte famë dhe prestigj të madh brenda e jashtë vendit. Horizontin tonë e tejkalon përkushtimi i atyre burrave që dhanë gjithçka nga vetja për të ruajtur nderin dhe kulturën dibrane. Mes brezit të përvojatur të intelektualëve dibrane, me meritë qëndron emri i Nazmi Kolarit, i cili u lind në një familje me traditë dhe kulturë, në vitin 1924. Shkollimi i zbuloi mendjemprehtësinë dhe dashurinë për leximin dhe studimin e gjuhës burimore shqipe. Jeta e njohu me shumë "fate" të rezervuara për brezin e tij, të cilët mbase ia zgjeruan horizontin e dijes. Leximi dhe ndjekja e vazhdueshme e shtypit, ishin "ushqimi" i kalitjes së intelektit të tij, të reflektuar pastaj në shoqërinë që e rrethonte. Të dalluar mes miqsh e bëri, pastërtia dhe eleganca e fizikut, moslejimi i gabimeve, matja e fjalëve dhe mendimeve, veçanërisht idetë emancipuese e përparimtare.

Pavarësisht rrethanave specifike-ekonomike të kohës, arriti që të shkollojë pasardhësit e tij në profesione të ndryshme, të cilët i shërbejnë Dibrës me përkushtim, duke gëzuar respektin e gjithë qytetit. Kulturën e traditat e vendit i promovoi nëpër manifestime të ndryshme, veçmas luajtja e valles dyshe dibrane, për të cilën u bë mjeshtër i vërtetë popullor, duke u radhitur në plejadën e artistëve popullorë dibrane. Këtë 9 shtator, përkujtohet në 20 vjetorin e ndarjes nga kjo jetë, si personalitet i shquar nga gjithë ata që e njohën, veçanërisht nga ne, pasardhësit e tij, si një falenderim për imazhin dhe respektin që la si krenari.

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Çmime shumë të mira për tirazhe 20-100 kopje

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 068 65 08 441

Bëj një abonim
online ose në
print...

Kushton vetëm 600 lekë
në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com



www.rrugaearbërit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: info@rrugaearbërit.com

Informacioni për versionin e printuar: rrugaearbërit@gmail.com

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjëime.

Shtyp butonin **“NDIHMË EDHE TI”** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/ Shqipëri në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky ëëbsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës “Rruga e Arbërit”, lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Shija dibrane në kuzhinën bashkëkohore



Tortino me çokollatë



PËRBËRËSIT PËR 4 PERSONA: Çokollatë e zezë 90 gr, sheqer 80 gr, gjalp 90 gr, miell 40 gr, vezë 2 kokrra, kupa porcelani 4.

VËSHTIRËSIA: normale

KOHËZGJATJA: 40 minuta.

PËRGATITJA: Vendosim në një tenxhere çokollatën së bashku me gjalpin dhe i përziemë që të shkrijnë. Në një enë tjetër përziemë vezët me sheqerin. Më pas shtojmë miellin dhe i përziemë mirë. Pasi çokollata me gjalpin të ketë shkrië e shtojmë tek ërzierja e vezëve me sheqerin dhe miellin. Marrim 4 kupa dhe pasi i lyejmë me gjalpë dhe miell i mbushim me masën e krijuar më sipër. I vendosim në një tave dhe i fusim në furrë të ngrhur në temperaturën 180 gradë celcius për 15 minuta. Në këtë çast çokollata është pjekur, por në brendësi është e lëngshme. E nxjerrim nga kupa dhe e vendosim në pjatë dhe e shërbejmë me një salcë sipas dëshirës.

info@vivandachef.al




BËJ NJË ABONIM ONLINE OSE NË PRINT...

Kushton vetëm 600 lekë në vit... / email: rrugaearbërit@gmail.com

LIBRA

Të gjithë këto tituj te libraria M&B, ART's dhe Adrion në Tiranë ose në Peshkopi.

...dhe mbi 100 tituj të tjerë të autorëve dibranë...



Të gjitha këto botime i gjeni pranë rrjetit të librarive **Adrion** në Tiranë, librari **ART'S** te ish-Stacioni i Trenit, **librarisë M&B** në Tiranë (pranë kryqëzimit të Selvia në Rrugën e Dibrës ose në librari **“Fleta XXI”** në Peshkopi.

Email: mmbotime@gmail.com Tel: **+355 69 20 68 603** (Viber) **+355 68 65 08 441** (Whats App):